Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 8-9 (170) / SHTATOR 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

PROFIL

‘Dibra resort’, një oaz qetësie në Luginën e Shërimit

Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 9

KRITIKË

‘Kur këndonin gjelat e tretë’ – rrëfimi i pagjykuar i vrasësve

Nga **BALLSOR HOXHA** — Faqe 11

BOTIME

Flutura Açka dhe “Biri”, një libër për të gjallët

Nga **LEONARD VEIZI** — Faqe 12

HOMAZH

Velo Cfarku, ikja e një njeriu që la emër pas

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** — Faqe 10

Covid-19 “kyç” industrinë e turizmit

Pandemia Covid-19 preku thuajse çdo sektor të ekonomisë. Por më e ndjeshme ishte situata në sektorin e turizmit që Shqipëria është shumë më e varur, si prej turistëve që vijnë nga jashtë, por edhe nga shqiptarët e trevave në Kosovë e Maqedoninë e veriut. Fushata e fundit “Pusho Shqip” për të stimuluar atë që quhet “turizmi patriotik”, mund të ketë mbushur plazhet, por në zonat malore, nuk duket një situatë e ngjashme. Sektori i turizmit në Dibër, vitet e fundit po merrte një zhvillim edhe më të madh. Shumë struktura akomoduese janë ngritur në këtë zonë për t’ju shërbyer turistëve vendas dhe të huaj. Por pandemia covid-19 i ka vënë në situatë të vështirë bizneset që operojnë në fushën e turizmit malor dhe atë kurativ në ujërat termal, një problem zinxhir edhe në ekonominë e zonës.

Nga **SAMI CURRI** - FAQE 3



Në foto: Kulla “Hupi” në Bulqizë, një nga destinacionet e reja turistike në Dibër, e cila rrezikon të mbyllet nëse situata e krijuar për shkak të pandemisë do të vazhdojë. Foto: Sami Curri

PRESIDENTI I REPUBLIKËS ILIR META VIZITON DIBRËN:
VLERËSIME PËR FIGURAT ATDHETARE DHE KULTURËS POPULLORE



REPORTAZH NGA ILMI DERVISHI

“O mirë se na erdhe!”

- Në **Muzeun e Kastriotëve** në Sinë
- **Neshat Ndreu**, organizatori i festës së 18 shtatorit në Zall Dardhë
- Shpopullimi i Dibrës është i dhimbshëm

FAQE 5,6,7

NË BRENDËSI:

- Eh **sikur kështu të fliste për Drinin** edhe në Zallë-Dardhën që mbytet Presidenti!
- **Sabedin Kurti**, mjeshtër i rrallë i punës dhe zejeve popullore
- **Elez Isufi** dhe **Suf Xhelili**
- Mëria e **Moisi Golemit**
- **Kryengritja** kundër serbe e shtatorit 1913
- Kujtime për **Gani Metën**
- **Qemal Çadri**, një meteor që nuk do të shuhet kurrë
- **Selim Sula**, ambasadori shëtitës i Elez Isufit
- Gjaku i **Isuf Murres** si gjak dovleti
- Ikja nga kjo jetë, që ndërpreu përvjetorin e 65 të martesës

Rënia e çmimit të kromit çon drejt kolapsit galeritë e Bulqizës

Nga: **SAMI CURRI**

Agimi* ka afro 20 vite që punon në galeritë e kromit të Bulqizës, por deri tani nuk kishte parë një krizë të tillë. Ai aktualisht punon si armator në një prej galerive e të ashtuquajturës zona D, nën kontrollin e një kompanie koncesionare dhe tregon se ka tre muaj që nuk paguhet. *(Lexoni në faqen 4)*

Ç’kemi asaj Dibre!

Nga: **BUJAR KAROSHI**

Pas shumë muajsh ndërprerje të kësaj rubrike, po rinis me Presidentin. Jo se është i pari i vendit, por se e kemi “majkun ma t’majr”. Dhe “majkut t’majr” i pritet berri, i bahet fli e petulla e i jepet vend n’krye t’vendit...

Presidenti Meta ishte këtë muaj në Dibër. Rrugës u ndal te Ura e Topojanit. Për të bërë ca foto mbi Drin dhe për të parë urën e re të Edi Ramës, aty ku priten të mblidhen votat në prillin e ardhshëm... *(Lexoni në faqen 2)*

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Në foto: Pamje nga by-passi i Rrugës së Arbrit, shtator 2020.

Ç’kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Pas shumë muajsh ndërprerje të kësaj rubrike, po rinis me Presidentin. Jo se është i pari i vendit, por se e kemi “majkun ma t’majr”. Dhe “majkut t’majr” i pritet berri, i bahet fli e petulla e i jepet vend n’krye t’vendit...

Presidenti Meta ishte këtë muaj në Dibër. Rrugës u ndal te Ura e Topojanit. Për të bërë ca foto mbi Drin dhe për të parë urën e re të Edi Ramës, aty ku priten të mblidhen votat në prillin e ardhshëm. Ndërsa po firmoste edhe dekoratat, sepse nuk kishte pasur kohë, a prej inatit për Ramën, a prej erës që frynte, të gjitha dekoratat ranë në Dri... “Ehu, - tha, tani, unë nuk merrem me to, kush të dojë të hidhet dhe t’i kapë”. Ca dibranë dolën në Katund të Ri dhe i kapën dekoratat, ca në Muhurr, ca në Fushë-Alie, të tjerë në Zall-Dardhë. I mori kush i mori - por thonë se ca të tjerë kaluan Urën e Dodës dhe përfunduan në Ujmisht, e mandej në Liqenin e Kukësit. Në Kukës nuk ka me lajme nëse u hodh ndokush për ta marrë dekoratën, apo e hëngri luçiperka...

Aq shumë e mërzitën Presidentin dibranët, sa ai anuloi edhe raftingun. Kishte frikë mos mbytej në Dri...

Presidenti, kur pa që ca intelektualë të gjallë e të vdekur u mërzitën që nuk morën dekorata, i qetësoi dibranët: “Sa të keni dhëndrin në Presidencë dhe Bujarin kryetar të Shoqatës, plot me tituj e dekorata do ta mbush Dibrën”...

Pas një viti në pushtet ia arriti qeveria të ndërtojë një rrugë në Radomirë... Rrugët e tjera mbushen me dhè, veç kur kalon ndonjë drejtues shteti... Me këtë ritëm në pesëdhjetë vitet e ardhshme do t’i ndërtojmë të gjitha rrugët - sigurisht nëse nuk ndërtohet Skavica...

Skavica deri më tani është ndërtuar 3-4 herë në letra e projekte. Ndalo të parin e ndërto të dytin, veç lekë për projekte njoftohen se dalin. Ca dibranë duan të ndërtohet, ca të tjerë duan të mos folet. Por shkon si shkon puna, Skavica i ka rrëzuar ca qeveri...

Si çdo vit, edhe këtë vit, pati zjarre në pyje e kullota. Jo nga temperaturat e larta, por nga kurioziteti i lartë: merr zjarr a jo me një fije shkrepëse... Dhe pastaj mund të bësh edhe ca foto të përpjekjeve për t’i shuar me kazma e lopata...

Meqë jemi te zjarret, ia vumë edhe fushës së plehrave. A nuk themi shpesh se plehrat duhen djegur?

Vitin tjetër kemi zgjedhje në pranverë. Në PD kanë filluar votimet. Ata që fituan online, nuk u futën fare në listë, ndërsa ata që humbën në listë, i shpallëm armiq menjëherë pas votimit... Armiq të tjerë priten të dalin në tetor, ndërsa në prill do dalin bashkëpunëtorë e bashkëfajtorë për humbjen e radhës...

Te PS kanë shpëtuar nga ky siklet: listat akoma i bën kryetari nga lart, me *sms* nga populli poshtë...

Meqë jemi te zgjedhjet, na e mori qeveria një deputet: nga 6, na bëri me 5. Ta kishte ulur më mirë në 4, se kështu si e kanë vendosur, na kanë hequr mundësinë e barazimit...

Meqë po flitet shumë për listat e hapura, janë hapur fare edhe listat e kandidatëve... Kanë filluar dibranët elozhet për Dibrën, kush e kush mundët ta lëvdojë më shumë... Në çdo tre dibranë, njërit duhet me qan se s’ban deputet, qoftë edhe në Skrapar, ndryshe rrofshin listat!

Ky vit ishte i vështirë edhe në Dibër. Kovid-i shkon e vjen, por dibranëve as ua ndjen. Plot bulevardi, plot edhe festat.

Kovidi ka futur në punë qeverisjen vendore. E kanë hequr maskën nga fytyra dhe e kanë vënë te goja. Se çfarë thonë e se çfarë bëjnë, e di veç facebooku... Për të tjerat nuk lejohet asnjë informacion, derisa të ikë Kovidi...

Meqë jemi të Kovidi, zbuluam sa të varfër kishte në qytet e në katunde. Mbushur plot makinat me ndihma katund e katund e lagje më lagje, e mbushur plot facebooku me falenderime e lavde. Rrofsh, o Kovid, që zbulove bamirësinë tonë!

Kovidi nuk ka sjellë vetëm panik e frikë. Ka sjellë edhe rritje të të ardhurave nga gjobat... Jo vetëm për kafetë dhe lokalet e dasmave, por edhe për ahengjet në oborret e shtëpive...

Kovidi në Dibër ka ndaluar çdo veprimtari... Ndryshon puna kur shkon Presidenti a kryeministri...

Një lajm i ditëve të fundit thoshte se janë rritur të punësuarit në katër bashkitë e qarkut... Tani u bë më e vështirë të gjesh se kush nuk punon në bashki... Sepse ata që punojnë, nuk ndihen, veç kur vjen fushata. Thuhet se kështu të punësuarish ka edhe në ca institucione të tjera, por ato do të merren vesh nëse ndodh rotacioni...

Viti i ri shkollor filloi dhe me këtë rast u zbulua se rrogën më të mirë e merr mësuesi që jeton në... Londër...

Në Dibër nisi viti shkollor me protestë. Nuk e duan mësimin online. Online duan vetëm diplomat...

Kanabis herë pas here i shkulin nga një rrënjë. Dhe para se t’i shkulin, policia njofton se ka arrestuar shkronjat e para të emrit dhe mbiemrit. Me emër e mbiemër njofton veç OFL-ja...

Turizmi këtë vit ishte i dobët shumë... Hashtagu #PushoShqip duket se nuk hyri në punë. Nuk ishte shkruar dibrançe, thanë ca zëra lokaliste...

Në Bulqizë gjithçka shkon normalisht... Minatorët punojnë, por kromi nuk po shitet...

Në fund e di që keni merakun për rrugën, por mos u shqetësoni: Do ta hapim vitin tjetër me by-pass. Rruga me by-pass është si i sëmuri me zemër: rriten rrahjet e zvogëlohen, por jeta vazhdon, plot adrenalinë...

Pandemia Covid-19 preku thuajse çdo sektor të ekonomisë. Por më e ndjeshme ishte situata në sektorin e turizmit që Shqipëria është shumë më e varur, si prej turistëve që vijnë nga jashtë, por edhe nga shqiptarët e trevave në Kosovë e Maqedoninë e veriut. Fushata e fundit “Pusho Shqip” për të stimuluar atë që quhet “turizmi patriotik”, mund të ketë mbushur plazhet, por në zonat malore, nuk duket një situatë e ngjashme. Sektori i turizmit në Dibër, vitet e fundit po merrte një zhvillim edhe më të madh. Shumë struktura akomoduese janë ngritur në këtë zonë për t’ju shërbyer turistëve vendas dhe të huaj. Por pandemia covid-19 i ka vënë në situatë të vështirë bizneset që operojnë në fushën e turizmit malor dhe atë kurativ në ujërat termal, një problem zinxhir edhe në ekonominë e zonës.

Nga **SAMI CURRI**

Dibra çdo vit edhe më shumë ka pasur një rritje të numrit të turistëve të huaj, por edhe vendas. Destinacioni kryesor është mali i Korabit, që ndahet mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Maja më e lartë është në Shqipëri me 2764 metra dhe rrethohet nga parku kombëtar me të njëjtin emër. Falë një destinacioni të tillë, në këtë zonë janë ngritur një sërë strukturash akomoduese dhe shërbimesh, si një bazë shumë e rëndësishme e ekonomisë së zonës. Por që prej fillimit të pandemisë Covid-19, në këtë zonë janë të pakët turistët e huaj dhe vendas që zgjedhin ta vizitojnë malin e Korabit.

Grehans Uka, që prej më shumë se 6 vitesh punon si udhërrëfyes, kryesish me turistët që vizitojnë Dibrën, tregon se këtë vit, shumë pak turistë zgjedhin të vizitojnë Dibrën. Kjo për shkak të pandemisë dhe frika krijuar tek të huajt. Uka tregon për gazetën “Rruga e Arbërit” se në këtë periudhë të një viti më parë, Korabi mund të vizitohej nga afro 2000 turistë në një javë. “Këtë vit, për rezervimet për bujtinat atje dhe guidat numri i turistëve arrin deri në 500 persona. Pra 25% e totalit të një viti më parë të turistëve që vijnë në këtë zonë. Kjo situatë është shumë e keqe për guidat dhe për bujtinat”, shprehet Uka.

Edhe zyra për informimin e turistëve në Peshkopi ka mbyllur dyert, kjo sa për mungesë të stafit, por edhe për shkak të mungesës së turistëve për t’u informuar në një qendër të



“Një viti më parë Korabi vizitohej nga afro 2000 turistë në javë. Këtë vit, për rezervimet për bujtinat atje dhe guidat numri i turistëve arrin deri në 500 persona”

Grehans Uka - guidë turistike

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 8-9 (170). Shtator 2020
Gazeta doli nga shtypi, 2 tetor 2020.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit tetor 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Avni ALCANI
Leonard VEIZI
Ballsor HOXHA
Bajram XHAFA
Arif MURRJA
Haki Përnezha
Mevlud BUCI
Nazmi KOÇI
Halil RAMA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Korabi, maja më e lartë është në Shqipëri me 2764 metra dhe rrethohet nga parku kombëtar me të njëjtin emër. Falë një destinacioni të tillë, në këtë zonë janë ngritur një sërë strukturash akomoduese dhe shërbimesh, si një bazë shumë e rëndësishme e ekonomisë së zonës. Por që prej fillimit të pandemisë Covid-19, në këtë zonë janë të pakët turistët e huaj dhe vendas që zgjedhin ta vizitojnë malin e Korabit.

Covid-19 "kyç" industrinë e turizmit

tillë. Nga Zyra e Turizmit në Bashkinë Dibër thanë për gazetën se "kjo është një situatë e vështirë për bizneset që operojnë në fushën e turizmit dhe të akomodimit".

"Ne kemi pasur disa projekte të aplikuara në Dibër, mbështetur edhe nga organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë. Çdo vit kemi pasur një trend në rritje të turistëve që vizitojnë Dibrën dhe pritshmëritë tona për këtë vit ishin vërtetë të larta. Por pandemia përmbysi gjithçka" u shpreh një specialiste e turizmit në Bashkinë Dibër. Ulja e numrit të vizitorëve ka prekur edhe Muzeun e Dibrës dhe Muzeun e Kastriotëve. Specialistët e muzeologjisë tregojnë se "vizitorët e këtij viti janë shumë të pakët dhe se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, muzeu kishte vizita nga të huajt dhe pushuesit vendas që vizitonin Dibrë". Kjo shifër shkonte deri në afro 3000 vizitorë vjetorë në statistikat e muzeut.

Të përdorura shumë në Dibër dhe jo vetëm, jufkat, janë makarona artizanale të pregatitura vetëm me miell, vezë dhe qumësht. Dashurie Zerja, fillimisht merrej vetëm me prodhimin e jufkave. Prej kësaj pune dhe jo vetëm, biznesi i familjes së saj u zgjerua me "Bujtinën e Jufkave", një restorant dhe disa dhoma hoteli. Edhe pse në një kohë dreke, në këtë restorant nuk të zë syri asnjë tavolinë të mbushur me klientë. Zerja na tregon se e vetmja punë që ka në këto ditë gushti është me ato klientë që ka në Dibër për tregtimin e jufkave, ndërsa rezervimet nga të huajt dhe turistët vendas thuajse janë anuluar të gjitha.

"Sa për pjesën e bujtinës, pritshmëritë kanë qenë zero. Në bujtinën tonë, të huaj as që bëhet fjalë gjatë kohës së pandemisë e deri më sot. Vetëm shumë pak turistë nga Shqipëria", tregon Zerja.

"Bujtina e Jufkave" është një biznes thuajse familjarë. Teksa bisedon me ta, kupton se gjenden përballë një vështirësie, teksa shohin që biznesi i tyre ngritur me shumë mund dhe me disa grante të qeverisë për nxitjen e turizmit në zonë, është thuajse i boshatisur dhe pa punë. Zerja tregon se mbijetesa e bizneseve të shërbimeve dhe të hotelerisë vetëm me tregun lokal është e pamundur, pasi ekonomia e zonës është shumë e dobët. "Ne kemi pak besim tek tregtimi i jufkave me të cilat mund të punojmë. Ndërsa sa për turizmin, pritshmëritë janë shumë të ulëta" tregon Zerja.

Në të njëjtën situatë ndodhen edhe ato pak bujtina që janë hapur në Bulqizë. Lulzim Hupi, pas kthimit nga emigracioni në Greqi, prej disa vitesh, kullën e familjes së tij mbi 200 vjeçare e ka kthyer në bujtinë. Lulzimi tregon për gazetën "Rruga e Arbërit" se thuajse të gjitha ato prenotime që ishin për vitin 2020 janë anuluar, me shpresën që ndoshta me qetësimin e situatës prej pandemisë së Covid-19, në vjeshtë të ketë një kthim të vizitorëve.





"Ka ndikuar shumë sepse ky biznes është rritur duke ardhur të huajt dhe ne aktualisht që flasim nuk kemi pasur asnjë vizitor dhe të gjitha prenotimet janë anuluar. Dhe nuk besoj se do të ketë prenotime të reja për arsye të situatës të krijuar nga pandemia. Nëse vazhdohet me një gjendje të tillë, do të jetë e vështirë mbijetesa dhe mbajtja hapur e bujtinës.
Lulzim Hupi, Bujtina "Hupi"

"Ka ndikuar shumë sepse ky biznes është rritur duke ardhur të huajt dhe ne aktualisht që flasim nuk kemi pasur asnjë vizitor dhe të gjitha prenotimet janë anuluar. Dhe nuk besoj se do të ketë prenotime të reja për arsye të situatës të krijuar nga pandemia", shprehet Hupi. Nëse vazhdohet me një gjendje të tillë, Lulzimi tregon se do të jetë e vështirë mbijetesa dhe mbajtja hapur e bujtinës. "Ky është një vit shumë i vështirë, jo vetëm për biznesin e familjes sime, por edhe për fshatarët, sepse si biznes është një ndihmesë edhe për familjet rreth e përqark nesh. Kështu nuk mund të rezistojmë shumë gjatë e do të detyrohemi ta mbyllim e ta kthejmë në shtëpi, siç ka qenë përpara" tregon Hupi.

TURIZMI BALNEAR NË PRAG TË MBYLLJES

Rruga që të çon nga pazari në Peshkopi deri tek llixhat, nuk ka qenë me e boshatisur se këto ditë gushti. Si pjesë e turizmit balnear, në rrethin e Dibrës rolin kryesor e luajnë ujërat termale të Peshkopisë. Turizmi kurativ paraqitet më i zhvilluar në këtë qark si nga numri i turistëve, hoteleve, të punësuarve në këtë sektor, të ardhurave etj. Aktiviteti kurativ mendohet të ketë filluar që në vitet 1600, kur janë përdorur nga krahina dhe më gjerë në mënyrë të vazhdueshme për efektet kurative. Rreth viteve 1870-të filluan të përdoren dhe të mirëmbahen nga komuniteti i krahinës. Rreth vitit 1928, u ndërtua i pari hauz me mbulesë, që filloi të përdoret me pagesë nga bashkia e qytetit, ndërsa në vitin 1953 filloi shfrytëzimi shkencor i tyre dhe ndërtohet i pari mjedis për larje me vaska si dhe hoteli pranë tyre për të shtruarit. Në vitin 1989 ndërtohet një kompleks modern, i pari në Shqipëri, me vaska dhe kabinete terapie të veçanta. Me kalimin e viteve, kjo industri mori një zhvillim shumë të madh. Kapaciteti ditor i frekuentuesve në një situatë normale është 2500 -3000 banjo. Muajt më të frekuentuar (dhe më të preferuar) janë prilli, maji, qershori, shtatori dhe tetori. Por faza e parë e llixhave ishte e bllokuar nga pandemia Covid-19 dhe të gjitha hotelet dhe shtëpitë private ishin të mbyllura. Ndërsa sot janë të hapura jo më shumë se 4-5 hotele akomoduese.



Mbyllja e llixhave të Peshkopisë ka një efekt zinxhir në të gjithë ekonominë e zonës. Thuajse të gjitha ato pak biznese në lagjen e llixhave ishin të mbyllura. Në këtë sektor përllogariten më shumë se 100 të punësuar në qytetin e Peshkopisë. "Një efekt zinxhir në të gjithë qytetin që ka prekur të gjithë qytetin nga mungesa e turistëve në llixhat e Peshkopisë. Ne pranverën e quajmë të humbur, por nëse do të kemi një valë të dytë të Covid-19, për ne do të ishte shkatërrimtare, por edhe për qytetin" shprehet Çipuri.

Shumica e sipërmarrësve në këtë fushë e kanë mbyllur aktivitetin deri në fazën e dytë të llixhave, me shpresën që nuk do të këtë ndonjë mbyllje të dytë të vendit.

Shkëlqim Çipuri, që prej vitit 2011 ka hapur një prej hoteleve më të mëdha në këto zonë, në akomodimin e personave që qëndrojnë për llixha në Peshkopi. Në hotelin e tij gjetëm të akomoduar vetëm 5 persona që po trajtoheshin në ujërat termale. Çipuri tregon se ky vit ka qenë një dështim total, pasi pjesën më të madhe kanë qëndruar të mbyllur.

"Për biznesin tonë, ky vit ka qenë shkatërrimtar në aspektin ekonomik. Të gjitha rezervimet kanë qenë një herë të anuluara nga ana jonë kur ishte vala e mbylljes, periudha prill – maj. Sepse me llixha e Peshkopisë, dy janë periudhat kur ka më së shumti turistë, prill-maj-qershor dhe pas shtatorit. Me shtimin e numrit të rasteve, ishte një ndalesë e dytë, jo më nga shtetit, por klientët që filluan anulimin e rezervimeve, kjo për shkak të frikës nga pandemia", shprehet Çipuri për gazetën.

Mbyllja e llixhave të Peshkopisë ka një efekt zinxhir në të gjithë ekonominë e zonës. Thuajse të gjitha ato pak biznese në lagjen e llixhave ishin të mbyllura. Në këtë sektor përllogariten më shumë se 100 të punësuar në qytetin e Peshkopisë. "Një efekt zinxhir në të gjithë qytetin që ka prekur të gjithë qytetin nga mungesa e turistëve në llixhat e Peshkopisë. Ne pranverën e quajmë të humbur, por nëse do të kemi një valë të dytë të Covid-19, për ne do të ishte shkatërrimtare, por edhe për qytetin" shprehet Çipuri.



Rruga e Arbërit nr. 170

Shumë minatorë që po vuajnë mungesën e pagës shprehen se nuk kanë protestuar dhe as kanë denoncuar pranë institucioneve shtetërore, me shpresën se dita-ditës kjo situatë do të marrë zgjidhje. Paga nga galeritë është shpesh i vetmi burim të ardhurash për shumë familje në Bulqizë, ku shumë gra punojnë si seleksionuese të mineralit.

Rënia e çmimit të kromit çon drejt kolapsit galeritë e Bulqizës

Mbi 30 kompani që kanë koncesione në Martanesh dhe Bulqizë kanë bërë shkurtime dhe kanë vonuar prej muajsh pagat për minatorët për shkak të rënies së çmimeve të kromit në bursa, duke zhytur në varfëri qindra familje që mbajnë frymën gjallë me punën nëntokë.

Nga: **SAMI CURRI**



Miniera e Bulqizës | Foto : Sami Curri

Agimi* ka afro 20 vite që punon në galeritë e kromit të Bulqizës, por deri tani nuk kishte parë një krizë të tillë. Ai aktualisht punon si armator në një prej galerive e të ashtuquajturës zona D, nën kontrollin e një kompanie koncesionare dhe tregon se ka tre muaj që nuk paguhet.

Punëdhënësi i ka thënë se nuk po e shesin dot mineralin që kanë nxjerrë për shkak të rënies së çmimit të kromit në tregjet ndërkombëtare.

"Fëmijët në shtëpi, nuk duan shumë të dinë nëse është shit kromi apo jo, por duan që të hanë," thotë ai.

Eltjon Deda, administratorë i dy kompanive që operojnë në këtë fushë, thotë se kriza filloi në pranverë të vitit 2018, kur çmimet e kromit ranë nga 250 USD për ton në rreth 140 USD.

Ai shpjegoi se tani kromi i cilësisë së mirë me 42% mineral shitet për 140 USD për ton, por shumica e galerive nxjerrin mineral me cilësi më të dobët, ndërsa për çdo pikë ulje në cilësi, çmimi ulej me 10 USD.

"Aktualisht jemi në periudhën që me një çmim të tillë, prodhimi është nën koston e nxjerrjes," shprehet Deda.

Një zyrtar i Inspektoritatit të Punës në Dibër i tha BIRN se rreth 30 kompani të vogla minerare kishin probleme me pagat, por numri i punëtorëve të prekur nuk ishte i qartë.

BIRN mësoi gjithashtu se të tjera kompani planifikonin të mbyllnin galeritë në të cilat punonin në vjeshtë, në qoftë se çmimi i shitjes së mineralit nuk do të rritej.

Institucionet e ndihmës sociale shprehen se gjatë muajve të fundit ka pasur një rritje të punëtorëve që kanë aplikuar për pagesën e papunësisë dhe të familjeve në ndihmë ekonomike.

Kriza në sektorin e minierave rrezikon të zhysë në krizë ekonomike të gjithë zonën. Sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, AKBN, gjatë vitit 2018, në galeritë e kromit punonin 3170 punonjës, ose rreth 1 në çdo 10 banorë të Bulqizës sipas censusit të vitit 2011. Kjo është pjesa dërrmuese e krahut të punës në qytet.

E ndërsa një pjesë e subjekteve po futen në muajin e katërt që nuk paguajnë pagat e punëtorëve, pasojat ekonomike kanë filluar të ndjehen në ekonominë e qytezës minerare. Shumë nga pronarët e kafeneve dhe ushqimoreve në lagje tregojnë se lista e borxheve po shtohet çdo ditë edhe më shumë.

MINATORËT PËRBALLEN ME PAQARTËSI

Besmiri, ka afro 8 vite që ka lënë emigracionin në Greqi dhe u vendos së bashkë me bashkëshorten dhe dy fëmijët tek prindërit në Bulqizë. E vetmja punë që mund të gjente në vendlindje ishte në minierë.

Ai thotë se viti i fundit ka qenë shumë i vështirë, pasi kanë hyrë në muajin e tretë që nuk i kanë marrë pagat.

"Ne jemi në këtë bela ka më shumë se tre muaj, gjithë kjo e shkaktuar me justifikimin që nuk kemi shitur kromin," tha ai. "Po se çfarë na duhet ne a është shit kromi në Durrës, a jo," shtoi Besmiri.

Minatori tha se disa vite më parë, edhe pse çmimet e kromit ishin 400 USD për ton askush nuk u dha atyre ndonjë shpërblim apo shtesë page.

"Ne, në gjithë këto vite me nga 20 mijë deri në 24 mijë lekë në ditë kemi punu," kujtoi ai. "Edhe këto tani nuk po na i japin," shtoi Besmiri, pa dhënë emrin e kompanisë ku punonte, për shkak të frikës se mund të penalizohej.

Minatorët tregojnë se ka shumë prej tyre që kanë shkuar edhe deri në përplasje fizike me administratorët e galerive për shkak të pagave që nuk janë paguar.

Të tjerë i thanë BIRN se kishin marrë kredi në banka dhe institucione financiare të vogla, të cilët po e rrisin presionin çdo ditë edhe më shumë për kështet e kredive të papaguara.

Për Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, SMBB, minatorët që nuk kanë marrë pagat prej 3 muajsh, janë duke luftuar për mbijetesë.

"Pa transparencë e përgjegjësi, një pjesë e madhe e pronarëve të këtyre galerive justifikohen se nuk po arrijnë dot ta shesin kromin e mbledhur. E prapëseprapë puna vazhdon përditë, krom nxirret e transportohet njëlloj si më parë," shkruhet në reagimin e postuar në rrjetin social Facebook.

SMBB i bën thirrje institucioneve shtetërore që të marrin masa për një problematikë të tillë.

"Askush nuk e di se ku shkon e sa shitet kromi i nxjerrë nga duart e sakatuara të minatorëve, por kuptohet lehtë se ka një problem që të pushtetshmëve të zonës nuk u intereson ta zbardhin," thuhet në reagimin e SMBB.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për 11 muajt e parë të vitit 2019-të, Shqipëria eksportoi krom dhe çimento në vlerën e 15.5 miliardë lekë ose rreth 126 milionë euro.

ASNJË ZGJIDHJE NË HORIZONT

Kompania më e madhe e nxjerrjes së kromit në vend, Albchrome – që ka rreth 700 punëtorë, nuk ka pasur probleme me dhënien e pagave. Por BIRN mësoi se disa prej kompanive të vogla rrezikojnë mbylljen në shtator.

Dy drejtues kompanish me të cilët BIRN foli kërkuan ndërhyrje të qeverisë. Ata pretenduan se vetëm përmes uljes së taksave apo të paktën shtyrjes së tyre në kohë, një pjesë e kompanive kishin mundësi të mbijetonin.

Presidenti i Kompanisë "Dema Patine", Edmond Isaku, tha se kompanitë koncensionare të nxjerrjes së kromit po përjetojnë një krizë të thellë likuiditeti dhe në një situatë të tillë rrezikojnë falimentimin.

"Kjo krizë është shumë shqetësuese pasi në këtë situatë do të ketë një përkeqësim të bilanceve financiare të kompanive," tha Isaku.

"Nëse do ta përmblidhja në pikat kyçe të krizës janë vështirësi të mëdha në pagesën e faturave, pagave të punonjësve dhe të detyrimeve tatimore, pa përjashtuar edhe detyrimet portuale," shtoi ai.

Eltjon Deda, administratori i kompanive Kevger dhe Isaku sh.p.k – që operojnë në zonën krom-mbajtëse D të Bulqizës, tregon se aktualisht po përballen edhe me një rënie të rezervave minerare, çfarë ka sjellë rritje të kostos për nxjerrjen e kromit nga nëntoka.

Për Dedën qeveria do të ndihmonte nëse do të pezullonte për një periudhë të caktuar kohore pagesën e detyrimeve karshi institucioneve shtetërore.

"Këtu flas jo që shteti t'i fali si detyrime, por që të jenë një borxh i akomuluar, ku në momentin që situata merr një drejtim më pozitiv, të fillojnë të shlyhen pak nga pak," tha ai, duke sugjeruar shtrirjen në kohë të pagesës së rentës minerare.

Ndërsa Isaku kërkoi që ndihma nga qeveria të ishte edhe më e madhe.

"Të hiqet ose të ulet në 2 % renta minerare; të ulen shpenzimet portuale; të mos vihen sanksione tatim-fitimi," theksoi ai, ndërsa shtoi se "këto probleme nuk janë vetëm për Bulqizën, por në të gjithë Shqipërinë ku ka subjekte minerare."

Isaku gjithashtu kërkoi një marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për pagesën e sigurimeve, për një afat 6 mujor.

"Kjo do të na jepte mundësinë për të mbajtur numrin aktual të punonjësve, për të mos shkurtuar vendet e punës ku humbin pagesën mijëra familje," nënvizoi ai.

BIRN iu drejtua edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për koment mbi situatën dhe ndërhyrjet e mundshme, por deri në publikimin e këtij shkrimi nuk mori përgjigje.

KRIZA SOCIALE

Shqipëria është e njohur për potencialin e lartë të mineralit të kromit. Burimet kryesore shtrihen në Bulqizë, Martanesh dhe Klos, por edhe në juglindje dhe rajonin qendror. Rezervat e kromit në Shqipëri janë të një cilësie që luhatet nga 15% deri në 48%.

Por megjithë këtë pasuri Bulqiza është një nga qytetet më të varfër në vend dhe me shumë probleme sociale, që pritet të thellohen për shkak të krizës në miniera.

Zyra e ndihmës ekonomike në Bashkinë Bulqizë i tha BIRN se krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë afro 300 familje më shumë që po trajtohen me ndihmë ekonomike.

Zhuljeta Deda, drejtuese e zyrës së çështjeve sociale, tregon se një rritje e tillë e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, vjen kryesisht si pasojë e krizës në sektorin minerar.

"Në Bulqizë, pjesa më e madhe e familjeve e kanë një të punësuar në minierë," tha Deda, ndërsa shtoi se një krizë në këtë sektor jep ndikim të menjëhershëm në ekonominë e qytetit.

"Ne jemi munduar që me pagesën e ndihmës ekonomike, të ndihmojmë sadopak në zbutjen e këtij problemi," theksoi ajo.

Rritje e personave që kërkojnë ndihmë raportoi edhe Zyra Vendore e Punësimit në Bulqizë. Jetmira Doda, nga ZVP Bulqizë shprehet për BIRN se që nga fillimi i muajit shkurt, është regjistruar një tendencë në rritje e personave që paraqiteshin për trajtim me pagesë papunësie.

"Kjo si shkak sepse disa subjekte minerare, të cilat kishin probleme në shitjen e kromit, kishin shkurtime në stafin e punës," tregoi Doda.

Shumë minatorë që po vuajnë mungesën e pagës shprehen se nuk kanë protestuar dhe as kanë denoncuar pranë institucioneve shtetërore, me shpresën se dita-ditës kjo situatë do të marrë zgjidhje. Paga nga galeritë është shpesh i vetmi burim të ardhurash për shumë familje në Bulqizë, ku shumë gra punojnë si seleksionuese të mineralit.

Flutura është një prej tyre. Ajo që prej vitit 2007-të punon si seleksionuese kromi dhe ka bashkëshortin minator në një galeri.

"Vetëm aty ke puna ime, janë largu shumë," tha ajo, ndërsa shpjegoi se pasi kanë filluar problemet me pagat një pjesë e punëtoreve e kanë lënë punën duke u ankuar se "po punojmë e po lodhemi e lekët nuk po i marrim."

Flutura thotë se është detyruar të qëndrojë në punë me shpresën se një ditë do të kompensohet për mundin, pasi familja e saj nuk ka ekonomi për të përballuar situatën.

"Ne me këtë rrogë jetojmë. Ja mbajmë një muaj. Por muajin tjetër ne jemi me listë tek dyqani," shpjegoi ajo.

"E dimë që puna në galeri është shumë e rrezikshme, por ne me atë punë kemi bukën, fëmijët për të rritur," përfundoi ajo.

**Emrat e minatorëve në artikull janë ndryshuar nga redaksia, për të ruajtur identitetin sipas kërkesës së tyre.*

Marrë nga www.reporter.al

reportazh



"O mirë se na erdhe!"

Nga **ILMI DERVISHI**

Të udhëtosh nga Tirana drejt Dibrës, vendlindjes, çdo herë ndjehesh mirë, aq më shumë që ky udhëtim është për festë, festën e Ansamblit Artistik "Kuvendi i Zall Dardhës", ku do këndojnë e hedhin valle artistët më të mirë të Dardhës, aty në vendlindjen e artistëve.

Këshilli Bashkiak i Dibrës ka vendosur datën 1 gusht si Festa e Kuvendit të Zall-Dardhës, por për shkak të pandemisë, këtë vit festa u shty për në shtator.

Makina gulçon sapo le pas "Rrugën e Kombit," aty në Skuraj, një rrugë e vështirë, një rrugë me pak investime për të mos thënë e lënë pas dore nga gjitha qeveritë.

Nuk ka kohë për kafe. Nxitojmë që të shkurtojmë kilometrat. Por telefoni nuk pushon. "A u nise? Ku je? Ku do ndalojmë për kafe?"

Te "Tre Çezmat e Zerqanit", kur e shohim se jemi mirë me kohën, ndalojmë për kafen dhe bashkohemi me grupin tjetër të udhëtarëve në vendlindje.

Në Peshkopi, në bulevardin "Elez Isufi" që në orët e para të mëngjezit kishte shumë dernjanë. Dikush kishte udhëtuar natën e të tjerë herët në mëngjes, të cilët së bashku me familjet e tyre nga Tirana e Durrësi, Lezha e Shijaku, mezi po e presin festën në Zall Dardhë. Nuk ka pasur ftesa emër për emër, por ftesës publike të bërë në facebook nga "Ansambli Kuvendi i Dardhës" i janë përgjigjur të gjithë. Si dikur, në "Kuvendin e Dheut", 99 vite më parë...

"O MIRË SE NA ERDHE!"

Sheshi në qendër të Zall Dardhës ishte gati për festë. Ishte rregulluar një skenë provizore ku do të këndohej e do hidhej valle. Megjithëse dernjanënt, kur vjen puna për këngë e valle, nuk kanë nevojë për skenën...

"O mirë se na erdhe" është shkruar në ballë të skenografisë, si për te evokuar një kohë të shkuar, ku mikpritja, kënga, vallja, alegoria ishin gjithçka për jetën buzë Drinit e mes maleve.

Ka 25 vite që ky shesh nuk ka patur kaq shumë njerëz, dernjan e të ardhur dhe nga fshatrat përreth. Madje edhe nga jashtë shtetit. Instrumentisti dhe këngëtari Muharrem Elezi vjen nga Kreta vetëm për këtë festë. Valltari virtuoz i ansamblit Lazam Sula ka ardhur posaçërisht nga Durrësi bashkë me familjen, me vëllain Isufin, një intelektual i njohur; Agim Cani, intelektuali dhe biri i Dardhës, që ka bërë shumë për vendlindje bashkë me familjen, inxhinieri Ismail Hysa, avokati Hasan Bara, poeti Ramadan Topuzi, burri i Dardhës Muharrem Gjoka, e shumë e shumë të tjerë.

Dernjanët janë sederli dhe merakosen deri në detaj për mbarëvajtjen e aktivitetit, por ardhja e Presidentit Shqipërisë, z. Ilir Meta , i jep një rëndësi më të veçantë.



BESNIK TRASHËGIMISË, KODIT KRAHINOR DHE IDEALIT KOMBËTAR

Presidenti Meta i shoqëruar nga autoritetet vendore, përfaqësues të forcave politike dhe qytetarë, vizitoi fshatin e Zall Dardhës, ku vendosi një tufë me lule tek Obeslisku "Kuvendi i Dardhës 1921", si dhe mori pjesë në koncertin festiv të organizuar nga shoqata atdhetare "Kuvendi i Zall Dardhës", ku edhe vlerësoi disa nga personalitetet më të shquara të kësaj treve.

"Të lidhur fort me doket, zakonet dhe pasurinë shpirtërore të parëve ju i keni qëndruar besnik trashëgimisë, kodit krahinor dhe idealit kombëtar", tha në fjalën e tij Presidenti Ilir Meta. "Jo pa kuptim ata kuvendin e tyre të burrave e quajtën " Dheu ", për të treguar, se si Anteu ata e marrin bekimin dhe fuqinë e tyre prej tokës që i lindi dhe rriti".

"Tradita e Kuvendeve në Reç e Dardhë, është një ndër shembujt më të shquar të përgjegjësisë atdhetare, të organizimit dhe qeverisjes vendore. Ajo konsiderohet si trashëgimia më e mirë e vlerave atdhetare të zonës", tha ai.

Presidenti, mes të tjerash, tha se "në këto kuvende u rritën e u formuan disa nga figurat më të rëndësishme të Dibrës, por edhe të mbarë kombit shqiptar si: Elez Isuf Ndreu, Isuf Xhelili e Dali Ndreu, si dhe plot figura të tjera të njohura e të respektuara si: Baftjar Doda, Cen Elezi, Hasan Marku, Hysen Vladi, Sul Marku, Sheh Halimi, Mahmut Laçi, Ramadan Cani, Merë Troci, Mehdi Kaca, Rrahman Mziu, Sheh Ymeri, Rrahman Rasha, Hysni Kaca, Selim Lila, Selman Ahmeti, e shumë të tjerë".

Më pas, Presidenti vlerësoi Ansamblin e Zall Dardhës, si "simbolikë të madhe për ruajtjen dhe përsosjen e folklorit shqiptar". "Artistët popullorë të këtij ansambli janë një shembull i madh i pasionit, përkushtimit dhe mbartës të vlerave folklorike të një treve me tradita ndër më të shquarat atdhetare".

Kreu i Shtetit vlerësoi me Titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" Qerim Sulën (pas vdekjes) dhe Liri Jushi (Rasha), ndërsa me Titullin "Mjeshtër i Madh" Sherif Dervishin, Xhelal Çerpjen (pas vdekjes), Shaban Mziun, Sajhe Poleshin, Xhelil Ymerajn, Lutfi Ndreun dhe Halil Ramën.

Me titullin "Për Merita të Veçanta Civile" Presidenti i Republikës dekoroi Neshat Ndreun dhe Agim Canin.

KASTRIOTI...

Një makinë me targa angleze, sa po kalon portën e shkolles së vjetër, ra në sy për shpejtësinë saj.

"Është Kastrioti - thanë, - Kastrioti i Medi Dervishit. Ai gjatë gjithë kohës filmonte me telefonin e tij. Arriti te ura, aty ku ka kaluar fëmijërinë. Kastioti u lind në Xhoxhe, u shkollua në Sllovë, dhe pas vitit 1990 u shpërngul me familje në Tiranë, pastaj në Greqi si emigrant e për 15 vite jeton me familjen në Angli. Gjatë gjithë koncertit, ishte gjithë kohës në këmbë, duke kërcyer. Duartroktiste me shumë zemër për të gjithë artistët, por më shumë për Lirie Rashën, vajzën e dajës së babait. E takon shpesh në sebepe e gëzime familjare, e ndjek nga ekrani i vogël i televizorit apo YouTube, por këtu sot është ndryshe. Bashkë me emocionet e duartrokitjet ndjen dhe rrahjet e zemrës. "Me Lirien vërtet na lidh gjaku, - thotë Kastrioti, - por sot më shumë se kurrë na lidh arti".

KUTIA E DUHANIT ËSHTË E MIKUT

Kur po interpretohet "Vallja e Kuvendit", vallja që i ka dhënë edhe emrin Ansamblit, kutia e duhanit kaloi nga njëri valltar të tjetri, ashtu të ulur këmbëkryq. Por valltari i fundit zbret nga skena, dhe i shoqëruar nga presidenti i Ansamblit Kuvendi, Neshat Ndreu, ia dhanë kutinë Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta. Ishte një gjetje e bukur, por surpriza ishte se valltari i valles së Kuvendit ishte një djalë i talentuar nga Skrapari... Sepse ansambli nuk është veç i Dardhës e dernjanëve, por është i gjithë shqiptarëve.



PESHKOPI

Vlerësim për figurat atdhetare dhe kulturës popullore



Gjatë ceremonisë solemne të organizuar para Pallatit të Kulturës së Peshkopisë, Kreu i Shtetit çmoi me "Dekoratën e Flamurit Kombëtar", më të lartën në Republikën e Shqipërisë, atdhetarin Elez Isuf Ndreu (pas vdekjes); me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" Ahmet Camin (pas vdekjes); ndërsa me Dekoratën "Nderi i Kombit" Edip Tërshanën (pas vdekjes) dhe Hazis Ndreun (pas vdekjes).

Me titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" Presidenti Meta dekoroi kompozitorin, orkestruesin dhe producentin muzikor Edmond Zhulali, si dhe artistin e mirënjohur Arif Vladi, ndërsa me Titullin "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", Muharrem Xhedikun (pas vdekjes). Me titullin "Mjeshtër i Madh" u vlerësua Përparim Tomçini (pas vdekjes), Behar Mera, Vera Duka (Laçi), z. Isak Shehu dhe z. Hysen Ndreu.

"Për shqiptarët Dibra është shumë e shtrenjtë, siç është edhe Atdheu për dibranët. Ajo ka qenë dhe mbetet një nga epiqendrat më spikatura dhe më të flakta të shqiptarizmit dhe betejave për liri!", tha presidenti i Republikës në përshëndetjen e tij. Pasi evokoi luftën e dibranëve për liri e pavarësi në shekuj, Presidenti u ndal edhe në problemet e aktualitetit.

"Kjo trevë e kaq e bukur, me këtë histori dinjitoze, me këtë panoramë mahnitëse dhe me këtë popull me kaq virtyte nuk duhet të braktiset më!", tha ai duke iu referuar braktisjes së vendit nga të rinjtë.

"Ky shpopullim është i dhembshëm, pasi braktisja e këtyre krahinave tradicionale që kanë qenë burimi i identitetit tonë kombëtar edhe kulturor, mund të jetë fatal për të gjithë kombin. Ndaj është momenti që të gjithë të kthejmë më shumë vëmendjen ndaj ruajtjes jo vetëm të vlerave më të mira të kulturës e identitetit tonë kombëtar, por mbi të gjitha të njerëzve në këto troje! Në mënyrë të veçantë të rinisë.".

"Cilësitë e civilizimit dibran sikurse janë organizimi i kuvendeve, alegoria e komunikimit si dhe rregullat kanunore qytetare të trevës së Dibrës përbëjnë shembuj të një shoqërie të emancipuar dhe përcjellin edhe sot mesazhe dinjiteti, progresi dhe zgjuarsie të veçantë popullore", tha Presidenti i Republikës në Peshkopi.

I.D.

Rruga e Arbërit nr. 170

Nder dhe krenari për Hazis Ndreun, të cilit Presidenti Meta i akordoi dekoratën "Nderi i Kombit".
Mirënjohje të thellë për Neshat Ndreun e Avni Ndreun që i dhanë jetë Ansamblit "Kuvendi".

Presidenti i Republikës Ilir Meta vizitoi Muzeun e Kastriotëve në Sinë

Nga **HALIL RAMA**



Tridhjetepesë vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës, një vizitë impresionuese këtu në vendorigjinën e Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e kreut të shtetit shqiptar Ilir Meta, do të shërbente për ripërtëritjen e traditës së kësaj zone. Një ditë historike kjo, pasi referuar pikërisht veprës madhore të prof.Kristo Frashërit "Historia e Dibrës", që qëndron hijerëndë përkrah busteve të Gjon, Pal e Gjergj Kastriotit në hyrje të Muzeut, presidenti Meta, ashtu si edhe elita historike e kombit që vizituan këtë muze para dy vitesh, do të "legjitimonte" këtë fshat si vendorigjinë e kastriotëve.

Historiani i njohur dibran Haki Përnezha, në rolin e ciceronit, ndër të tjera do t'i bënte të njohur vizitorit më të rëndësishëm të këtij muzeu atë që ka lënë si testament Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të: "Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm..." (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr).

Besnik Këbej, ish-drejtor i shkollës 8-vjeçare Sinë, autor i librit "Origjina dibrane e Skënderbeut", që kishte ardhur pas tridhjet vitesh në vendin ku shërbeu dekada të tëra dhe që dha kontribut të çmuar në ngritjen e këtij muzeu, do të sillte në kujtesë kohën kur këtu erdhën për të parën herë profesorët e nderuar të historisë Stefanaq Pollo e Kristo Frashëri.

"Pasi i kisha njoftuar me telegram për gjetjen nga nxënësit e shkollës të një medalioni bronxi me diametër 9 cm, me emblemën e Skënderbeut, profesorët Pollo e Frashëri udhëtuan më këmbë 6 orë, që nga Lura për në Sinë, për të bërë ekspertizën e këtij medalioni. Më pas, nën ndikimin e tyre, do të ishte kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Dibrës Skënder Dema që do të urdhëronte ngritjen e këtij muzeu",-thotë ndër të tjera Besnik Këbej.

Ndërsa Presidenti Meta shprehet se njohja e trashëgimisë dhe rrënjëve kombëtare është thelbësore për të ardhmen eropiane të vendit. "Sot (18 shtator 2020) në Sinë, në truallin e Kastriotëve, vendin e origjinës të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Kënaqësi të vizitoja Muzeun Historik dhe të njihesha nga afër me të dhëna interesante për betejat heroike të zhvilluara për mbrojtjen e kombësisë, territorit dhe identitetit tonë europian. Të bëhet zemra mal kur sheh djemtë dhe vajzat e Dibrës të lartësojnë traditat dhe vlerat tona duke na bërë të ndihemi krenarë! Thelbësore që rinia jonë të njohë rrënjët kombëtare, për të mbrojtur më mirë të ardhmen europiane të Shqipërisë",- deklaron Presidenti Meta.

Neshat Ndreu, organizatori i festës së 18 shtatorit në Zall Dardhë

Organizimi i veprimtarive festive të datës 18 shtator 2020 në Zall Dardhë, ka një emër. Ai është Neshat Ndreu - President i Shoqatës "Ansambli Kuvendi Zall Dardhë". Nëse para një viti, me rastin e 70-vjetorit të këtij Ansambli, Neshati organizoi një koncert festiv në pallatin e Kulturës Kamëz, ku ky ansambël u dekorua nga Presidenti Meta me Urdhërin "Naim Frashëri" të Klasit I, këtë 18 shtator festa mori karakter gjithpërfshirës. Pas afro një muaj përgatitjesh dhe takimesh intensive me këshilltarë të Presidentit Meta, Neshat Ndreu finalizoi projektin e tij, duke dekoruar-personalitetet më të shquara të këtij ansambli. Po ashtu, meritë e tij është dhe organizimi i koncertit madhështor që u shfaq në qendër të Zall Dardhës, si dhe darka festive në oborrin e shtëpisë së tij të origjinës po në Zall Dardhë, me praninë e kreut të shtetit SHT Z.Ilir Meta, autoriteteve vendore të Dibrës: kryebashkiakut Imeraj e Prefektit Shehu etj.

Kësisoj historia riciklohet. Atë që bënë burrat e shquar të Dardhës, para shtatë dekadash, duke themeluar Ansamblin Kuvendi, me në krye shumëtalentuarin Hazis Ndreu, po e ripërtërin Neshat Ndreu-President i Shoqatës "Ansambli Kuvendi Zall Dardhë", të cilin kreu i shtetit e dekoroi me Titullin "Për merita të veçanta civile" - titull ky që u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për merita të veçanta civile në Republikën e Shqipërisë.

Janë të rrallë burrat si Ai, që edhe në këto kohë të vështira kontribuojnë për ringjalljen e traditës. Realizimi prej tij i vizitës së Presidentit Meta në Zall Dardhë ku u vlerësuan me dekorata të larta artistët më të mirë të kësaj treve: Xhelal Çerpja, Qerim Sula e Sherif Dervishi (pas vdekjes), si dhe Liri Rasha, Sahje Poleshi, Halil Rama, Xhelil Imeraj, Lutfi Ndreu, Shaban Mëziu, Neshat Ndreu e Agim Cani është shembull frymëzimi për të gjithë ata që duan të promovojnë e trashëgojnë traditat e shkëlqyera të Dardhës.



Presidenti Meta duke dekoruar personalitete të etnografisë, folklorit dhe muzikës popullore shqiptare në Zall Dardhë vlerësoi Dibrën si simbol të qëndresës së shqiptarëve, që ka qenë përherë djepi i luftërave patriotike për liri dhe identitet kulturor. Në ceremoninë solemne të organizuar me këtë rast kreu i shtetit vuri në dukje se ndihet i lumtur që gjendet në Zall Dardhë, në fshatin me histori të madhe të luftërave për liri, por dhe në krahinën e artistëve, rapsodëve dhe valltarëve të famshëm për mbarë kombin!

H.Rama

PROBLEMATIKA

Shpopullimi i Dibrës është i dhimbshëm

Bahçja e fermerit Shefki Prifti në Sinë të Dibrës, një parajsë e vërtetë! Në këtë vend të begatë, perlë e natyrës, vetëm dy kilometra sipër luginës pjellore të Drinit të Zi, që ka përballë Korabin dhe sipër Runjën hijerëndë e kreshnike, për herë të parë në këto tridhjet vjet vjen Presidenti i Republikës. Dhe Shefki Prifti, një ndër kuadrot e njohur në gjithë Dibrën e pret atë sipas traditës dibrane. Në oborrin mahnitës të shtëpisë së tij janë mbledhur dhjetra fermerë të kësaj zone. Kuvendojnë ata shtruar me kreun e shtetit për "braktisjen qeveritare" të kësaj zone me histori të lavdishme. Ndër të tjera, më i moshuari, Besnik Kaloshi, përçues i denjë i mençurisë dhe filozofisë popullore dibrane do të shprehej se "Skënderbeu e ka lënë të hapur që prej gjashtë shekujsh rrugën e tij nga Sina për në gjithë Shqipërinë, por kjo copë udhë (vetëm dy kilometra nga ura e Arrasit) ka nevojë të asfaltohet e mirëmbahet që këtu të mund të vijnë vizitorë nga e gjithë bota".

Dhe ndërsa ka provuar shijen e rakisë, rrushit, dardhës, kumbullës e të mjaltit të sdapo dalë nga hojet e bletëve të Shefki Priftit, gjatë kuvendimit me vendasit, Presidenti Meta tha se "shpopullimi i Dibrës është i dhimbshëm, pasi sipas tij braktisja e këtyre krahinave tradicionale që kanë qenë burim i identitetit tonë kombëtar e kulturor, mund të jetë fatal për të gjithë kombin".

Dhe vërtetë ndjen dhimbje kur sheh të braktisura këto vise me bukuri të rrallë natyrore, të cilat me pak investime mund të kthehen në një destinacion turistik tërheqës për vizitorë të shumë vendas e të huaj. / ***H.R.***



"Skënderbeu e ka lënë të hapur që prej gjashtë shekujsh rrugën e tij nga Sina për në gjithë Shqipërinë, por kjo copë udhë (vetëm dy kilometra nga ura e Arrasit) ka nevojë të asfaltohet e mirëmbahet që këtu të mund të vijnë vizitorë nga e gjithë bota".

opinion

VLERËSIM I MERITUAR PËR GAZETARIN

Halil Rama merr titullin "Mjeshtër i Madh"

Tre prej librave më të arrirë artistikisht të Halil Ramës, monografitë: "Një legjendë në kufirin e dy kohëve", "Gjenerali që sfidoi kohërat" dhe "Muhurri, histori dhe personalitete, janë botime te Shtëpisë Botuese "M&B"



Nga **SHPENDI TOPOLLAJ**

Nuk më duket shumë serioze, reagimi i ndokujt, që sa herë Presidenti i Republikës, dekoron figura të shquara të historisë; luftës, punës, artit, kulturës a sportit, nisin nga qesëndisjet, duke aluduar se ai e bën këtë për të shtuar radhët e përkrahësve të tij. Kjo tingëllon sa anadollake aq edhe disi qesharake, po të kemi parasysh se atributi i dekorimeve atij i është dhënë, dhe nga ana tjetër në Shqipëri ka mjaft njerëz që meritojnë të nderohen për cilësitë, vlerat, virtytet, ndershmërinë, përkushtimin, dhe kontributet në shërbim të Atdheut dhe popullit tonë. Qortimi duhet të orientohet nga mos ushtrimi sa duhet i kësaj të drejte, e cila synon për të ngjallur në popull optimizëm, krenari, nxitje për të ndjekur shembullin e më të mirëve. Prandaj, u gëzova kur këto ditë zoti President vlerësoi në Zall - Dardhë të Dibrës, njerëz të shquar të asaj treve, që i kanë dhënë lavdi asaj. Dhe akoma më shumë, u ndjeva mirë kur midis tyre pashë emrin e miku tim, njeriut të mrekullueshëm, gazetarit e shkrimtarit të palodhur, demokratit dhe atdhetarit të urtë Halil Rama që ju dha titulli "Mjeshtër i Madh".

Ky titull i lartë iu dha autorit të 17 librave monografikë (H.Rama), në një manifestim festiv të komunitetit artistik të Zall Dardhës, me prezencën e autoriteve vendore dhe elitës intelektuale dibrane: "Për kontributin e shquar si shkrimtar, skenarist e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Dibrës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar" (motivacioni i dekoratës).

Jo pa qëllim ishte përzgjedhur Zall Dardha për të vlerësuar shkrimtarin dhe publicistin Halil Rama, si dhe artistët më në zë të kësaj treve Liri Rasha, Qerim Sula, Xhelal Çerpja, Sherif Dervishi, Sahje Poleshi, Lutfi Ndreu, Xhelil Imeraj, Neshat Ndreu, Agim Cani, etj. "Halil Rama ka shkruar dhe promovuar monografi e dokumentarë për artistë të përmasave kombëtare të kësaj treve, si për kompozitorin e tangos shqiptare Muharrem Xhediku, ikonën e artit e kulturës kombëtare Hazis Ndreu, regjisorin dhe aktorin e shquar Skënder Cala, për Lutfi Ndreun – mësues dhe artist, etj, të botuara këto edhe në gazetën "RRUGA E ARBËRIT".

Në 17 librat e tij (letërsi dokumentare) Halil Rama prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltyra që të mbeten në kujtesë. Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërmbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht.

Konti rus Leon Tolstoi duke folur për punën është shprehur se "Pa punë njeriu nuk mund të ruajë dinjitetin njerëzor. Prandaj njerëzit bosh kujdesen për madhështinë e jashtme". E solla këtë thënie të mençur, pasi më duket më i merituari për Halil Ramën, i cili në çdo vend ku ka punuar, ka mbetur po ai; i thjeshti, kokëuluri, dashamirësi, i qeshuri, fjalëpaku, pajtuesi dhe përherë, i palodhuri. Kjo është dhe arsyeja përse ky gazetar e shkrimtar i pa bujë është kaq dinjitoz, dhe ka aq shumë miq e shokë, gjë që bije në sy menjëherë në vaprimtaritë që organizon me shokët e tij, ku gjithmonë salla do të jetë e mbushur, me pjesëmarrës të të gjitha fushave. Nga viti 2003 që Halil Rama drejton gazetën "Veterani" organ i OBVL, çdo lexues ka gjetur në shkrimet e botuara, evokimin e ngjarjeve madhore të Kombit, përpjekjet për liri në shekuj, epopenë e lavdishme të Luftës Nacional - Çlirimtare, rolin e atyre që drejtuan formacionet partizane, kujtimin e dëshmorëve që dhanë jetën për atdhe,ndeshjen me bishën serbe të UÇK - së në bashkëpunim me Forcat e NATOS, ndikimin e SHBA në pavarësinë e Kosovës, dëmin që si kudo edhe te ne solli ideologjia komuniste, dhe kurrë nuk mund të gjesh një rresht të vetëm që të mbjellë përçarje. Halilin, intuita e ka orientuar drejt madhështisë së një burri të papërsëritshëm, Heroit të Popullit, Nderit të Kombit, gjeneral - leitnant Rrahman Parllakut. Ai ka parë te ky personalitet i rrallë, genin shqiptar, të cilin nuk e thyen padrejtësitë e kohës, vuajtjet fizike dhe shpirtërore, nuk ja mpinë qartësinë e gjykimi as vitet e gjata të burgut dhe as dramat familjare, dhe që nuk i lejoi asnjëherë vetes që tëngrinte kokë ndjenja e hakmarrjes. Halili e lançoi staturën e tij prej patrioti të madh, brenda mundësive që lejonte arti gazetaresk dhe shkroi monografi të shkëlqyer për gjithësa ai bëri si drejtues ushtarak, politikan dhe Kryetar i OBVL. S`duhet harruar se edhe vetë i ndjeri dhe i paharruari Rrahman Parllaku, e donte me gjithë shpirt Halil Ramën dhe e merrte kurdoherë me vete, kudo që shkonte anë e kënd vendit. Por me fisnikërinë e shpirtit të tij, Halili ka lartësuar dhe përjetësuar në shumë e shumë libra, plot burra e gra që nuk kursyen asgjë për popullin e vendin e tyre. Nga ana tjetër, Halili, jo vetëm si gazetar me përvojë, por edhe si jurist, bën analiza të fuqishme në faqet e shumë gazetave të përditshme, duke u paraqitur si një opinionist vizionar e me kurajë dhe aspak partiak. Për Halil Ramën e para është Shqipëria. Ai gjithmonë ka pasur për devizë thënien e poetit salaminas Euripidit "O, kurrë mos u lodh për ndihmën që i jep Atdheut!" Ndaj dhe Atdheu e shpërblen birin e tij me atë titullin e lartë "Mjeshtër i Madh", si mirënjohjeje.



OPINION

Eh sikur kështu të fliste për Drinin edhe në Zallë-Dardhën që mbytet Presidenti!

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Presidenti ynë Ilir Meta ishte në Zallë- Dardhë të Dibrës.

Piu, këndoi sa u ngjir këngën "veshur me fustan jeshil", foli "pa maskë" dhe zbrazi një thes me dekorata.

Poshtë rridhte Drini i Zi në shtratin e tij mijëravjeçar; i pastër, i virgjër, shtrat historik i betejës së parë të Gjergjit të Gjon Dibranit, betejës së Torviollit më e njohura në historinë e Shqipërisë dhe të botës ku osmanlinjtë në kulmin e lavdisë morën goditjen e parë të madhe, dhe më së afërmi betejën e Lanë Lurës, tetor 1921, që mbyti në Drin armikun më të betuar të trojeve shqiptare në Verilindje, serbo-jugosllavët.

Nuk e pashë a lexova të flasë për këto dhe në se dërgoi ndonjë nga punonjësit e tij të verë një tufë me lule në muzeun e Skënderbeut në vendlindjen e tij, Sinë, apo të ngjiteshin rrëpirës së Lashkizës e Qanit dhe të vendosnin një tufë me lule në lapidarin e shkatërruar të betejës madhore të Maleve të Dibrës, Betejës së Lanë-Lurës, obligim për përkujtim madhështor në mos më shumë, por sa 100 vjetori i Vlorës, vitin e ardhshëm, në 100 fitores historike të saj..

Drini i Zi, sipas deklaratave të Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, në janar të vitit 2021 do të kthehet në liqen. Skavica do të përmbytë trevën më me histori të vjetër dhe të re, Dibrën. Drini i Zi, nga momenti që niveli i ujit arrin kuotën maksimale në digën e Skavicës, shuhet, i harrohet emri.

Nëmja e plakave për fëmijët plëngprishës "Tu harroftë emri" do të bie mbi një lum e mbi një luginë me emër.

Nuk do të ketë më emër "Drini i Zi" dhe as "Lugina e Drinit të Zi" sepse as lumi dhe as lugina nuk do të ekzistojnë fizikisht...

Presidenti Meta nuk iu kundërvu Ramës (siç bën në çdo rast) për Skavicën, mbytjen e Dibrës, shuarjen e lumit Drini i Zi, luginës pjellore e historike të tij.

Nuk iu kundërvu as si president dhe as si dhëndër i Dibrës.

Dy ditë më vonë presidenti u pa në Vjosë, në një fjalë të ashpër kundër Ramës dhe në një fjalim plot ndjenjë për virgjërinë e Vjosës dhe lënien e saj si e ka krijuar Zoti e shpalljen Park Kombëtar.

Bashkohem me të dhe i përkulem me respekt. Si specialist i natyrës, i tokës dhe gjelbërimit dua që asnjë pëllëmbë e gjelbër të mos preket, mos betonohet, mos hidhen themele, mos përmbytet.

Dua që edhe pjesa që ka mbetur e Drinit të Zi, pjesa më pjellore e luginës së tij, të mbetet ashtu si e ka krijuar Zoti.

Desha që presidenti im të thoshte në Zallë-Dardhë po ato fjalë që tha për Vjosën dje në Qendrën Ndërkombëtare Shkencore për të.

Po e përshtas me ndryshim emri, nga Vjosë në Drini i Zi, fjalimin e presidentit...

"Është kënaqësi të takohemi së bashku këtu në Zallë-Dardhë për një ngjarje mjaft pozitive, përurimin e Qendrës Kërkimore Ndërkombëtare për Drinin e Zi. Hapja e kësaj Qendre Kërkimore ndërkombëtare është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit mes Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Universitetit të Vjenës dhe Universitetit të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës në Vjenë, Austri (BOKU). Dëshiroj t'i falënderoj këto universitete për dedikimin e tyre për çështjen e lumit Drini i Zi dhe njëkohësisht dhe Kryetarin e Bashkisë Dibër z. Dionis Ymeraj, për mbështetjen e vazhdueshme që japin kësaj kauze!

Qëllimi i krijimit të kësaj Qendre është ofrimi i infrastrukturës për zhvillimin e studimeve shkencore në luginën e lumit Drini i Zi dhe formalizimi i bashkëpunimit mes 3 universiteteve themeluese.

Ne zhvilluam dje në Tiranë, Tryezën e Rrumbullakët për të ardhmen e lumit Drini i Zi me pjesëmarrjen e shumë personaliteteve të shquara dhe shkencëtarëve nga vende të ndryshme të Evropës.

Dua të vë në dukje kontributin e tyre të jashtëzakonshëm dhe përpjekjet e vazhdueshme në mbrojtje të lumit Drini i Zi.

Lumi Drini i Zi është një pasuri natyrore kombëtare por edhe ndërkombëtare, që ne kemi fatin ta kemi këtu, por që në të njëjtën kohë është i rrezikuar nga planet për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Edhe pse në kohë të vështira, siç jemi tani në situatën e COVID-19, jemi mbledhur për të diskutuar mbi këtë çështje të rëndësishme në një moment kyç për të ardhmen e luginës së Drinit të Zi – para lëshimit të Deklaratës mjedisore nga Ministria e Mjedisit për hidrocentralin e Skavicës.

Unë shpresoj që qeveria të marrë në konsideratë serioze si peticionin e nënshkruar nga 776 shkencëtarë nga e gjithë botë, në mbrojtje të lumit Drini i Zi, ashtu edhe konkluzionet e nxjerra nga tryeza e djeshme, që iu dorëzuan Presidentit të Republikës dhe që do të dërgohet pranë të gjitha institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me këtë çështje.

Unë do të vazhdoj të mbetem në mbështetje të nismës në mbrojtje të lumit Drini i Zi, dhe ky aktivitet, i organizuar në këto dy ditë, është vetëm i pari i shumë të tjerave, që do të organizohen në mbështetje të kësaj kauze, por dhe kauzave të tjera që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Uroj dhe shpresoj që tryeza e djeshme dhe hapja sot e Qendrës Kërkimore Ndërkombëtare për Drinin e Zi, të mundësojnë e lehtësojnë dialogun e munguar mes shkencëtarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve, duke bërë të mundur që të dëgjohet zëri i shkencëtarëve që studiojnë lumin Drini i Zi prej vitesh!

Zhvillimi i qëndrueshëm i vendit arrihet vetëm duke rritur vlerat e pasurive të tilla të jashtëzakonshme siç është lumi Drini i Zi dhe lugina e tij, duke mbështetur ekonominë e gjelbër, duke zhvilluar agro-turizmin dhe ekoturizmin në zona me vlera të rralla natyrore siç janë ato të Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Lurës, Korabit etj.

E ardhmja e Drinit të Zi nuk mund të jetë kurrsesi shkatërrimi i tij përmes ngritjes së hidrocentraleve, por shpallja si Park Kombëtar, duke sjellë kështu impakt pozitiv dhe zhvillim të qëndrueshëm për zonën dhe komunitetin për sot dhe për gjeneratat e ardhshme."

I kërkoj ndjesë zotit president që tjetërsova emrin "Vjosa" në "Drini i Zi" dhe emrin "Kalivaçi" me emrin "Skavica".

Besoj se do ta pranojë ndjesën sepse e din se sa i dashuruar jam pas Drinit të Zi dhe luginës së tij dhe se sa e urrej mbytjen e Dibrës nga ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës.

Athinë, 25 shtator 2020

Rruga e Arbërit nr. 170

histori

Elez Isufi dhe Suf Xhelili, në kohën e tyne, kanë pasë qenë të njoftun kështu me këtë identitet, tue u përmendum në këtë mënyrë në popullsinë e vendit.

ELEZ ISUFI dhe SUF XHELILI

Nga **Tahir KOLGJINI***

Elez Isufi dhe Suf Xhelili, origjinën e kishin nga katundi Dardhë i Dibrës, qi turqt, në kohë të vjetra i thojshin Debre i Zir, dmth. Dibra e Poshtme. Këta, ishin agjë e nip. Xhelil Isufi dhe Elez Isufi, qenë vëllazën. Sufa, pra, qe i biri i Xhelilit dhe gjithmonë krah i djathtë i Elez Isufit.

Kjo familje, nga pikëpamja materiale, ishte largue prej katundit Dardhë dhe ishte vendue në rajonin Sllovë thuejse gadi në rranëz të Korapit, afër katundeve Sllatinë, Kallë dhe Vleshë; sepse, ky rajon, jo veç përbahej prej tokave ma pjellore, por, edhe prej tokave të shkreta, dmth. të pa zot. Veç kësaj, banorët e këtyne krahinave, me qenë se me shumicë, ishin shtektarë, dmth. gurbetçij, tue frekuentue Stamboll e Anadoll, si të tillë, mund të thuhet se, ishin pak ma t'urtë se krahinat e quejtuna Malsi, krahinë, në të cillën bânte pjesë edhe katundi Dardhë.

Elez Isufi dhe Suf Xhelili, në kohën e tyne, kanë pasë qenë të njoftun kështu me këtë identitet, tue u përmendum në këtë mënyrë në popullsinë e vendit. Me gjithë këtë, ata, zotnojshin mbiemnin «Ndreu» në katundin e tyne në Dardhë. Si duket, ky mbiemën, iu ka mbetun prej kohëve shum të vjetra, kur të parët e tynë, kanë qenë katolikë. Kësisoji në Shqipni, sidomos në malsina, ka shum mbienna katolikë si Markaj, Lleshaj, Peposhaj, Kolaj, Kolgjin e tjerë.

Simbas mendimit t'em, banorët e Dibrës, të Mates, të Krujës, të Merditës, të Lumës e përgjithësisht të Vilajetit të Shkupit, qi shkrojën "i" e përdorin "aj", "ej", bâjnë pjesë nga popullsija e vjetër e Maqedonisë. Kështu merret vesht si nga historija e gjermanit Droysen e titullueme «Leka i Madh» ashtu dhe nga vepra frengisht «Arnavutlar ve Arnavutluk» Vasa Pasha. Banorët e naltpërmendun, edhe bashkëtinglloren e përngjitun «PL» e shqyptojnë «Ç», f.v.: Plak = Çak.

Në volumin e II. të «Historia e Popullit Shqiptar», tue i qendrue besnik përdorimit të fjalës në botën arabe dhe turke, përdoret në trajtën «Jusuf», kurse populli i krahinës së vet, e përdorë me "I", Elez Isufi. Emni Jusuf, Isuf, âsht nji emën i vjetër i mbetun prej hebrejve dhe përdoret ne forma të ndryshme: Jusuf, Isuf, Josef, Giuseppe, Zef e tjera.

Edhe «Suf Xhelili», emnin e plotë e ka «Isuf», por, nji rrokje ia kanë hiekun dhe ky emën, ka mbetun «Suf». Gegënija, e ka zakon me i shkurtue emnat. Pra, kur thomi Ramë, Dan, Rexhë, Xhepë, Lil e tjera, kemi për qellim me përmendum Ramadanin, Rexhepin, Halilin e tjera.

Tash, po vijmë te Elez Isufi dhe Suf Xhelili.

Elez Isufi, më kujtohet në katër perioda:

I.

Sikurse e kam pasë shpjegue në SHEJZAT N. 4-6 të vjetit 1969 me artikullin t'em «Luma dhe luftat e saja», artikull, i cilli, si i shtrydhun nga revista e naltpërmendun, qe botue dhe në formë libri, Elez Isufi, në vjeshtën 1912, pat bashkëpunue me Lumën për kundra okupatorit serb.

Në parathanje e shenova se, Elez Isufi, rranjët i kishte nga katundi Dardhë i Dibrës së Vogël. Ky katund, dmth. Dardha, përherë ishte si i bashkuem me katundin Reç po të Dibrës, i cilli, âsht shum i shpërndamë dhe përbahet thuejse prej ma tepër se katërqind shtëpijash. Këto dy copë katunde, për shkak të bashkëpunimit të ngushtë me njeni-tjetrin përmendeshin së bashku: Reç e Dardhë ...

Elez Isufi, shkonte shum mirë si me Dardhnjanë ashtu dhe me Reças. Dhe kur i thirrte për ndonji nevojë, banorët e këtyne katundeve, e kishin për lavdi me iu përgjegjun, mbassi Elezi, si nga pikëpamja e mendarisë, ashtu dhe nga pikëpamja e gjallënimit dhe e djelve ishte Agaj i krahinës.

Në kohë, për të cillën duem me folun, Lumën me Dibrën e dante Veleshica, nji lum, qi zbret nga bjeshka e Korapit. Tash, më duket regjimi i sodshëm në Shqipni, disa katunde, qi përmenden me emnin Qafa, ose Nahije të Lumës iau ka mbathun Dibrës. Pra, Reç e Dardhë dhe katundet tjera afër Lumës, ishin - dhe janë - të përziem me njani tjetrin me anën e krushqise dhe të kumbarisë. Të mirën e të keqen e kishin të përbashkët.

Âsht vjesht e vjetit 1912. Luma, vendosë me bâmë nji kryengritje kundra ushtrisë okupuese serbe, e cilla, asht vendosun në Bicaj, qi âsht kryevendi i Lumës. Parësija e Lumës, merret vesht me Elez Isufin e me ndonji tjetër nga parësija e katundeve pranë.

Elez Isufi, me rasën e disfatës së Turkisë në luftën e Ballkanit, na paska pasë mbajtun nji top me disa gjyle dhe na paska pasë strehue nji tetshe ushtarë turq. Elezi, me tetshen ushtarë, me top dhe me banorët e katundeve Reç e Dardhë e ndonji tjetër prej katundeve të Dibrës, shkon në katundin Kolesjan të Lumës. Ky, âsht katundi i Islam Spahisë, i cilli, ishte mullari i Lamës së kryengritjes. Ky fakt historik, vërtetohet dhe me kangën popullore:

«.....»

«Reç e Dardhë ranë n'Kolesjan.»

«..... në Bican.»

Fillon lufta në befasi. Ushtrija serbe e hutueme prej topit dhe prej mësymjeve të popullsisë në shum anësh dhe në nji mot shum të keq, shterret dhe luftëtarët kryengritësa, çlirojnë Lumën tue asgjasue nji divizion t'ushtrisë anmike.

Në dëshroftë ndokush ndonji shpjegim ma të gjanë rreth kësaj ndodhine historike, mundet me iu drejtue artikullit «Luma dhe luftat e saja».

Për kujtim të kësaj lufte dhe të luftëtarëve pjesëmarrësa e trima, po mbaj pesë minuta heshtje dhe po notoj nji pjesë të kangës, qi e quej si kryevepër:

«Po rrjedh Shéja plot me gjak».

«Po i thotë Drinit: - Ndihmom pak!»

I I.

Ishte Gushti i vjetit 1920. Aty kah medisi i muejit bâhet nji mbledhje në katundin Arras të Dibrës dhe më dalin Ramiz Dibra e Ramiz Daci, të dy këta, personalitete të njoftuna e prej Dibre.

Kjo mbledhje, s'ka dyshim se, âsht bâmë me sugjerimin e Qeverisë Shqiptare t'asaj kohe, mbassi po n'atë vjetë ishte zhvillua lufta e Vlonës për kundra forcave ushtarake italiane qi kishte përfundue me ngadhnim. Sugjerimi i Qeverisë për nji veprimtari, provohet dhe nga nji letër turkisht drejtue nga Ahmet Zogu, Alush Agë Lumës, letër, të cillën e kam pasë këndue unë vetë dhe qi do të bâj fjalë mbi 'te këtu ma poshtë.

Mbledhja n'Arras, vendosë qi populli i Dibrës, t'ia filloje kryengritjes kundra ushtrisë serbe - jugosllave -, e cilla, tue pasë kalue kufinin e caktuem në vjetin 1913, ishte sistemue për Drin të Zi, me qëllim sigurimi, mbassi lumi Drin, përbante nji vijë mbrojtjeje natyrale për çdo sulm qi eventualisht mund t'i drejtohej nga Shqipnija, ose nga Italija. Drini, ishte nji vijë strategjike për Jugosllavinë.

Mbledhja e Dibrës n'Arras, në këtë kryengritje komandën ia ngarkon Elez Isufit. Dhe kishte të drejtë, mbassi Elez Isufi, për veç qi ishte me randësi në Dibër, tue pasun nji rreth shum të gjanë, por, për sa i përket njij ndeshjeje civile, ishte edhe shtatmadhuër me openga. Ishte në gjendje me e trazue popullin dhe me e futun në luftë me mjeshtërinë e tij.

Kërset lufta, në gjymës të Gushtit 1920. Elez Isufi, shliron Dibrën e Vogël. Suf Xhelili, tue pasë me vehte nji pjesë të dibranëve, në bashkëpunim me Osman Mustaf Litën e me popullin e Nahije-s, iu bijnë komandave serbe dhe çlirojnë 12 copë katunde të Lumës, tue mbërrijtun deri në Lerat e Sorrave të katundit Lusën (katundi i em).

Në katundin t'em në Lusën, ndodhet Alush Agë Luma me njimijë zaptije, të cillët, janë të regjistruem me rrogë për mbajtjen e qetësís së Lumës.

N'atë kohë unë, nuk i kishem mbushun të 20 vjetët. Prandej, në punët e shtëpisë dhe në çâshtje të jashtme, ishem vetëm si spektator. Të gjitha punët i endte dhe i pralmendte em atë, rahmet i pastë shpirti.

Baba, nji ditë, më thotë: - «Sod, në shpinë t'onë kanë me pasun nji takim Alush Aga me Mus Preçin prej Reçi». Ishte para dreke.

Erdhi Alush Aga vet' i treti. Pak ma vonë erdhi edhe Mus Preçi vetëm dhe me nji armë në krah. Mbassi u përshëndetën zakonisht n'odë të miqve, baba, Alush Agën dhe Mus Preçin i hypi në pod të sipërm të kullës dhe i la vetëm për vetëm qi të bisedojnë lirisht.

Mbas njij kohe, të dy zbritën dhe si hangrëm drekë, Musa, u nis për kah kishte ardhun dhe Alushi, shkoi ma vonë. Se ç'patën bisedue, nuk dij. Vetëm se Alush Aga, para se të shkonte, mue më dha nji letër për t'a këndue, mbassi vetë, nuk dinte me këndue.

Letra në fjalë, ishte e shkrueme turkisht e në Tiranë, dhe me nji orthografi të bukur. Përmbante nji shkrim me germa të vjetra turkisht, mbassi n'atë kohë, Turkija enë nuk i kishte pranue germat latinisht. Letra, n'emën t'interesave kombtare e këshillonte Alush Agën qi sa të jetë e mundun, të mos bâhet vegël e Jugosllavisë në ndeshjet eventuale dhe i epte premtime personalisht për t'ardhmen.

Letra, përmbante nënshkrimin «A. Zogu».

Kjo letër, e bâni ndikesën e vet në mënyrat e poshtëshënueme:

A) Autoriteti jugosllav, e urdhnoi Alush Agën qi me forcën e vet të dale përtej Drinit të Zi me luftue kundër fuqive kryengritëse. Mirëpo, Alush Aga, nuk iu bind këtij urdhni, tue thanun se:

- «Unë, qysh në fillim i kam pasë pranue këto 1000 armë me konditë qi të shërbej mbrenda katër kufijve të Lumës, tue mos u angazhue me luftue përjashta Lumës me asnji forcë tjetër. Dhe jam gadi me i dorëzue armët, qi m'i keni dhanun».

Në fakt, Alush Aga, i dorëzoi krejt armët, tue i bâmë truç në Bicaj dhe shkoi në shpi të vet. Mbi këtë, vendin e Alush Agës, e zuni nji farë Mahmut Rexhep Bulica prej katundit Kolesjan, i cilli, me forcat e veta, kapërcei Drinin; por, fuqinat shqiptare, e pritën ashpër, tue i dhanun nji pushkë të thântë dhe këthei në Lumë si ma zi.

B) Luma, ma përpara që damë më dyshë: Nji palë, ndiqshin politikën shqiptare dhe nji pjesë tjetër me Alush Agën, akuzoheshin si serbofila. Kjo përçamje vazhdoi shum vjet. Mbi këtê Jugosllavija, dergoi trupa ushtarakë, dogj e poq katundet e Dibrës e të Nahijes së Lumës dhe ngrehi topat në Gjurrë të katundit Kalisë te shpijat e Mahmut Markut dhe filloi me rrahun Tejdrinen, atje n'ato vende, ku ndodheshin fuqina kryengritëse shqiptare si Reçin, Dardhën, Lurën e tjera vende. Popullsija, kush mundi, duel përtej Drinit me qellim qi të vejë për Tiranë. N'udhtim e sipër, në Selitë, disa prej tyne, u plaçkitën dhe nja katër vetë, u vranë prej selitasve, mbassi nuk u bindën me iu dorëzue gjanë e gjallë.

Në përkim me këtë çâshtje kam shkrue në Shejzat e vjetit 1969, në «Luma dhe luftat e saja».

III.

Nuk po më kujtohet data ekzakte e tërhjekjes së trupave jugosllave nga Dibra e nga Luma për në kufinin e 13-tës. Do të jetë aty kah fundi i vjeshtës së vjetit 1921, ose kah fillimi i dimnit 1922. Gjithashtu nuk munda me hasun në ndonji shenim nga librat dhe revistat, qi kam në dorë. Ka randësi data 9 Nanduër 1921 e shenueme në faqen 497 të volumit 2 të «Historia e Popullit Shqiptar», ku bâhet fjalë mbi referimin e çâshtjes nga Lidhja e Kombeve Konferencës Ambasadorëve e viceversa.

T'izoluem në katunde pa radio e pa ndonji mjet tjetër informacioni, e kishim vështirë me dijtun se ç'ndodhë në botën politike të naltë. Unë, rasësisht, atë ditë u ndodha te i ndiemi Mahmut Spahija në Kolesjan. Më thonë se: - «Burrat dhe nxanësat e shkollës, kanë dalë me pritun forcat e Shqipnisë». Edhe unë, interesohem qi të shoh; por, për fat të keq, kam mbetun vonë. Gjindja, po kalon, bashkë me Elez Isufin hiptë në kalë, tue u vjerrun drejt Bicajve. Sigurisht shumica e tyne, ishin prej Reçi e prej Dardhe, qi e shoqnojshin Elez Isufin. Kalojshin Qafën e Kolesjanit, qi dikuër kishin luftue...

Elezi, bje në Bicaj dhe mandej prej Bicajve varet për në Kukës, ku do të takoheshin me Bajram Currin, qi dhe ky, me forcat e veta, do të vinte në Kukës. Ma vonë, pata ndigjue se, Elez Isufi e Bajram Curri, në shtëpinë e Sul Elezit nga Kuksi, kanë bisedue, kanë vendosun dhe i kanë dhanun besën njani tjetrit për me bâmë kryengritje kundra Ahmet Zogut dhe shokëve të tijë.

IV.

Ndodheshem në Tiranë në fillim të Martit 1922. Qyteti, nuk paraqitet në gjendje normale. Këshilli i Naltë, të gjithë ministrat, me përjashtimin e A. Zogut, dhe pjestarët e parlamentit, ishin trazue nga kryeqyteti dhe kishin shkue n'Elbasan. Ndërsa Bajram Curri me forcat e veta, ndalon në Pukë, mbassi parija e Shkodrës, me përgjegjen qi i ka dhanun, refuzon me e shoqnue në kët kryengritje; besëlidhësi tjetër, Halit Lleshi me forcat e veta, pengohet prej forcave të Shevqet Vërlacit në Librazhd.

Elez Isufi - dhe Suf Xhelili, - me nji forcë prej hamendisht dyqind vetë nga Reçi, Dardha, e nga katundet tjera rreth e për qark, tue pasë marrun pjesë dhe disa vetë prej Nahijes së Lumës, pa shikue pengesat, tue udhtue natën e ditën, vijnë në Krujë dhe si marrin edhe Mustafa Krujën e Abas Kupin, nisen për Tiranë.

Ahmet Zogu, i kishte marrun me kohë masat e duhuna dhe iu kishte nxjerrun përpara në rrugë nji forcë gjindarmërije nen komandën e Meleq Frashërit. Kërset, pushka. Kryengritësat, vrasin Meleq Frashërin dhe si shkelin forcat e gjindarmërís, vijnë e rrasen në gadi medis të qytetit në rrugën e Vorrit të Bamit. Këtu âsht nji vend, i cilli, quhet «Qoshja e Elezit». Nuk e dij në se ky emën vendi, âsht i vjetër, apo i ka mbetun për shkak t'Elez Isufit.

Ana e Ahmet Zogut, ishte forcue, tue zanun vende të forta, ndërtesa të ndryshme dhe minaret e përshtatshme të xhamijave. Pushkët, krisshin pa ia damë në të dy anët. Ndonji herë, tarafi i A. Zogut, zbrazte edhe mitraljoz. Aty për aty, nuk ishte e mundun qi të mposhtej fuqija e qeverisë. Nuk jam në gjendje me tregue ekzaktësisht se sa ka vazhdue, kjo ndeshje. Âsht çâshtje e vjetër.

Kur nji ditë, mêni pushka. Në nji automobil (veturë) të zi kalon Elez Isufi me 3-4 shokë. E pashë s'afërmi. Që me nji plise rrafshatake, si i mban Dibra dhe Luma. Kishte nji mintan të leshtë e të bardhë dhe nji koporane të zezë si i bânë vendi. N'atë kohë, bukur i vjetër; por, i shëndoshë dhe i mbushun në trup.

«Shkoi te Ahmet Beu me pajtue, mbassi iu hyni ndërmjet legata e Inglizit», u pëshpërit në populll.

Ministri ingliz, H. Aires (kështu e noton Historia e Popullit Shqiptar emnin), paska pasun interes qi të qendrojë në fuqi Ahmet Zogu, për shkak të koncesionit të vojgurit shqiptar. Prandej, hyn ndërmjet Elezit dhe Ahmetit. Elezi, sheh se, nuk do të mundet me e realizue qellimin me ato forca, qi ka. Zogu, trembet se mos po vjen ndonji vandak forcash tjera për kundra 'Tij. Dhe në kët mënyrë, të dy palët, dhanë hirin e tyne për nji marrëveshtje.

Elezi, me grupin e vet, si piqet me A. Zogun, niset pa i hymë ferrë në kambë, tue e lanun Tiranën. Mbassi ishte largue Aj, Hamit Toptani dhe Bajram Gjoni, me terafin e vet, filluen kryengritjen; por, dështoi kjo kryengritje, për shkak se, forcat e qeverisë, tashma ishin të lira dhe iu vërsulën pjesës rebele - të thomi, tue e asgjasue shqimit.

Nji mêngesë, në rrugën 28-Nanduër të Tiranës pata njehun plotsisht 16 (gjashtëmbëdhetë) vetë të vjerrun në trekambësha, në krahnorët e të cillve ishin ngjitun vendimet e dënimit të gjyqit.

Këta, ishin ana e Hamit Toptanit, qi i ishte përveshun kryengritjes mbas pazarit me vonesë...

Si u pashit gjendja, pata shkue dhe në vorrimin e Meleq Frashërit.

Ishte nji kallaballëk shum i madh. Medis tjerëve dhe Ahmet Zogu, pat marrun pjesë në varrimin e M. Frashërit. Ishte veshun në petka krejt të zeza dhe n'atë kohë ishte i ri dhe i hijeshëm e i hollë si fidan. Më bje ndërmend, kur mbi vorrin e Meleqit, mbajti nji fjalim të shkurtë, tue thanun medis tjerave: - «Meleq, flej i qetë, se shkaktarët e gjakut t'and, gjithmonë kanë për t'u dënue».

Lim Përtrelën tregtar i madh në Tiranë, nuk e pata njoftun personalisht. Të vëllanë, Shaqirin dhe të birin, Besimin i pata njoftun ma vonë. Lim Përtrela, kësaj kryengritjeje i paska pasë ndihmue materialisht. Mbas disa ditsh, kur e zunë, u përfol se, shkoi te A. Zogu dhe iu lut qi t'i falet jeta, tue u tregue i gadshëm me pague 20.000 - (njizetmijë) napoliona ari. Ahmet Zogu, refuzon dhe Lim Përtrela, ekzekutohet.

Në përfundim, me rasën e Lëvizjes së Legalitetit - dmth. të kthimit të Zogut në Shqipni me 24.12.1924 - në nji ndeshje, qi ndodhi në Peshkopi, Suf Xhelili, mbet i vdekun dhe Elez Isufi, u plague randë, i cilli, mbas dy javësh ndërroi jetë në shtëpín e vet në katundin Sllovë të Dibrës së Vogël. Mbas vdekjes s'Elez Isufit, nji i dibranë, shkon për të pamë te Cen Elezi dhe e ngushullon, tue i thanun: - «Or Cen, taj shëndosh për teprinën.» (Ti shëndosh për eprorin.) Vërtetë kishte të drejtë, se përnjimend, Elez Isufi, në kohën dhe në vendin e vet, shokët i pat të rrallë. E tregon dhe kanga popullore:

-Ahmet Zogu, pika e djalit.
Elez Isufi, Arusha e malit.
Bini more trima, bini! ...

Të tanë shka përmenda në kët artikull, janë të vdekun. Të gjithë, simbas pikëpamjes së tyne, janë përpjekun me i shërbyem Shqipnisë. Bekimi i Zotit, qofte me 'ta...

Kët artikull po due me e përfundue me nji vjerrshë të Sadiut:

- «Çü aheng-i reften küned, can-i paq
Çi ber taht mürden, çi ber ruy-i haq!»
Dmth.:
- Kur shpirti i pastër, vendosë për me dalun,
Ç'âsht vdekja në fron e ç'âsht përmbi dhé?

** "Koha e Jonë", nr.1-2-3, janar-mars 1985, Fq.45-50, Paris, Viti XXIV i botimit*

profil

Gëzim Feta, ky njeri punëtor e vizionar, si një shembull, si një model që duhet ndjekur

Dibra Resort

Një oaz qetësie në Luginën e Shërimit

Nga **OSMAN XHILI**

Sapo ke lënë pas qytetin e Peshkopisë dhe merr rrugën për te Llixhat, të shfaqen një mori hotelesh e bujtinash, në të dy anët e rrugës, që presin vizitorë , nga Shqipëria, apo më gjerë akoma. Ujërat kurative, që Zoti i ka dhuruar këtij qyteti të vogël në verilindje të vendit, i japin një atraksion të veçantë dhe një mundësi zhvillimi ekonomik. Por tjetër herë do flasim për këtë temë dhe pse shkrimet nuk kanë munguar në këtë drejtim. Objekti ynë këtë radhë është një burrë vizionar dhe shumë punëtor, Gëzim Feta nga Zagradi.

Sapo ke lënë pas dhe Llixhat e nisesh në rrugën që të çon në fshatrat e Bellovës, në krahun e majtë të shfaqet një pamje vërtet fantastike, një perlë e krijuar nga dora njerëzore. Resorti që identifikohet me emrin e Dibrës, nuk ka shumë kohë që ka marrë jetë, vetëm katër vite më parë. Katër vite punë titanike , përpjekje maksimale e sërish ka akoma për të bërë. Ka kaq shumë gjëra për të vizituar e për tu kënaqur, sa nuk dish nga t'ja fillosh. Të bën përshtypje një kullë dykatëshe me shkallë që gjarpërojnë e bedena të vegjël mbi katin e dytë. Ajo ka dy dhoma rrethore, e mjaftë për të pushuar, të paktën dy familje, ku gjithçka është punuar me gurë dekorativë e dru gështenje. Gëzimi nuk e ka ndërtuar kullën e tij për luftë, por për paqe, për të pushuar njerëzit në të, për të kaluar një ditë ndryshe, për të larguar streset e shumta që e kaplojnë njeriun në këto kohët tona "moderne".

Pak më tej është shtëpia e tij, ku qëndron familja, një ndërtesë katër katëshe, me çati alpine, të modelit zviceran. Ftesa për të konsumuar një drekë me ushqime bio është pa të drejtë refuzimi. Fasulja, sallata, kompostot, janë të gjitha prodhime familjare, që mbyllet me reçel mani të përgatitur aq mjeshtërisht nga zonja e shtëpisë. Shumë shpejt do të fillojë punë kafja dhe një restorant, dekoruar aq bukur nga duart e Gëzimit. Në resortin e tij kombinohen natyrshëm antikja me modernen. Do të gjesh aty një depozitë karburanti e avionit luftarak, sjellë nga Gjadri i Lezhës, me një kapacitet 800 litra, siç do të gjesh spirancën e një peshkarexhe, apo një copë litari të trashë, që dikur përdorej për ankorimin e anijeve. Gjen aty të ekspozuar një karrocë të vjetër druri të sjellë nga Struga, apo një taksi e përdorur para 50 vjetësh, e sjellë nga Gostivari. Shumë gjëra janë realizuar, siç ka dhe shumë të tjera që pritet të bëhen në vazhdim.

BIMË, PEMË, LULE

Siç është i çmendur pas gjërave antike, që i ka sjellë nga afër e larg, Gëzimi është po kaq i dashuruar, pas gjelbërimit, bimëve, pemëve e luleve. Më lehtë do të ishte të përmendim gjërat që nuk i ka, se sa e kundërta. Shumica e luleve janë nga Shqipëria, por ka dhe prej Struge, apo nga Greqia. I gjen të pranishme këtu Aronian, boronicën, manaferrat, mjedrat, kurse Goy berin, që nuk e kishte, shkoi ta marrë tek Zija Keshi në Majtarë. Shumica e tyre janë thjeshtë për të kënaqur syrin e nuk sjellin ndonjë vlerë materiale, por kjo është vetëm ide e momentit. Sa më shumë lule, sa më shumë gjelbërim, aq më shumë vizitorë e turistë, aq më shumë të ardhura do të ketë në xhepin e tij. Pemët janë pjesë e identitetit të këtij resorti të bukur. Gëzimi dëshiron ti ketë të gjithë dru frutoret, që nga kumbullat, qershia, mollët, rrushi, arrat e lajthitë. Nuk mungojnë këtu as pemë atipike të zonës, si ulliri, fiku, shega e të tjera si këto. Disa kanë hyrë në prodhim e Gëzimi kënaqet me kokrrat e para të arrave, mollave, lajthive e manaferrave. Si për ta bërë më të plotë panoramën, nëna e tij, e mira e urta dhe punëtorja



Resorti i Gëzimit është vetëm një oaz në shkretëtirë. Më sipër vazhdon Lugina e Shërimit, me këtë emër të bukur. Rruga që shkon përmes saj e të çon në fshatrat e Bellovës, ku mes tyre dhe Rabdishti i shpallur fshat turistik, është për t'i qarë hallin. E paasfaltuar, gjithë gurë, pluhur e gropa... Ajo sipërfaqe dhjetëra hektarësh, që dikur ka qenë me plepa, mund të kthehet në një park të bukur, me asfalt, me pemë dekorative, me stola, kënde lojërash e bare që shërbejnë. Nuk është ky një projekt utopik dhe i parealizueshëm. Gëzimi, një individ i vetëm e ka krijuar resortin, një shtet i tërë nuk mundet dot ta bëjë...

si ajo, i ka marrë ca metra katrorë shkëmbit dhe ka ngritur kopshtin e saj. Një nostalgji për kohën kur ishte nuse dhe mbillte një kopsht të bollshëm. Domatet, specat, trangujt, qepët e shumë perime të tjera prodhohen këtu, duke përdorur vetëm pleh lope e ujë burimi. Askush nuk i kërkon të punojë, por ajo dëshiron të kontribuojë sadopak, duke i siguruar familjes perime të freskëta.

Ajo kujton vite të shkuara, kur sapo kishte ardhur nuse dhe tamam këtu ku jemi ishte një mulli me ujë, pronë e tre vëllezërve, që bluante drithin e gjithë zonës. Kështu vazhdoi gjatë mulliri, deri afër viteve 2000, për të heshtur më pas. Por Gëzimi ka ide të reja. Ai do ta ringjallë atë, në mos si një mulli real, të paktën, kujtimin dhe imazhin e tij, duke vënë një elikë që lëvizet nga uji.

UJI, SHPIRTI I RESORTIT

Jo vetëm kaq, por dhe dyfishin e gjërave të kishte bërë Gëzimi në këtë vend, nuk do kishin kaq vlerë, po të mos ishte uji. Ai shërben për resortin, si shpiri për trupin e njeriut. Diku aty në cep të tij është dhe burimi i këtij uji fantastik, shumë i pasur me squfur. Vlerat kurative të tij janë të shumta, vetëm se nuk ka temperaturën, si uji i llixhave që përdoret më poshtë. Gëzimin pa frikë mund ta quash një inxhinier hidroteknik. Ai ka bërë mrekulli me ujin, duke na dhënë pamje magjepsëse. Aty lart në shkëmb, nga një vrimë e hapur, varet poshtë një rrëke uji, që krijon idenë e një ujëvare të vogël. Shumë vizitorë afrohen të bëjnë foto, për ti pasur si kujtim të atyre minutave të këndshme e relaksuese të qëndrimit këtu.

Ai bashkohet poshtë me rrjedhën mëmë e kështu së bashku vazhdojnë rrugën përmes resortit. Gëzimi ka krijuar një pishinë të bukur, ku vizitorët mund të fusin këmbët për disa minuta, për të shëruar reumatizmën, artritet e disa sëmundje të tjera. Më tej uji krijon një ujëvarë më të madhe se e para. Ciklat e ujit fluturojnë në mijëra, hapen e bashkohen sërish. Të tjera pamje të mrekullueshme dhe vizitori nuk di ku të bëjë foto e video më parë.



MIQTË E KOSOVËS.

Një ditë, miku im italian Kozimo, profesor i shquar i fizioterapisë, me përmasa europiane, vizitoi llixhat dhe po ashtu resortin e Gëzim Fetës. Ai i kishte vizituar llixhat në Japoni, në Hungari e në shumë vende të tjera dhe e dinte qartë se si punohej atje. Ndërsa për të parat mbeti disi i zhgënjyer si të lëna pas dore, për të dytin nuk i kurseu lëvdatat. Kështu duhet të punojnë të gjithë, nëse duam të kemi një bum turistik, u shpreh profesori.

Ndërsa Gëzimi po më shpjegonte punët e bukura që kishte bërë, dy çifte disi të moshuar hyjnë në resort dhe pyetën nëse mundeshin të kalonin pak minuta aty. Dhe pse akoma nuk funksionon restoranti dhe bari, ata ulen dhe shijojnë kafen e freskët që u përgatiti vetë Gëzimi. U ulëm dhe ne në bisedë me ta. Ishin nga Kosova. Ramush Matoshi, bashkë me të shoqen, jetonin në Suharekë, kurse Bajram Memaj me bashkëshorten e tij vinin nga Korisha e Prizrenit. Ata e përgëzuan Gëzimin për atë punë që kishte bërë, për ato ide të bukura që kishte realizuar. Bajrami ka qenë dhe në Llixha të Elbasanit, por thotë se këto të Peshkopisë janë më të mira. Tek ne, vazhdon ai, punohet më mirë nga Komuna dhe nga shteti. Ndonëse bjeshkët e Kabashit, në lartësi të Prizrenit, janë bosh, po dërgohet rryma elektrike dhe rruga po asfaltohet. Dhe lumi i Rekës po disiplinohet dhe zbukurohet shtrati i tij.

Dëgjon tregime të tilla për një vend që kaloi një luftë të tmerrshme dhe ndihesh keq. Resorti i Gëzimit është vetëm një oaz në shkretëtirë. Më sipër vazhdon Lugina e Shërimit, me këtë emër të bukur. Rruga që shkon përmes saj e të çon në fshatrat e Bellovës, ku mes tyre dhe Rabdishti i shpallur fshat turistik, është për t'i qarë hallin. E paasfaltuar, gjithë gurë, pluhur e gropa. Shumë projekte janë bërë, shumë tendera janë dhënë e prapë situata është e njëjtë. Ajo sipërfaqe dhjetëra hektarësh, që dikur ka qenë me plepa, mund të kthehet në një park të bukur, me asfalt, me pemë dekorative, me stola, kënde lojërash e bare që shërbejnë. Nuk është ky një projekt utopik dhe i parealizueshëm. Gëzimi, një individ i vetëm e ka krijuar resortin, një shtet i tërë nuk mundet dot ta bëjë. Le të na shërbejë Gëzim Feta, ky njeri punëtor e vizionar si një shembull, si një model që duhet ndjekur, nëse duam të shkojmë drejt vlerave europiane.







Rruga e Arbërit nr. 170

histori

Deri në fund të jetës së tij Moisi Golemi mori pjesë gati në të gjitha betejat që zhvilloi ushtria arbërore

MËRIA E MOISI GOLEMIT

Nga **Avni ALCANI**

(vijon nga numri i kaluar)

4. MËRIA E MOISI GOLEMIT

Disa autorë shqiptarë, duke filluar nga Barleti, Frangu e deri te Noli etj., në monografitë e tyre kushtuar Skënderbeut, Heroit Kombëtar të shqiptarëve, kanë shkruar se Moisi Golemika tradhtuar Skënderbeun për shkak të një mërie, apo zemërimi të madh, dheu bashkua me osmanët kundër tij.

Përse u nda Moisi Golemi nga Skënderbeu dhe cili ishte shkaku i zemërimit të tij? Si qëndron e vërteta e "tradhtisë" së luftëtarit më të famshëm të ushtrisë arbërore të shek. të 15-të? Përse iku në Stamboll dhe ç'e shtyu atë që të ngrinte armët kundër bashkëluftëtarit dhe mikut të tij më të ngushtë? A është e vërtetë se ai, pas disfatës që pësoi ushtria osmane e komanduar prej tij, u kthye fshehurazi e i penduar dhe, siç shkruajnë Barleti dhe Frangu,30) u përul i gjunjëzuar duke i kërkuar Skënderbeut*"me lot në sy"* që ta falte? Këto dhe disa pyetjeve të tjera do të mundohemi t'iu japim përgjigje në vijim të shkrimit tonë.

Sipas Barletit dhe Frangut, "tradhtia" e Moisiut zuri fill pas humbjes së rëndë që pësoi ushtria e Skënderbeut në betejën e Beratit.31)Barleti shkruan se shkak i tradhtisë së Moisiut ishte "Barbari", dmth, Sulltani, i cili, sipas tij, pasi nuk e mundi Skënderbeun në fushën e betejës, ai bëri ç'mos për ta mposhtur me anë të dredhive, duke i *"grishur"*(ftuar) në bisedime bashkëluftëtarët e tij më të ngushtë e më të zot me qëllim për t'i joshur e korruptuar dhe, për këtë, gjithnjë sipas Barletit,ai përzgjodhi Moisi Golemin, kryegjeneralin e ushtrisë së arbërorëve dhe krahun e djathtë të Skënderbeut. Sulltani, shkruan Barleti,*"s'la gurë pa luajtur për këtë punë. Mbi të gjitha ai vuri në veprim tërë urtësinë dhe mençurinë e vet për të në bisedime Moisiun..."*.32)Kurse Dh. Frëngu shkruan se pas Betejës së Beratit dhe të përmbysjes, sipas tij, së gjendjes në Arbëri: *"Moisiu nuk shpresonte më se Skënderbeu të qe në gjendje të mbronte vendin"* dhe kaloi tek osmanët, me qëllim *"për ta shporrur Skënderbeun prej Shqipërisë nëse i jepeshin mijëra ushtarë turq të zgjedhur dhe me kusht që, pasi ta kishte përzënë Skënderbeun prej Shqipërisë, të bëhej zot i atij vendi, duke i paguar Turkut një tribut vjetor"*.33) Kurse F. S. Noli, biografi më i shquar shqiptar i Skënderbeut në shek. e 20-të, shkruan se ishin venedikasit ata që e kanë nxitur Moisiun dhe princërit e tjerë arbër që ta tradhtonin Skënderbeun dhe të hidheshin te turqit. *"Ka të ngjarë*, - shkruan ai, - që *vendikasit* të kenë dashur që ata të hidheshin në anën e turqve dhe të ktheheshin pastaj me ushtrinë turke, kundër ish komandantit të tyre të përgjithshëm. Në fakt ata i kanë inkurajuar dezertorët për të vepruar në këtë mënyrë (*Makushev, Marinesco). Ata shpresonin ta likujdonin Skënderbeun me anë të luftës vëllavrasëse dhe të agresonit turk (112)"*.34)Kurse shtysën e "tradhtisë" së Moisiut, ai e shikon te bashkëshortja e tij, Zanfina Muzaka,të cilën Skënderbeu e kishte ndarë prej burrit të saj të parë, Muzak Topisë, për ta martuar këtë të fundit me të motrën, Mamica Kastriotin.*"Ta dini që Zot Muzak Topia, ose ndryshe Karl Muzaka*, - shkruan Gj. Muzaka, - *pati për grua Zonjën Zanfina, ose ndryshe Suina, me të cilën bëri dy fëmijë, një djalë me emërin Andrea dhe një vajzë më emrin Jella, që kjo e quajtura Jella u martua me Zot Gjergj Cernoviçin dhe ju them se Zot Skënderbeu e prishi këtë martesë të të lartpërmendurit Zot Muzakë e zonjës Zanfina Millosaka e lartpërmendur, pa e dashur as perëndia dhe askush, dhe as fëmijët që ata kanë dhe i dha të motrën, Mamicën*.35)

A është e vërtetë se Moisiu e "tradhëtoi" Skënderbeun për shkak se, siç shkruan Barleti, të grishjes që i bëri Sulltani, apo, siç shkruan Frangu, të egoizmit të tij që ai të bëhej Zot i Arbërisë, apo për shkak të intrigave të Venedikasve, siç shkruan Noli?! Akuzat e dy prej biografëve të Skënderbeut, të cilët kanë qenë bashkëkohës të ngjarjeve të mëdha të shek. të 15-të, janë sa naive aq dhe të njëanshme. Kurse insinuatat e Nolit, se kanë qenë intrigat e venedikasve shkaku i tradhtisë së Moisiut, nuk mund të merren në konsideratë, pasi nuk ka dëshmi apo fakte reale që e vërtetojnë një pohim të tillë.

Por cili ishte shkaku i vërtetë i mërisë së Moisi Golemit, që çoi atë në një reagim ekstrem kundër Gjergj Kastriot Skënderbeut? Këtë na e thotë një tjetër bashkëkohës i Skënderbeut, Despoti i Beratit, Zoti Gjon Muzaka, autori i "Gjenealogjisë" së Derës së Muzakajve. Ai shkruan se arsyeja e vërtetë e zemërimit të Moisi Golemit ndaj Kastriotit kishte shkaqe më të thella, që kishin të bënin me rrëmbimin tokave të tij dhe përvetësimin e Principatës së Moisiut në Dibër. *"Zot Skënderbeu...*, - shkruan ai, - *pasi mori Matin, Principatën e të atit, u bë Zot i qytetit të Krujës, të cilën i ati nuk e kishte ... e në pak kohë synoi të zotëronte të gjithë vendin... mori dhe Moisi Komnenit principatën e tij, e cila ishte në Dibër"*.36) Skënderbeu ishte Komandanti i përgjithshëm i ushtrisë Arbërore me ambicie për t'u bërë Mbret i Arbërisë, ndaj synonte zgjerimin e territoreve të shtetit të tij, që ishte ende i vogël, dhe këtë zgjerim ai kërkonte ta bënte duke u rrëmbyer tokat e fisnikëve shqiptarë. Skënderbeu nuk ia rrëmbeu toka vetëm Moisiut, por edhe fisnikëve të



tjerë arbër, ndër të tjerëve dhe dy nipërve të tij nga e motra Jella, vëllezërit Gjon dhe Gojko Balsha, të cilët, pasi ua rrëmbeu pronat që kishin midis Krujës dhe Lezhës, i burgosi dhe i internoi në Itali.37) Ai, shkruan Muzaka, *"na mori dhe neve Tomorrishtën, domethënë Myzeqenë e vogël dhe kështu bëri dhe me zotërinjtë e tjerë të krahinave të Komit dhe të Randisës* që nuk mbroheshin dot, sepse ai kishte ushtrinë për luftë dhe turku kërcënonte çdo vend".38) Fan Noli i konsideronte si të natyrshme rrëmbimet e përdhunshme që u bënte Skënderbeu pronave të feudalëve të tjerë arbër. *"Ishte fare e natyrshme*, - shkruan ai, - që Skënderbeu t'i hiqte këta krerë të paafrueshëm, t'i aneksonte kantonet (krahinat e tyre) dhe ta bashkonte të gjithë vendin kundër Turqisë dhe Venedikut".39) Por, nga ana tjetër, Noli i pranon pasojat që rrjedhin nga një veprim i tillë. *"Këto dezertime*, - shkruan Noli, - *i detyrohen faktit që Skënderbeu po i aneksonte principatat e gjithë këtyre gjysm*ë feudalëve, ose më mirë, krerëve patriarkalë, të cilëve s'u mbetej më gjë tjetër, veç të kërkonin mbrojtje nga turqit ose nga venedikasit....".40)

Nëse fisnikët e tjerë, që u ishin rrëmbyer pronat, ishin më të dobët dhe të pafuqishëm që të përballonin fuqinë e Kastriotit, kurse Moisiu, duke qenë se nuk mund ta përtypte dot poshtërimin dhe fyerjen që i shkaktoi Skënderbeu, iu kundërvu këtij të fundit dhe u arratis në Anadoll (Turqi). *"Moisiu ishte njeri me zemër dhe trim*, - shkruan Muzaka, - *dhe, duke mos mundur të durojë një dhunë të tillë, u arratis tek Sulltani dhe ky Sulltani e bëri komandant të njërës nga ushtritë e tij dhe e dërgoi kundër Skënderbeut"*.41) Një tjetër shkak përse Moisiu është ndjerë i fyer, kishte të bënte me sojin (rangun) e lartë të fisit të tij të Aranitëve, të cilët, në krahasim me atë të Kastriotëve, që vinin nga një familje e vogël fisnikësh, e kishin origjinën e tyre nga familje të vjera feudale, me lidhje të shumta me dyer mbretërish e perandorësh europianë. Historiani Pëllumb Xhufi, kur analizon marrëdhëniet e familjes Araniti me Kastriotët, shkruan: *"Gjergj Arianiti ...nuk e duronte lehtë autoritetin epror të Skënderbeut, aq më shumë kur bëhej fjalë për një kapedan që, ndryshe nga ai, vinte nga një familje fisnikësh të vegjël..."*.42)

Në Mesjetë marrëdhëniet midis të fisnikërisë arbërore të shekullit të 15-të, si aleancat, vasalitetet, ndarjet, mosmarrëveshjet, tradhtitë etj. ishin të vendosura mbi bazë të një kodi, të quajtur "Kodi i nderit". Mosmarrëveshjet, armiqësitë, mëritë etj. ishin të nxitura nga shkaqe apo motive të ndryshme, por kryesisht ato shkaktoheshin për territoret. Mjaft nga çështjet e mprehta, siç ishin, mëritë, apo zënkat, zgjidheshin në fushën e betejës, në dyluftimet trup me trup,apo me vrasje në pusi, siç pati ndodhur vrasja në pusi e Lekë Zaharisë nga Lekë Dukagjini,43) e cila nxiti një luftë të re të Skënderbeut kundër Venedikut, pasi venedikasit, pas vdekjes së Zaharisë, kishin zaptuar pronat e këtij të fundit si dhe qytetin e Danjës.

Kishte dhe armiqësi të mëdha mes fiseve dhe familjeve të mëdha, të cilat shkaktonin luftime të përgjakshme mes tyre. E tillë ka qenë ajo e Dukagjinëve kundër Kastriotëve. Dukagjinët dikur kishin qenë aleatë të Skënderbeut. Ata morën pjesë në Beslidhjen e Lezhës (2 mars 1444), por kurrë nuk iu nënshtruan këtij të fundit dhe në mes tyre kishte plasur një mëri dhe armiqësi e egër, gjë që shkaktoi një përçarje mes ish aleatëve dhe Dukagjinët kaluan me osmanët.44) Kjo gjë shkaktoi shqetësim te Vatikani, sa që e detyroi Papën Nikolla V t'i kërcënonte Dukagjinët me shkishërimin e tyre.45)

Moisi Golemi, pas mërisë, u largua nga Skënderbeun dhe, ashtu siç kishin bërë fisnikë të tjerë para tij, për ta luftuar atë u bashkua me Sulltanin, me armikun më të madh të tij. Parimi: *"Armiku i armikut tim është miku im"*, që ishte normale për kohën, ndoshta ka qenë arsyeja kryesore përse Moisiu shkoi te Sulltani. Shkaktari dhe fajtori kryesor i konfliktit mes tyre ishte Skënderbeu, i cili kishte rrëmbyer pronat e Moisi Golemit dhe e kishte detyruar këtë të fundit që të hakmerrej. Në këtë përfundim ka mbërritur historiani zvicerian Oliver Jens Schmitt, autori i librit "Skënderbeu" (Tiranë 2009), i cili shkruan: *"Fajin nuk e ka tradhtari, por Skënderbeu, i cili kishte fyer rëndë një fisnik dhe e kishte detyruar këtë të hakmerrej. Moisiu nuk kishte rrugëdalje tjetër, nëse donte të ruante nderin e vet..."*.46)

Moisiu u rikthye në Arbëri në krye të një ushtrie osmane, por u thye keq nga Skënderbeu. Ashtu siç kam nënvizuar dhe në një shkrimin tim kushtuar Muzhaqit të Angjelinës,47)në këtë betejë, Skënderbeu hartoi një strategji të jashtëzakonshme kundër Moisiut. Ai e vendosi ushtrinë e tij, e cila ishte e ndarë në dy pjesë, nën komandën e. dy vëllezërve Araniti, Muzhaq Komnen Araniti dhe Gjuric Vladan Araniti, që ishin djemtë e xhaxhait të Moisiut, duke i vënë Aranitët përballë njëri-tjetrit, gjë e cila bëri të pamundur dyluftimin vëllavrasës dhe siguroi fitoren e ushtrisë së tij.

Moisiu u kthye te Sulltani i mundur dhe me ushtri të shpartalluar. Brenda shpirtit të tij duhet të ketë pasur tallaze të mëdha. Dy nga biografët e tij më të hershëm, Barleti dhe Frangu, shkruajnë se Moisiu u kthye i penduar dhe i kërkoi falje Skënderbeut. Barleti shkruan: *"I pikëlluar sa s'ka, i ra përpara në gjunjë, i kërkoi me lot në sy që ta falte e të mos i bënte gjë, jo se e meritonte, por për vetë bujarinë dhe njerëzinë e shpirtit të tij... Skënderbeu e zuri prej dore dhe e porositi që të ngrihej menjëherë. I gatshëm për ta falur, i foli me shumë mirësi dhe, duke e përqafuar e puthur shpesh, ia hapi zemrën krejt dhe u pajtua me të..."*,48) ndërsa Frangu shkruan:"(Moisiu) *erdhi fshehurazi në Shqipëri zëmërdridhur dhe me lot për të kërkuar mëshirë. Skënderbeu shtriu menjëherë dorën, e ngriti dhe nisi të bisedonte me të në një mënyrë të tillë, a thua se nuk kishte marrë as edhe një fyerje më parë nga ana e tij"*.49)

A ishte e vërtetë se Moisiu u kthye i përulur ndaj Skënderbeut dhe i kërkoi falje? Muzaka shkruan krejt të kundërtën, se ishte Skënderbeu ai që i shtriu dorën e pajtimit dhe i bëri thirrje Moisi Golemit që të kthehej.50)Muzaka shkruan: *"...por pastaj ai (Skënderbeu) i dërgoi lajm që të kthehej e të mbeteshin vëllezër dhe Moisiu, duke parë se nuk ishte i sigurt tek Sulltani dhe për të mos rritur më gjakderdhjen e të krishterëve, u kthye"*.51Skënderbeu kishte gabuar me Moisi Golemin, por dhe Moisiu, me sa duket, kishte qenë i penduar për aktin që kishte kryer dhe që të dy zotërinjtë më të mëdhenj të Arbërisë bënë pajtimin e tyre historik. O. J. Scmitt-i, shkruan: *"...Skënderbeu e kishte kuptuar gabimin e tij edhe Moisiun e kaploi pendesa... kështu që interesat e të dy zotërinjve përputheshin me njëri-tjetrin; ishte harruar fyerja, ishte rimëkëmbur vëllazëria e armëve deri në vdekje..."*.52)

Opinionet e disa prej historianëve për Marin Barleti kanë qenë kritike nga veprës së tij "Historia e Skënderbeut", sa që ndonjëri prej tyre (Babingeri) e ka quajtur edhe "përralltar".53) Ai është kritikuar nga disa të tjerë edhe për një lloj njëanshmërie të skajshme dhe jo reale në favor të Skënderbeut, që, siç shkruan Noli, i *"ngre në qiell fitoret e heroit* (Skënderbeut-A.A.), *ndërsa fatkeqsitë e tija i kalon në heshtje. Të vrarët turq i shumëzon me mijëra, ndërsa humbjet shqiptare i pakëson deri në disa dhjetëra..."*.54)Krejt të ndryshme janë opinionet për Gjon Muzakën, pasi vepra e tij, "Gjenealogjia", ka karakter përshkrues, është më realiste dhe ka një qëndrim kritik ndaj figurës së Skënderbeut, ç'ka e bën më të besueshme se veprën e Barletit, i cili vetëm lavdëron anët heroike të Skënderbeut. *"Muzaka*, - shkruan Noli, - *është kundërshtar i hapur i Skënderbeut, të cilin e konsideron si arrivist dhe uzurpator, që u muar me aneksimin e tokave të principatave fqinje. Dëshmia e tij* është, pra, shumë më e vlefshme se ajo e biografëve të tjerë që janë pak a shumë lavdërues".55)

5. BETEJA E VAJKALIT. FUNDI I MOISI GOLEMIT

Në prill të vitit 1465 u zhvillua Beteja e Vajkalit, midis ushtrisë së Skënderbeut dhe ushtrisë osmane të udhëhequr nga sanxhakbeu osman i Sanxhakut të Ohrit, Ballaban Badera, i cili ishte një renegat me origjinë arbërore, i dërguar nga Sulltan Mehmeti II që të shkatërronte Skënderbeun. Ushtria arbërore i ishte besuar Moisi Golemit. Para betejës, Skënderbeu u paraqiti luftëtarëve planin e luftimit, në të cilin ishte planifikuar që t'i mashtronte osmanët, duke i bërë të mendojnë se forcat e tij janë shumë më të dobëta për të luftuar dhe tepër të frikësuara. Osmanët u futën në betejë me një ndjenjë të rreme sikur luftëtarët shqiptarë ishin më të pakët se ata në numër. Skënderbeu i lejoi ushtarët osmanë që të vinin sa më pranë tij dhe pastaj filloi kundërsulmin. Beteja u zhvillua e ashpër dhe ushtria osmane u frikësua dhe ushtarët filluan të largohen në panik. Në ndjekje të ushtrisë së shpartalluar të Ballabanit, shkruan Franku,56)disa prej drejtuesve të ushtrisë së Skënderbeut nuk zbatuan urdhërat e tij për të ndaluar ndjekjen e forcave osmane dhe u kapën në befasi. Disa nga njerëzit më të afërt e më të besuar të Skënderbeut, duke përfshirë: Moisi Golemin, Gjuric Vladanin, Muzhaqin e Angelinës, Gjin Muzakën, Gjon Perlatin, Nikollë Berishën, Gjergj Kukën dhe Gjin Maneshin, *"të rrëmbyer nga furia e Marsit dhe vrulli i luftës, shkuan më tej nga ç'duhej"*.57)Ata u zunë të gjallë. Robërit u dërguan në Konstandinopojë, ku u torturuan në mënyrë çnjerëzore.

Skënderbeu dërgoi ambasadorë te Sulltani, që, kundrejt një shume të madhe të hollash, apo duke i shkëmbyer me robër osmanë, t'i këmbente me luftëtarët e tij, në të kundërt ai do të ekzekutonte të gjithë robërit osmanë të luftës. Sulltani nuk pranoi, por urdhëroi ekzekutimin e robërve. *"Me vdekjen e tyre*, - do të shkruante Barleti, - e *bënë Arbërinë më të përlotur se ndonjëherë më parë, sepse që të gjithë shquheshin shumë si për fuqinë e trupit, si për forcën e shpirtit dhe për dijen ushtarake"*.58

30) Barleti 1983, faqe 468; Frangu 2000, faqe 31;

31) *"...kur u mor vesh kërdia e ushtrisë* (Beteja e Beratit) *dhe u bë e ditur fatkeqësia* e Skënderbeut, *atëherë Moisiu, duke gjetur më në fund rastin e dëshiruar prej kohe, i ktheu armët e krimit kundër atdheut dhe ia filloi, siç i thonë"*.Barleti 1983, faqe 422; *"... pas gjithë asaj përmbysjeje të gjendjes, Moisiu nuk shpresonte më se Skënderbeu të qe në gjendje të mbronte vendin. Kështu që nisi ta konsideronte kaq të pazotin Skënderbeun, sa më në fund e braktisi, la detyrën që mbante dhe shkoi me vrap te Turku, të cilit i afroi shërbimin e vet për ta shporrur Skënderbeun pre Shqipërisë nëse i jepeshin mijëra ushtarë turq të zgjedhur dhe me kusht që, pasi ta kishte përzënë Skënderbeun prej Shqipërisë, të bëhej zot i atij vendi, duke i paguar Turkut një tribut vjetor..."*,Frangu 2000 faqe 29;

32) Barleti 1983, faqe 409-468;

33) Frangu 2000, faqe 29;

34) Noli 1967, faqe 113;

35) Muzaka 1996, faqe 48; "*Padyshim zonjë Zanfina, e shoqja e Moisiut* të Dibrës, duhet të ketë pasur gisht në dezertimin e tij. Ajo do t'i ketë mbajtur mëri Skënderbeut që i kishte marrë burrin e saj të parë për ta martuar me të *mo(112)trën, Mamicë Kastriotin"*. Noli 1967, faqe 113;

36) Muzaka 1996, faqe 50;

37) *"Vuri në pranga Zot Gjonin dhe Zot Gojkon e balshajve* që ishin dy vëllezër dhe ia dërgoi Mbretit *Ferrant plakut në Napoli, i mbajti në burga dhe iu mori Principatën e tyre që shtrihej midis Krujës e Lezhës e që thirrej vendi i Misisë"*. Muzaka 1996, faqe 50;

38) Po aty;

39) Noli 1967, faqe 113;

40) Po aty, faqe 113;

41) Muzaka 1996, faqe 50;

42) Xhufi 2019, faqe 61;

43) Buda 2018, faqe 132;

440 "Dukagjinët u bashkuan me osmanët, pranuan, pra, më mirë të tërhiqnin sulltanin në vend se sa t'i nënshtroheshin Skënderbeut". Schmitt 2009, faqe 204-205;

45) "Atëhere Nikollës V iu desh t'i kërcënonte Dukagjinët dhe klerilët në malësi me shkishërim". Schmitt 2009, faqe 205;

46) Schmidtt 2009, faqe 216;

47) Alcani 2019, faqe 147;

48) Barleti 1983, faqe 468;

49) Frangu 2000, f aqe 31;

50) Schmidtt 2009, faqe 216;

51) Muzaka 1996, faqe 50;*"...nuk ishte Moisiu ai që u kthye i përgjëruar te Skënderbeu, porse, sipas Muzakit, ka ndodhur gati e kundërta"*.

52) Schmidtt 2009, faqe 216;

53) Po aty, faqe 479

54) Noli, faqe 162;

55) Po aty, faqe 164;

56) "Mirëpo Moisiu, Jurici, Muzhaqi i Angjelinës, Gjergj Kuka dhe Gjin Maneshi... harruan për një çast porosinë e Skënderbeut që të mos e kalonin vendin e caktuar dhe krejt papritur u gjendën në mesin e luginës së Vajkalit. E atëhere, skuadroni i armikut, që rrinte fshehur atje, u hodh i tëri mbi të tetë kapedanët...".Frangu 2000, faqe 52;

57) "Por 8 burra luftëtarë shumë trima nga skënderbegasit, çdonjëri prej të cilëve mund të numurohej siguisht ndër kapedanët dhe komandantët më të mirë, të rrëmbyer nga furia e Marsit dhe vrulli i luftës, shkuan më tej nga ç'duhej... Ndër të parët, pra, që u hodh kështu në sulm ishte ai Moisiu i dëgjuar i Dibrës, për të cilin kemi folur shumë më lart, më i dashuri dhe më besniku për Skënderbeun, që i kishte besuar komandën e përgjithshme të ushtrisë. Pas këtij vinin Gjuric Vladeni, i cili ishte në lidhje gjaku me Skënderbeun, Muzaka i Angjelinës, nip prej motre i Skënderbeut, Gjin Muzaka, Gjon Perlati, Nikollë Berisha, Gjergj Koka, dhe Gjin Maneshi, të cilët me vdekjen e tyre, e bënë Arbërinë më të përlotur se ndonjëherë më parë, sepse që të gjithë shquheshin shumë si për fuqinë e trupit, si për forcën e shpirtit dhe për dijen ushtarake. Barleti 1983, faqe 603-604;

58) Po aty, faqe 604;



Pse në përmbledhjen me tregime të Agron Tufës "Kur këndonin gjelat e tretë" mungon edhe perspektiva e vrasësve, dhunuesve, dhe e masakruesve, vetë "Njeriut të ri" të komunizmit? Kjo, në fund të fundit kërkon përballjen e dëshmive.

'Kur këndonin gjelat e tretë' – rrëfimi i pagjykuar i vrasësve

***Nga* BALLSOR HOXHA**

Pse në përmbledhjen me tregime të Agron Tufës "Kur këndonin gjelat e tretë" mungon edhe perspektiva e vrasësve, dhunuesve, dhe e masakruesve, vetë "Njeriut të ri" të komunizmit? Kjo, në fund të fundit kërkon përballjen e dëshmive.

Por a mund të jetë perspektiva e munguar e po këtyre, "Njeriut të ri", Shqipëria e sotshme? Apo, thënë ndryshe, përse të pyetemi më ku është problemi i shqiptarëve, Shqipërisë? Kur kemi para vetit panumër dëshmi të "Gjenocidit shqiptaro – shqiptar". Dëshmi si kjo e rrëfyer nga – shpirti – dhe realiteti i atyre që vuajtën këta shpirtra, në përmbledhjen me tregime "Kur këndonin gjelat e tretë" të shkrimtarit Agron Tufa.

-Realja – "Luka pas shpine", njeriu pa peng ndaj kësaj bote

Ky gjenocid ishte -kalimi i njeriut përtej përvojës së tij, në "Njeri të ri", e që është theks dhe psikologji e ideologjisë tipike për braktisje dhe si braktisje të fajit dhe përvojës së njeriut. Dhe ky kalim krijoi totalen e dhunës, kaosin, deri në zhveshje të asaj që Arthur Shopenhauer e quante vullneti për në të ligë i botës dhe natyrës. Gjë që zbuloi realen, pandjeshmërinë, zhdukjen e njerëzores në këtë pandjeshmëri. Në të vërtetë kjo është realja e zhveshur, e natyrës ashtu si është – qeniesim në vete, e pandjeshme ndaj njeriut. Reale tej asaj që ne e quajmë njerëzore, qoftë sipas asaj religjioze, dhe qoftë sipas asaj humaniste. E -kaluar në realen që nuk e njeh njeriun, reale ku njeriu është po aq i ndjeshëm, i lidhur dhe i përgjegjshëm ndaj tjetrit, sa edhe guri. Reale të cilën e përshkruajnë edhe Arthur Shopenhauer, e Jacque Lacan, reale që tenton kah e liga, kah e keqja, apo, që nuk e njeh njeriun, por që krejt çka mund të bëj njeriu është të krijojë brenda saj.

Kjo Reale në të vërtetë, pandjeshmëria e natyrës dhe botës ndaj njeriut, në këtë përmbledhje me tregime/dëshmi, arrin thellësinë e shprehjes, në tregimin "Luka mbas shpine". Arrin këtë pikërisht nëpër mishërimin e pandjeshmërisë në tërë dhunën brenda jetës së personazhit si Luka, dhe me këtë nëpër tërë absurdin e një "bote të re" ku është i ngujuar Luka, pa dalje.

"Me 11 korrik 1987, pasi kishin ngranë drekë me nanën dhe ajo ish shtri, Luka merr shkrepsen në oxhak, një sëpatë dhe del në zabelin e përcëlluem mbi katund. Mbledh e bën një mullar me dru e dëllinja të thata. U jep zjarrin. Mandej zhvishet kadalë, palos rrobat me kujdes, vë mbi to orën e dorës, sëpatën shkrepsen dhe … futet në zjarr lakuriq… "Edhe sikur ta mbajnë me force njeriun në zjarr, nuk do të rrinte ashtu si Luka", – thoshin barinjtë që e gjetën skeletin e tij të shkrumbosur."

Luka, derisa digjet, i pa ankesë, i pa keqardhje, i pa dyshim dhe as pa peng ndaj jetës, nuk është e liga në njeriun, ai është individi, ndoshta i vetëm, përballë Reales, pandjeshmërisë, kaosit dhe totales së të ligës në të cilën është zhytur pakthyeshëm Shqipëria, kjo "Botë e re". I pandjeshëm dhe vetë në revoltën e tij.

Djegia "duke qëndruar brenda zjarrit i palëvizshëm", e pa peng, pa keqardhje dhe pa fajin, e personazhit Lukaështë vetë shkëputja e ndjeshmërisë, sensit dhe njerëzores, deri në zhdukje të njërit ndaj tjetrit, të njeriut për njeriun. Në të vërtetë është shpërbërje dhe kaos i emrit të njeriut, i cili nuk ekziston pa tjetrin përballë.E tjetri përballë, emri i tij është abstraksion, theks dhe zhveshje e njerëzores (pikërisht të nënës, nga "bija nënë", sikur në tregimin "Të pushkatohet" dhe pyetjen brenda tij *"ku e ka nanën bijë ajo ideja jote?")* në kompozicionin krejtësisht artificial në "Nëna Parti".

-Perspektivat ende njerëzore të viktimave

E tërë përmbledhja e tregimeve "Kur këndonin gjelat e tretë" të Agron Tufës është e dominuar nga dëshmi, perspektiva dëshmish ndaj "Gjenocidit" të "Njeriut të ri". Janë disa perspektiva dominuese nga të cilat rrëfehen tregimet në Kur Këndonin Gjelat e Tretë: ajo infantile, e gruas, e familjes/familjarit, në të vërtetë perspektiva e rrëfimit përfshinë edhe dëshminë eqoftë, edhe të një pianoje të marrë në Austri (tregimi Pianofortja e Çitës). Por ajo që është më tronditëse nga të gjitha perspektivat e rrëfimit të këtyre tregimeve është 'kthimi i shpirtrave', 'rrëfimi i shpirtrave një çast para shkëputjes', 'lëngimi i shpirtrave nën ndriçimin e prozhetorëve të masakrave", pra perspektiva e rrëfimit të shpirtit.

Duke shkuar me radhë, në – perspektivën e infantiles – viktimë, përmbledhja fillon me tregimin "Sajza" një shpirt infantileje që shtegton nëpër ujin e lumit duke qenë se nuk a kanë lënë "të rilind si lule" me zhvarrosjen e varrit të saj në përhershmëri, derisa edhe ia kanë hedhë në lum eshtrat dhe mbetjet e trupit të saj. Ky është horrori, që endet brenda kësaj historie, të shpirtit infantil i cili endet në lum në përhershmëri, me realitetine zhvarrosjes dhe humbjes së eshtrave të edhe fëmijëve, gjatë komunizmit, dhe po ashtu me tregimin brenda po të njëjtit tregim, që ia thotë nëna personazhes – shpirt – para vdekjes,se do të ketë "rilindjen e saj si lule" pas vdekjes. Ky horror është ndërthurja e vdekjes së pa emër të fëmijëve (siç dëshmohet në fund të librit për masakrën e Tepelenës, me mbi 300 fëmijë e foshnje të vdekura), vrasja e pa emër – totale -, dhe realiteti, qoftë ai i kohës reale e qoftë ai i të sotshmes, që vuan mungesën e emërimit të këtyre masakrave.

Në të vërtetë infantilja e ngujuar brenda "ortekut të dhunës" (sipas njërit prej tregimeve në këtë përmbledhje) është e pa emër, sepse infantilja është e pa përvojë dhe e pagjykueshme qoftë nën ndriçimin e "Prozhetorëve të masakrave të Bijëve të Stalinit". Në të vërtetë infantilja ende nuk ka pasur një emër, një faj, një "aktakuzë" të qëndrueshme. Përpos aktakuzës së ishin infantile e "jetës reaksionare". Sajza është rikrijuar, dhe është ri-konstelacion i shpirtërores, është rikthim për të kërkuar emrin e saj, për të gjetur emrin e saj , për të gjetur edhe varrin por edhe vendin e saj, e me këtë të fundit, edhe për të përmbushur emrin e saj. Në këtë, edhe vendi, me këtë dëshmi, duke mbetur i pa emër po ashtu.

– Perspektiva e gruas – dominon në dy perspektivat: në vullgaren e të dhunuarit të saj seksual, si thyerje, si shfytyrim dhe si shkatërrim i njeriut, por me të njëjtën duke e mbajtur të gjallë, për të shërbyer qoftë si dëshmi e 'mundësisë' së dhunës, dhe qoftë si 'përherëshmëri' e dhunës. Në anën tjetër, gruaja si nënë, është nënë që i bindet instinktit të saj për të – vazhduar jetën – për të vazhduar llojin (e njeriut), për të vazhduar familjen. Ajo në fund, kur edhe ka dështuar si nënë, në të gjallë, vazhdon duke shqyer rrobat e saj për "qefin" të fëmijës së vet, si në tregimin "Qefini". Ajo ende vazhdon të jetoj, jetën e plotë, paradoksalisht, duke kërkuar të krijoj mburojën për atë jetë, të amshimit dhe të përkujtimit.

– Perspektiva e familjes- , më së miri vërehet në një prej tregimeve më mbresëlënës të përmbledhjes "Ku po shkon, babë…"; jo në përhumbjen dhe tronditjen e babait të familjes që ka varrosur të gjithë anëtarët në kazamatin komunist, i cili në momentin e përballjes me shenjë jete siç është gurgullima e lumit Vjosë, do të kthehet në Komandë për të kërkuar familjen e tij, por në mënyrën dhe rendin si i ka varrosur të gjithë anëtarët e familjes:

"E vorrova në të djathtë të nanës së tyne. Pa i mbushë 5 pranverat, Tash ajo (Nëna) i ka dy djemtë në të majtë, dy çikat në të djathtë."

Në këtë renditje, ai ende ruan rendin e familjes, ende ruan rendin e njerëzores, ende ruan rendin e jetës/familjes, ai është ende me ta. Ende është ndërmjet të gjallëve të vetdhe vdekjes, ende është ndërmjet jetës dhe vdekjes, dhe në transin e dhembjes së familjes. Mirëpo ai ende ruan emrin dhe rendin e emrit të të gjithëve bashkë, "Tash ajo i ka dy djemtë në të majtë, dy çikat në të majtë". Ende nuk ka përfunduar asgjë. Ende i kanë varret. Ende i kanë anët e tyre,dhe vendin e tij secili anëtar i familjes, bashkë, të vdekur!

-Perspektiva e shpirtit

Në përmbledhjen "Kur këndonin…" të Agron Tufës, shpirti është aty brenda masakrës, qenie në vete. Është këtu brenda masakrës për herën e dytë, si i kthyer, për të dëshmuar para nesh. Shpirti është qenia që "shikon lëvozhgën/trupin", shpirti që "rri roje përreth rrënojës së vet trupore:"

Më poshtë janë marrë shembull tri tregime të cilat e përshkruajnë me logjikë gjuhe dhe qenieje, që e monologojnë shpirtin duke lënë këtë botë.

Në tregimin e parë, shembull këtu, shpirti "ikë si shpend", dhe braktisë "lëvozhgën e munduar të trupit" në një "fërfëllimë" pamjeje, dhe braktisë prezencën, derisa për pamje të fundit të prezencës ka "mijëra hije njerëzore të llangosur me llucë".

Tregimi "Dhëmbët e floririt"

"… Pastaj, me radhë, tre pickime të hidhura. I numërova. Bashkë me pickimin e tretë ndjeva se u shkul prej meje edhe shpirti. I dlirë, i lehtë, shpirti e braktisi këtë lëvozhgë të munduar dhe si një shpend i trishtuar, kaptoi barakën, u ngjit mbi Këneta, duke marrë me vete pamjen e mijëra hijeve njerëzore të llangosura me llucë dhe pikëllimin e ujërave të verdha midis kallamishteve që dridheshin e fërfëllonin në erë."

Në këtë tregim krijohet ndjesia e lirisë së braktisjes së shpirtit, pas një absurdi vullgar. Zëri i narracionit është i lehtë, i dlirë dhe i pagjakim për jetën, i pa ankesë dhe as keqardhje. Është i lirë, prapë dhe përtej kalimit të dhunës në absurdin e saj. Emri ka mbetur në "hije të mijëra njerëzve". Logjika e këtij rrëfimi, këtij lloji duke arritur mjeshtëri artistike të zërit të rrëfimit në tregim, lehtësinë dhe dëlirësinë, duke shuar pyetjen – nga erdhi dhe si u kthye ky shpirt për të dëshmuar -. E lë si logjikë e shpirtit të ikur, si fatalitet dhe pakthyeshmëri.

Në tregimin, e dytë shembull këtu, shpirti, i njeriut i cili tërë jetën e tij ia ka kushtuar shpirtërores së njeriut është në çlirimin e tij të "dalë-ngadalshëm" deri në "kthjellim". Shpirti është në kalim e sipër, prej "shpërqendrimit" e në "kthjellim", e në "unifikimin nga lehtësimi prej barrës tokësore".

Tregimi "Kur kënduan gjelat e tretë"

"… kërsima buçitëse e kobures më shpërqendroi….Dalëngadalë, gjithçka nisi të kthjellohej, tok me njësinë e lehtësimit nga barra tokësore…"

Në të vërtetë dëshmia e shpirtit që ikë në "kthjellim" është dëshmi e cila ka një sinqeritet serioz dhe të thjeshtë deri në 'vërtetësi' të kësaj lirie, dhe të këtij procesi. Është dëshmi e cila krijon vërtetësinë e krimit, derisa 'shpirti' rrëfen. Është moment kur pyetesh "si ndodhi, si u rrëfye kjo dëshmi? Kur i vdekuri, njeriu iku në "kthjellim", dritë?" Pra derisa në tregimin e parë shembull këtu, nuk arrijmë të pyetemi për logjikën e shpirtit që flet, që dëshmon, që nuk kërkon emrin e tij "Në mesin e mijëra hijeve të njerëzve", në tregimin e dytë shembull këtu, tanimë pyetemi, përmes seriozitetit dhe 'vërtetësisë' së braktisjes së shpirtit, krijohet logjika e shpirtit – me emër -.

Në tregimin e tretë, të zgjedhur këtu si shembull, shpirti dëshmon tërë ngjarjen, që nga fillimi, në rrjedhë e sipër e deri tek ndarja për në amshim. Në të vërtetë shpirti, paradoksalisht, jeton ndanë trupit të tij që duhet vrarë për së dyti, dhe në këmbë, pasi që është vrarë një herë. Dëshmi e shpirtit i cili në "naiven" e tij të pa ankesë të pa keqardhje, të pa dyshimin njerëzor dhe të pa dhembje njerëzore, ndien nostalgji për trupin. Kështu duke krijuar logjikë ndërmjet dy ndarjeve të njeriut, logjikë e cila përballë lexuesin, në këtë dëshmi, me ekzekutuesit e këtij trupi; me -kalimin e njeriut në diçka të panjohur, të pa realitet, të pabesueshëm në pandjeshmërinë e tij.

Tregimi "Në këmbë: Te "Përroi i Qenve""

"Asgjë më nuk ndreqej. Pashë si u tërbua kapiteni. Si e gjuajti me shqelm kufomën time ende të ngrohtë… Nuk arrija të përshtatesha me gjendjen e re. Doja të kthehesha në trupin tim, por nuk mundesha. Filli i balonës që më lidhte me bujtinën time prej mishi, qe këputur. Përfundimisht. Megjithatë unë ekzistoja. Pluskoja padukshëm në ajrin e qelisë. Pa peshë. Pa formë. Pa dhimbje. I çliruar, por ende nostalgjik. Ende roje përreth rrënojës sime trupore… Trupat e gjallë u kositën pjerrtaz. Vetëm kufoma ime qëndroi, si më parë, në këmbë. E pandjeshme ndaj plumbave."

Në të vërtetë në këtë shembull, të tregimit "Në këmbë: Te përroi i Qenve" vrasja, përballë dëshmitarit, pra përballë shpirtit, me trupin e vet që i ka mbetur peng, është diçka e pa lidhje me njerëzoren që ka pasur trupi i vrarë, është punë, aq më shumë, vrasja është tërësisht e shkëputur nga dhembja, etika apo qoftë edhe jeta, është obligim, që duhet kryer, qoftë për të dytën herë. Është – emri – i cili nuk arrin të theksohet, emri njeri, si përvojë dhe dëshmi, sepse ajo përballë, "njeriu i ri" më nuk është njeri, ka kaluar përtej logjikës së shpirtit dhe trupit, në pandjeshmërinë e pabesueshme dhe të paarritshme.

Por në të vërtetë, perspektiva e rrëfimit prej anës së shpirtit, sikur në këto tregime këtu, është logjikë e cila dëshmon përtej vrasjes, dhunës, qoftë absurde dhe vullgare, dhe përtej sadizmit, dëshmon duke krijuar logjikën e shpirtit që rri peng ndaj trupit të tij dhe anasjelltas, logjikë e cila krijon "çlirimin" e asaj që ka mbete prej përvojës njerëzore, tutje në "fërfëllimë". Mirëpo "fërfëllimë e cila bartë me vete pamjen e mijëra hijeve njerëzore të llangosura me llucë". Por e tërë kjo logjikë, ndërmjet trupit dhe shpirtit si dëshmitar ndodh përballë njeriut, dhunuesit dhe vrasësit, nën "Prozhetorët e pushkatimit". Në të vërtetë, edhe pse në leximin direkt është kthim i njeriut për të kërkuar drejtësinë evënies së emrit vrasjes së tij, në të vërtetë është e paikshmja e fajit, është ngujimi i të vrarit, viktimës dhe të paemëruarit dhe të paemrit, në këtë botë. Apo, thënë ndryshe, "çlirim" i pa keqardhje, që në këtë na lë neve dëshmitarë në pamundësi për të ikur prej përgjegjësisë që bartim.

Gjuha e shpirtit, sidomos me trupin e tij, me sensin e shpirtit ndaj trupit të tij, me "nostalgjinë" e tij ndaj trupit, në të vërtetë është, qoftë si mjeshtëri letrare artistike, dhe qoftë si dëshmi, ri-konstelacion i përvojës, rikthim i njerëzores së munguar, të shtypur, të masakruar, në emër, qoftë emri të jetë – shpirt.

Por, duke lexuar këtë libër, këto dëshmi që të çjerrin zemrën, nuk mund të mos pyetemi për të pafundmen herë: çka ka ndodhur në të vërtetë? Ku u zhvesh njerëzia dhe kaloi në një çarje ndërmjet trupit që nuk mbante më, qoftë dhunën, qoftë të të qenit të dhunuar, në shpirt që ka peng trupin si "lëvozhgë"?

Me shpikjen e "një bote të re", "një njeriu të ri", njeriu kaloi në regresin brenda kompleksit të ashtuquajtur anal – sadist. Kompleks kur fëmija hynë në botën si i ndarë nga tjetri, dhe me këtë zhvillon sadizmin, me këtë tenton të zhdukë tjetrin, dhe të arrijë tërë botën dhe me këtë ta mbajë botën për vete. Në këtë "katilët" – njeriu i ri, u kthye në regres në sadizëm infantil, që do të thotë e rezervoi vetëdijen, fajin dhe gjykimin etik, vetë njerëzoren në një botë të sajuar, në "Një botë të re" që i takonte vetëm atij, dhe me këtë arriti deri në fund, në të vërtetë deri në pafundësinë e dhunës, në dhunë totale, në vetë tendencën e botës, natyrës për në të ligën,në realen e pandjeshmërisë së kësaj bote.

Ç' është e vërteta, ai duke pas rezervuar të gjitha në "botën e re", ai nuk pati vetëdije më të lartë se të fëmijës që po hynë në botën që e ndanë me tjetrin, dhe në këtë deshi dhe gjeti argumentin për të zhdukur tjetrin.

Në të vërtetë vrasësit me vetëdije infantile janë vrasës të cilët nuk arrijnë të gjykojnë as kënaqësinë dhe as efektin e vrasjes, sepse nuk e kanë këtë aftësi, pra të të gjykuarit. E me këtë asnjëherë nuk arrijnë të ndjejnë fajin dhe përgjegjësinë.

Gjë që do të thotë se ende nuk kanë dalë nga ky rezervim i gjykimit të tyre, "Në të qenit bijtë e Stalinit" të botës së re, dhe ende nuk e kanë aftësinë e gjykimit.

Në fund të fundit, vetë Kanuni, duke e njohur mirë rrezikun e fajit të vrasësit, e sheh si të domosdoshme jo zbutjen, as faljen, por 'sublimimin' e fajit të vrasësit, të bërit të tij të prekshëm për vrasësin. Përndryshe nuk ka drejtësi.


– Perspektiva e " bijve të Stalinit", Perspektiva e "Njeriut të ri" –

Duke iu kthyer fillimit, thjeshtë duhet të pyetemi, si nuk ka asnjë që rrëfen, qoftë si i penduar e qoftë si "Brigadier" i kauzës, së "Meshave të zeza" komuniste. Ka vetëm moment kur ata bëhen të dukshëm , por jo edhe të vetëdijshëm, të përkujtuar por jo edhe të vetëdijshëm. Në një moment, në tregimin "Shqelmi", shfaqet qartë ikja ekësaj bote të re nga mundësia e komunikimit njerëzor. "Roja"i këtij tregimi, pasi që ka shkelmuar një nënë që ka ardhur për të vizituar të briri e saj, dhe pasi që i biri i saj i ka thënë se "nëna e tij nuk do të shqelmohej nga viktima në mënyrën si ka bërë ai", "roja" nuk ka përgjigje. Ai përshkruhet kështu*"roja brutal më pa me disa çaste me sytë e idiotit, që dëgjon, por nuk kupton … dhe thirri… për pendrek…"*. Është pamundësia për të arritur deri tek ndjeshmëria birë – nënë, humbur diku në mes të vërshimit, ortekut të krimit. Mungesa e një fytyre që i rri përballë viktimave të këtij kaosi "kainiade" (siç e quan Tufa), një fytyre që ka kryer këtë urdhër, këtë 'ndërmarrje', këtë organizim, që ka totalizuar këtë kaos, këtë horror, është në të vërtetë mungesa e një realeje të po kësaj/këtyre fytyrave, qoftë sot në demokracinë e shtetit të Shqipërisë, e qoftë në pragun e rënies së komunizmit, e qoftë në kohën kur ka ndodhur kjo "kainiadë".

Mungesa e fytyrës është pritja që i shkakton ky libër, jo vetëm atyre, por tërë shoqërisë shqiptare, që këta kainë të dalin përballë e të rrëfejnë.

Ku mbetet pra emri, i Sajzës, i Lukës pa peng, i gjithë shpirtrave që kthehen e dëshmojnë? Emri i Shqipërisë? Si demokraci, apo si kimerë? Apo e pa fytyrë. E pa emër, duke qenë se nuk ka një varr për infantilen e masakruar të tërë një kolektivi. Duke qenë se nuk ka një gjykim për këto varre. Duke qenë se nuk ka një rrëfim përballë këtij emri.

botime



Botimet: Skanderbeg Books
ISBN: 978-9928-221-37-7
Nr. faqeve: 366
Çmimi: 1200 lekë

Flutura Açka dhe "**Biri**", një libër për të gjallët

Nga **LEONARD VEIZI**

Përtej asaj që është e mundshme, në krejt pamundësinë e saj, me një sforco gërryese, ethëse, të brishtë dhe shpërbërëse hera-herës, ajo arriti të ngrihej me plagën e pambyllur. Mori pak letër..., dhe mori një penë. E nisi të shkruajë...

"Nuk është e lehtë për prindin ta lyejë bojën me të zezë..." kishte shënuar më parë se kaq, në faqen e ftohtë të ekranit, teksa në një çast përhumbeje, në mosbesimin e vazhdueshëm për të mos pranuar fatin deri në skajin më ekstrem, vendosi t'u japë miqve lajmin e trishtueshëm, se djali i saj i vetëm, në një pamundësi jete shkoi përtej, atje ku askush nga të gjallët nuk e di, në është ferri i frikshëm dhe djalli ndëshkues, apo parajsa e pretenduar, shtruar me bardhësinë hyjnore.

Tashmë, e gjithë jeta e saj është e lexueshme, faqe pas faqesh, në një libër me titullin aq të shkurtër, por të gjithëkuptimtë: "Biri".

Ngushëlluese dhe po aq njerëzore. Sepse është një libër i shkruar për më të dashurin, pjesë e trupit dhe e gjakut; pra vetvetja. E, pa dyshim, është dhe një ngarkesë emocionale, e cila nis të shkarkohet për të të krijuar një lehtësim të përkohshëm, të çuditshëm e, hera-herës, indiferent. Kjo është jeta, dhe ne nuk kemi në dorë asgjë, edhe pse luftojmë aq fort për të qenë mbi dhe, pjesë e një cikli sa të bukur, aq edhe absurd.


Mendimet vijnë e ikin, hidhen mbi letrën e bardhë e bëhen të palexueshme nga lotët që rrëshqasin pa dashur. Dhe të duhet gjithçka ta rishkruash, vetëm se këtë herë në një tjetër mënyrë rreth të njëjtit bosht.

Prandaj vjen një çast kur gjithçka kërkon ta ndash me të tjerët, miq e shokë, por dhe të panjohur gjithashtu. Sepse duhet që historia jote të depërtojë, për të dhënë një mesazh universal.


Në 6 maj 2018 në postimin e saj informues Flutura Açka do të shkruante: "Miq. Mbrëmë, në një orë të vonë të natës, u nda nga jeta Biri ynë i vetëm, Jerin van den Brink, në të tetëmbëdhjetat e tij, prej një sëmundjeje shumë të rrallë, nga e cila vuajti kohët e fundit. Nuk është e lehtë për prindin ta lyejë bojën me të zezë për të tillë lajm, as ta pranojë humbjen e qenies më të dashur që patëm, dhe kemi, mbi këtë dhe. Me drojën se nuk do të mësohemi kurrë me mungesën e tij, urojmë të dëgjojmë vetëm lajme të mira prej jush... Flutura & Richard".

Më shumë se dy vite pas këtij çasti, ajo ndan një tjetër emocion: botimin e një libri, me jetën e tij e të sajën bashkë. "Ky është libri im, që nuk kam pasur as dëshirë as nevojë ta shkruaj, por fati më shtyu", – shprehet shkrimtarja, e cila shton gjithashtu se ndihet më e qetë, pas mjegullës ku i është dashur të ecë me plot tension psikik. Sepse, në fund të fundit, dhe gjithmonë bëhet fjalë për një bir, fizikisht të munguar, por që me forcën e fjalës së shkruar do ta mbash në shtrat a poshtë nënkresës për ta lexuar në një vazhdimësi marramendase e torturuese.

BOTIME TË REJA




Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-56-9
Nr. faqeve: 96
Çmimi: 600 lekë



Botimet Ëest Print
ISBN: 978-9928-249-83-8
Nr. faqeve: 308
Çmimi: 800 lekë



Botimet M&B
ISBN: 978-9928-307-095
Nr. faqeve: 128
Çmimi: 800 lekë




Botimet Ëest Print
ISBN: 978-9928-307-11-8
Nr. faqeve: 248
Çmimi: 700 lekë

BOTIMET M&B
mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283

*Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia; rrjetit të librarive "*ADRION*"; librari "*Art's*" të Stacioni i Trenit në Tiranë;* FletaXXI *në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit ose online në* www.bukinist.al

cyan magenta yelloë black



Shkozë Tiranë

SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Sëift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**



Rruga e Arbërit nr. 170

histori

Karakteri i fortë, shpirti luftarak, dëshira për t'u pajisur me armë të reja, bëri që shumë çidhnakë të shkruhen vullnetarë për në Shkodër.

Kryengritja kundër serbe e shtatorit 1913

RËNIA E PERANDORISË OSMANE

Sipas të dhënave historike, mësojmë se ajo që më së shumti ndikoi në rrokullimën e Perandorisë Osmane ishte edhe Kryengritja e Përgjithshme e popullit shqiptar, e cila nisi në Kosovë, por që shpejt përfshiu gjithë Shqipërinë. Pikërisht, kjo Kryengritje shënoi edhe fillimin e shkatërrimit të Perandorisë Otomane. Për shkaqet e kësaj rënie, S.Brestovci shkruan: *"...Shkaqet e rënies së Perandorisë Osmane burojnë në radhë të parë nga kriza e bazës së saj ekonomiko-shoqërore, nga shtresëzimi dhe shthurja e strukturës së saj timariotiste. Kjo gjë është e pashmangshme për të gjitha monarkitë e ngjashme pas pushtimeve të tilla. Prandaj, procesi në fjalë shpuri kah anarkia dhe padëshueshmëria e vetë jeniçerëve ndaj zotëruesit të tyre... Në fund të shek XVI difiçiti i Perandorisë Turke ishte 3 herë më i madhë se sa të ardhurat e saja shtetrore..."*

Pas shpartallimit e rënies së Perandorisë Osmane, kombësia shqiptare mbetej në katër vilajete, gjë e cila sillte shqetësim të thellë në kancelaritë e shteteve ballkanike, që synonin të rrëmbenin copa të mëdha teritori të ish-Perandorisë së rrënuar. Lukuni të tëra pushtuesish serb, malazes e grekë iu drejtuan kufijve të Shqipërisë, duke krijuar situatën më të vështirë në historinë e mbrojtjes së trojeve amtare. *"Nga fundi i tetorit ata (fqinjtë pushtues - H.P), filluan të flasin hapur për copëtimin e Shqipërisë."*

Zbatimi i atij plani të kobshëm për coptimin e atdheut, filloi me Luftën e Shkodrës, e cila çeli "siparin" e një konflikti shekullor me serbin. Ajo filloi më 8 tetor 1912 dhe mbaroi më 25.4.1913. Menjëherë pas Serbisë edhe shtetet tjera Ballkanike, sipas parimit "u bë deti kos, merr lugën e madhe", i shpallën me radhë luftë Turqisë me qëllimin që, kur të ulen në tavolinë, të përfitojnë nga territoret e ish-Perandorisë. Kështu më 14 tetor 1912, Mali Zi shpalli luftë Turqisë, ndërsa më 16 tetor 1912 Serbia dhe Bullgaria dhe, në fund, më 18 tetor 1912, edhe Greqia. Shqipërisë i kanosej një rrezik tjetër, ai i kalimit nga robëria Osmane në atë serbe.

Veprimtaria dhe aktiviteti i madh i Qeverisë serbe, për të rivendikuar kufijtë, projektonte një situatë mjaft komplekse në marrëdhëniet e ardhshme me Serbinë. Qeveria Jugosllave nxori "*Dekret-ligjin mbi vënien e pushtetit në viset e çliruara*",sipas të cilit, në zonat e pushtuara nga serbët, vendosej pushteti i jashtzakonshëm ushtarak dhe policor. Veç kësaj, serbët krijuan edhe një Komision, i cili do të zgjidhte kontestet në fshatrat kufitare, në krye të të cilit ishte antishqiptari i njohur Vasileviq.

Në vitin 1912 (tetor), pikërisht në kohën kur përpjekjet e patriotëve shqiptarë po intensifikoheshin dhe përgatisnin Pavarësinë e Shqipërisë, ushtri të tëra serbësh e malazezësh kërkonin të shkëpusnin pjesë nga trupi i gjakosur e i copëtuar nga ajo çka kishte mbetur e që quhej Shqipëri. Lufta Ballkanike kishte filluar. Shovinistët serb e malazes nuk lanë rast pa shfrytëzuar për t'i siguruar vetes të drejtën e aneksimit të shumë tokave shqiptare.

Sipas ***"Shtojcës sekrete"*** të Traktatit të Miqësisë në mes të Serbisë dhe Bullgarisë, të përfunduar më 29 shkurt 1912, Serbisë i sigurohej dalja në Adriatik, aq shumë e dëshiruar.[212] Shkodranët, duke e parë në sy rrezikun e copëtimit dhe të mbetjes jashtë kufirit, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të forcave, u detyruan t'ju drejtohen për ndihmë gjithë krahinave të Veriut. Kjo thirrje mbërriti deri në Dibër.

DIBRANËT NË MBROJTJE TË SHKODRËS

Dibra e Epërme nuk mundi t'i përgjigjej kësaj thirrje, pasi forcat shoviniste greke ishin drejtuar për në Veri, ndërsa patriotët e Dibrës së Poshtme, nën udhëheqjen e Isuf bej Hysenagollit, ia dolën të mbledhin mbi 4000 vullnetarë, të cilët do t'i shkonin në ndihmë Shkodrës.

Në mes këtyre burrave ishin edhe mbi 1000 çidhnakë, të cilët të udhëhequr nga Selman Alia, Llan Kaloshi e Shaban Lusha u rreshtuan me këtë ushtri. Lajmi për të shkuar vullnetarë në Shkodër dhe se atyre do t'u jepeshin nga një armë e municion, u përhap shpejt në Çidhën. *"Ishim në dasëm tek H.Loka,* kujtonte Halil Pashnjari*, kur erdhi një e na solli selamin e Selman Alisë për luftë. Burrat që ishin në dasëm e lanë atë dhe u nisën për të marrë armë në Shehër. Kazanët e mishit i kishin derdhë, pasi aty mbetën vetëm gratë e fëmijët".*

Patriotët e Dibrës së Poshtme, nën udhëheqjen e Isuf bej Hysenagollit, ia dolën të mbledhin mbi 4000 vullnetarë, të cilët do t'i shkonin në ndihmë Shkodrës. Në mes këtyre burrave ishin edhe mbi 1000 çidhnakë, të cilët të udhëhequr nga Selman Alia, Llan Kaloshi e Shaban Lusha u rreshtuan me këtë ushtri. Lajmi për të shkuar vullnetarë në Shkodër dhe se atyre do t'u jepeshin nga një armë e municion, u përhap shpejt në Çidhën.

Karakteri i fortë, shpirti luftarak, dëshira për tu pajisur me armë të reja, bëri që shumë çidhnakë të shkruhen vullnetarë për në Shkodër. Pasi u pajisën me armë e municion, çidhnakët u kthyen të kënaqur nga Shehri i Dibrës dhe qëndronin gati të niseshin për Shkodër, sapo t'i njoftonin.

Grumbullimi i çidhnakëve dhe nisja për në Shkodër u bë tek Ferra e Pashës. Dibranët u nisën, duke pasë me vete edhe 2 topa, por nuk mundën të kalojnë shkurt nëpër Mirditë, pasi Kapedani i Mirditës nuk u dha udhë e për këtë arsye ata iu drejtuan Matit. Rrugës, kur kolona e vullnetarëve dibranë ndodhej në Mat, një letër e Sheh Shezumanit të Vleshës, njofton Elez Isufin, se *"forca të shumta serbe i janë drejtuar Prizerenit e Lumës"*. Pas konsultimeve, u vendos që Elez Isufi me forcat e tij të kthehej për të mbrojtur trevën nga ndonjë sulm i mundshëm serb. Vllamasi tregon se, fuqitë dibrane u ndanë më tresh:

" 1. Me në krye Selman Alinë e Llan Kaloshin etj, shkojnë për të mbrojtur garnizonin e Shkodrës,... nën komandën e Hasan Riza Pashëse më vonë të Esat Toptanit.

*2. Nën drejtimin e Elez Isufit, Shaban Lushës (*gabim, duhet Met Dedes H.P*) etj. shkuan në Kolosjan...*

3. Forcat serbe sulmojnë edhe Dibrën e Madhe..."

Ishin të shumta fushëbetejat e dibranëve por më e spikatura ishte ajo për mbrojtjen e Taraboshit e më pas ajo e Bërdicës.

Aq i madh ishte gëzimi që ngjalli shkuarja e dibranëve dhe heroizmi e trimëria e tyre e treguar në luftë, sa që shpejt atyre iu këndua kënga*: "Një takam qi janë dibranë, / Ata brejshin hekur me dhamë. / Nji takam kah Gjakova, / Bajnë irish e hidhen n'topa. / Irish m'topa e hipin n'grika, / Bajnë shiçir qi na erdh Dibra."*

Çidhnakët, të udhëhequr nga plaku 60 vjeçar Selman Alia dhe të frymëzuar nga trimëria e Shaban Lushës, luftuan me heroizëm në çdo pëllëmbë tokë. Aktet heroike të çidhnakëve ishin të panumërta, të përditshme, në çdo pëllëmbë llogoreje. Qëndrimi i tejzgjatur në llogore dhe ushqyerja me një copë peksimet, të cilin e hanin pasi lidhnin sytë, që të mos shihnin krymbat, nuk i dobësuan për asnjë çast dibranët. Vuajtjet e tyre në llogore janë bërë objekt shkrimesh për shumë personalitete të fushës së letrave.

DORËZIMI I SHKODRËS. KTHIMI I ÇIDHNAKËVE

Më 22 prill 1913, Esat Pashë Toptani nënshkroi marrëveshjen e kapitullimit me forcat malazeze, duke siguruar, këto të fundit, atë që s'ia arritën me luftë. Pas 6 muaj luftë e sakrifica të mëdha, forcat vullnetare dibrane u kthyen nëpër shtëpi dhe e gjetën anën e djathtë të Drinit të okupuar nga forcat serbe. *"Nuk kish nevojë t'i pyesje se kishin qënë në Luftën e Shkodrës, pasi ata tregonin në fytyrë,* kujtonin pleqtë: *ata ishin të verdhë, sikur kishin dalë nga varri."*

Vuajtjet që ata kishin kaluar gjatë periudhës së luftës, janë të përmasave biblike. Megjithatë, kthimi në shtëpi i trimave të luftës së Shkodrës, nuk u rezervonte ndonjë qëndrim të këndshëm. Ata kërkoheshin nga serbët për t'u arrestuar ndaj ishin të detyruar të qëndronin të fshehur. Askush nuk guxonte të kalonte e të dilte në pjesën lindore të Drinit, ku shtrirja e pushtimit serb shkonte sipas idesë së vijës strategjike, apo siç thuhej në popull "*për Drini*".

SITUATA NË ZONËN E PUSHTUAR NGA SERBËT

Në fakt, pasi vullnetarët ishin nisë për në Shkodër, nuk kishte vonuar shumë dhe forcat serbe ishin vendosur përgjatë luginës së Drinit. Një ditë para shpalljes së Pavarësisë, ushtritë serbe ishin ulur këmbëkryq, duke synuar *"vijën strategjike"*. Këtu vendosën një regjim të egër pushtimi në gjithë pellgun e lumit Drin. Artilieria serbe gati çdo ditë qëllonte me top fshatrat e bregut perëndimor të Drinit, duke shkatërruar shumë shtëpi, duke i menduar si istikame të të kthyerve nga Shkodra.

Kudo shkeli këmba e serbëve vinte era shkrumb e hi. Ata vranë e prenë shumë njerëz të pafajshëm, ndoqën e persekutuan familjet e pjesëmarrësve të Luftës së Shkodrës, shumë prej të cilëve, për t'i shpëtuar terrorit, u strehuan në thellësi të maleve. Gjatë gjithë verës së vitit 1913, Selman Alia, edhe pse me plagë të rënda nga Lufta e Shkodrës, nuk reshti për asnjë çast ecejaket e takimet me Elez Isufin e të tjerë patriotë të zonave fqinje, për të organizuar çlirimin e vendit, ndërkohë që në zonat e pushtuara *"Terrori serb vazhdonte kudo dhe shumë veta largoheshin emigrantë"*. Këto përpjekje të patriotëve të Dibrës së Poshtme, për organizimin e një kryengritjeje të fuqishme, nuk kaloi pa u kuptuar nga forcat serbe. Ata kishin zbuluar se diçka po lëvizte, ndaj dhe komandanti i garnizonit të Ostushit, thërret krahinarin e anës së përtejme të Drinit (anës perëndimore të Drinit), Dali Xhikën, për ta pyetur për lëvizjet e dyshimta të patriotëve dhe për organizimin e kryengritjes.

Sigurisht që Daliu u përpoq që çdo gjë ta paraqesë si normale dhe se nuk kish asnjë shenjë të ndonjë organizimi për kryengritje. Komandanti serb nuk i besoi Daliut, prandaj urdhëroi ushtarët që ta përcillnin dhe ta vrisnin. Dhe, në fakt, ashtu ndodhi. Ushtarët e përcollën deri tek Ura e Lushës dhe aty e vranë e më pas e lëshuan në Drin. Trupi i Dali Mud Xhikës u gjet rastësisht në shkurret e lumit pas tre ditësh, afër Rrasës së Bollës.

Varrimi i Daliut u shndërrua në një procesion, i cili, i mobilizoi akoma më shumë çidhnakët për të rrokur armët. Fati e kish sjellë që një pjesë e Çidhnës të ishte në sytë e pangopur të interesave serbe. Se sa të mëdha ishin interesat qeverisë serbe për gjithë anën e lindore të Drinit, e tregon edhe deklerata e përfaqësuesit të Serbisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, i cili mes tjerash deklaronte*: "Jemi gati të tërhiqemi nga Bregu i detit Adriatik, si dhe nga të gjitha ato vise që do të përfshihen në kufinjtë e Shqipërisë autonome, me përjashtim të Dibrës, Ohërit, Manastririt e sipër, të cilët duhet të hyjnë brenda kufijve të Serbisë."*

Në këto kushte, kur qeveria serbe nuk deshte kurrësesi të lironte trevën e Dibrës dhe, kur Konferenca e Londrës në korrik 1913 la jashta kufijve gati gjysmën e tokave shqiptare, fillimi i kryengritjes kundër pushtuesve serbë, ishte një imperativ i kohës, i cili lidhej me ekzistencën e krahinës, Dibrës e të gjithë kombit tonë. Edhe Qeveria e Përkohëshme e Vlorës e vlerësoi situatën e krijuar, ku me anën e një letre i drejtohet presidentit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, z. Eduard Greit, në të cilën mes tjerash kërkohej: *"... të lejojë që qyteti i Dibrës bashkë me pjesën e pandashme që i përcillet Shqipërisë, të vihet nën regjimin e Qeverisë Provizore Shqiptare... Në emër të drejtësisë, nà e përsërisim lutjen tonë që të mos lejohet që ... të shkaktohet një kryengritje."*

... Aso kohe (shtator 1913), të gjithë të kthyerit nga Lufta e Shkodrës, vazhdonin të ruheshin e të lëviznin me kujdes, por gjithnjë në anën perëndimore të Drinit. Shumica e familjeve të fshatrave Fushë-Alie, Laçes , Blliçe dhe Rrenx, ishin larguar nga shtëpitë e tyre dhe, që prej nëntorit 1912, vazhdonin të strehoheshin tek të afërmit e tyre, kryesisht në Mustafe, Sinë, Çidhën e Grykë - Nokë, në Zall - Dardhë e deri në Lurë.

PËRPJEKJE TË PATRIOTËVE PËR TË ORGANIZUAR KRYENGRITJEN

Në këtë kohë, çdo odë në Çidhën e më gjërë ishin kthyer në kuvend burrash, ku flitej për lirinë e atdheut. E, pikërisht në këto kuvende të thjeshta u përgatit kryengritja, e cila ish gati për të shpërthyer. Ishte fillim shtatori dhe forcat patriotike çidhnake zhvillojnë një përpjekje të armatosur me patrullat serbe në Arras. Për këtë përpjekje të armatosur edhe Naçallniku i Dibrës, N.Cirkoviç, në një raport për Shkupin shkruante: *"...Më 7 shtator 1913, një njësi e fortë shqiptare e kishte sulmuar pararojën serbe te Ura e Arrasit. Ajo e shpërndau atë dhe kishte kaluar në anën e djathtë të lumit Drin. (Për këtë kemi lajmëruar inspektorin në Shkup)*

PËRPJEKJA ME ARMË NË MES PATRULLËS SERBE DHE DY FSHATRAVE

Siç u përmend edhe më sipër, Selman Alia, megjithëse i sëmurë, ishte marrë vesh me Elez Isufin e udhëheqës të krahinave të tjera, që kryengritja të fillonte nga mezi i shtatorit, por pa caktuar datë fikse. Çdo gjë tashmë ishte gati, pritej vetëm sinjali për fillimin e luftës. Dhe momenti erdhi më 7 shtator 1913.

Sipas Ismail Strazimirit shkak për fillimin e kësaj kryengritjeje është vrasja e një tregtari shëtitës në Rrasë të Bollës. Ne mendojmë se në atë kohë tollovie e ankthi, nuk mund të jetë aq i saktë Strazimiri të përcaktojë, se cili qe shkaku i fillimit të parakohshëm të kryengritjes së palanifikuar. Ne, shumë kohë më parë, në vitin 1983, kemi studiuar dhe pastaj kemi referuar në një sesion shkencor për këtë problem. Duke "gërmuar" për këtë ngjarje, kemi mësuar se, atë ditë, vërtetë ka ndodhë një incident, vrasja e tregtarit belicar, siç e përshkruan I.Strazimiri. Por, po atë ditë, ka ndodhë edhe një përpjekje e armatosur në lagjen Lazrej të Fushë - Alies. Ky incident ishte shumë herë më i rëndë e më i madh, se ai që përshkruan I. Starzimiri.

Ne do të sjellim, siç e kemi vjelë nga pleqtë e atyre viteve.

... Aso kohe (shtator 1913), të gjithë të kthyerit nga Lufta e Shkodrës, vazhdonin të ruheshin e të lëviznin me kujdes, por gjithnjë në anën perëndimore të Drinit. Shumica e familjeve të fshatrave Fushë-Alie, Laçes , Blliçe dhe Rrenx, ishin larguar nga shtëpitë e tyre dhe, që prej nëntorit 1912, vazhdonin të strehoheshin tek të afërmit e tyre, kryesisht në Mustafe, Sinë, Çidhën e Grykë - Nokë, në Zall - Dardhë e deri në Lurë.

Fshatarët, herëpashere i "vizitonin" shtëpitë e tyre fshehurazi, bile me vështirësi të shumëta, ia kishin dalë që të mbillnin edhe gjatë pranverës 1913. Shtatori po vinte, misrat ishin bërë për t'u korrur, familjet vuanin për bukën e gojës. Pothuajse çdo natë në vahet e Drinit, që nga Rrasa e Bollës deri në Mollë të Hoxhe, me dhjetra malësorë kalonin me thasët e mbushur me misër të vjelur përgjatë natës. Në një natë të tillë, edhe Han Tota e Halim Marku, që të dy nga Fushë - Alia, kishin punuar gjithë natën për të zhveshur misër në arat e tyre.

Pasi i mbushën torbat me misër, dy fshatarët, duke iu shmangur vështrimit të patrullave serbe, takohen te Mani i Dukës dhe nisen poshtë, drejt Lazrejve, për të rënë në va tek Kroi i Martinit. Kur ata, me torba në krahë, ishin afër shtëpisë gjysmë të djegur të Vish Martinit, diktohen nga patrulla serbe, e cila sillej vërdallë lagjes. Serbët, sapo i shohin dy fshatarët me torba në krahë, bërtasin: "Stoj,stoj!" dhe vrapojnë drejt tyre. Dy fshatarët e kuptojnë se rreziku po u afrohej me shpejtësi, ndaj ato bënë një lëvizje taktike për t'i shpëtuar rrezikut. Ata u futën në shtëpinë e Vish Martinit nga dera, por dolën nga ana e pasme e saj dhe me vrap po iknin drejt Drinit. Forcat serbe kujonin se i kishin mbyllë në shtëpi, prandaj u pozicionuan para saj dhe filluan t'ju thërrisnin që të dilnin e të dorëzoheshin.

histori

Kjo luftë, e cila solli fitore të bukur Dibrës, nuk kishte se si të kalonte pa dëshmorët e martirët e saj, të cilët u rreshtuan në altarin e heronjve të tjerë të luftërave të mëparshme.

Kjo luftë, e cila solli fitore të bukur Dibrës, nuk kishte se si të kalonte pa dëshmorët e martirët e saj, të cilët u rreshtuan në altarin e heronjve të tjerë të luftërave të mëparshme. Burra të tillë si Haziz Lusha, Hajdar Noka(Vllanicë), Murat Skepi(Vllanicë), Can Han Xhari (Vllanicë), Llan Pali (Vllanicë), Muharrem Bitri(Vllanicë), Jashar Allaman Maleçka, Lokë Nuz Loka, Maliq Loka, Xhafer Loka, Ali Koltraka Kurt Sali Cuni, i vrarë tek Ura e Lushës; Sali Buci në Rrenx te Ara e Xhokës; Hysen Man Tusha, i vrarë tek lapidari i Suhodollit, Halit Kuta, Ferë Nezha, i vrarë në Grykë të Gramës, Dalip Hasi e Taf Hasi u vranë në Vllanicë, Ibrahim Paci në Peshkopi, Rushit Pashnjari, Xhetan Kaloshi, Maliq Loka, Xhafer Sulë Kaloshi, Hysen Bushi, Isuf Shquti, Beqir Loka, Abaz Shquti, Ramadan Doka, Haziz Loka, Hasan Shquti të vrarë në Skërtec, Abaz Isuf Loka, Hysen Jonuz Bitri, Met Osman Buci.

Dy fshatarët po i afroheshin vahut të lumit, kur patrulla serbe e kuptoi hilenë. Ato filluan të qëllojnë mbi dy fshatarët ku njëri prej tyre i plagosur në krahë, me vështirësi po kalonin lumin. Fshatarët, sapo dolën në anën e përtejme, u poziciunuan dhe filluan të qëllojnë në drejtim të patrullës. Gjatë kësaj kohe edhe ushtarët tjerë serbë, që ndodheshin tek posta në Kodër të Mullirit, filluan të qëllojnë. Në këtë mënyrë u krijua një situatë me shumë të shtëna dhe pas pak filluan edhe pushkët në Arras, në Topuze e më vonë, përgjatë gjithë rrjedhës së Drinit.

Është shumë e lehtë të dallohet se si gjithë patriotët në Arras, në Muhurr, në Dardhë e kudo, shkëmbimin e gjatë të zjarrit me patrullën serbe, e kujtojnë si fillimin e kryengritjes. Kështu pra shpërtheu kryengritja e shtatorit 1913, momentin e fillimit të së cilës H.Stërmilli, e shpjegon me vrasjen e tregtarit shëtitës nga Xheladin Xhediku. Ne mendojmë se është koinçidencë, që të vritet tregtari i Dardhës në të njëjtën ditë me "betejën" e zhvilluar në mes Han Totës e Halim Markut, me patrullën serbe. Mund të shtojmë se 1-2 pushkë që vranë tregtarin, të qëlluara nga Mërxhala, nuk mund të dëgjohen në Arras, Sinë e Gur të Zi, ndërsa pushkët e bëra në Fushë-Alie, beteja gjysmë ore e përshkruar më sipër, i kanë ngritur zemrat e dibranëve në kryengritjen e madhe të shtatorit 1913.

Nuk shkoi shumë kohë pas incidentit (përplasjes me armë në mes dy fshtarëve të sipërpërmendur dhe patrullës serbe) dhe çidhnakët, e më pas edhe krahinat fqinje, me pushkë e vikamë, "a besë-a besë" u sulën mbi serbin që nga Rrasa e Bollës, në Ostush e Mollë të Hoxhe. Luftime shumë të ashpra u zhvilluan në Ostush e në Gjarajcë, etj ku serbët kishin vendosur topa të kalibrave të ndryshëm. Përsëri në krye të çidhnakëve do të ishin heronjtë e dalluar në sa e sa luftëra të tjera për liri, si Selman Alia, Halil Kaloshi, Llan kaloshi, Haxhi Noka etj, etj. Çidhnakët, si dhe shumë herë tjera, me krahët përvjelë, shumëkush ndonëse edhe pa pushkë, por me thirrje të fuqishme, i detyruan serbët të lëshojnë pozicionet, duke lënë në fushën e luftës shumë të vrarë e armatime. Ushtria serbe u tërhoq e shpartalluar dhe në panik të plotë drejt Peshkopisë, e cila u çlirua plotësisht në mëngjesin e 8 shtatorit.

Ja se si shprehej Naçallniku i Shkupit, Cirkoviç, për këtë betejë: (*Këto forca* - H.P.) *"... një pjesë i udhëhiqte Alil Kaloshi prej Dibrës së Poshtme"* . Po në këtë dokument, më poshtë thuhet: *"… Atë ditë kryengritësit shqiptarë të drejtuar nga Elez Isufi dhe prijësat tjerë popullor Sefedin Pustina, Selman Alia, Haxhi Llan Kaloshi, Isuf Xhelili, Mersim Dema, Iljaz Hoxha, Haziz Lila… etj, organizuan sulmin e mëtejshëm të ndarë në disa kolona, si në drejtim të Strugës e Ohrit, të Mavrovës e Gostivarit. … forcat serbe u tërhoqën me shpejtësi, duke lënë 1000 ushtarë të vrarë, 300 ushtarë u zunë rob, si dhe u kapën 12 topa e materiale tjera ushtarake"*.

Ndërsa Sefi Vllamasi, për këtë betejë, në "Ballafaqime Politike" shkruan: "*Kur forcat (shqiptare - H:P) ndodheshin te Vorret e Pilafe, nën breshërinë e plumbave të mitralozit, malësori i quajtur Mehmet Skepi, një burrë me mustaqe kapadaji, u bën thirrje shokëve se:* ***'ai që vdes sot, asht i pavdekshëm' dhe thërret që ta kapin armikun të gjallë"*** Kjo fitore e shkëlqyer e dibranëve bëri bujë të madhe në të gjitha qarqet politike e mediatike na Ballkan.

Gazeta "Taraboshi" e datës 26 shtator 1913, shkruante: *"Fitesat e dibranëve janë të vërtetueme prej Belgradit. Shqyptarët kjen fitusa n'shumë luftime, e para se me mrrit n'Dibër murën Piskopien e serbët patnë shumë t'dekun e t'varruem e t'bierrne (humbur - H.P) dhe katër oficera"*

JEHONA E KRYENGRITJES SË SHTATORIT

Kjo luftë, e cila solli fitore të bukur Dibrës, nuk kishte se si të kalonte pa dëshmorët e martirët e saj, të cilët u rreshtuan në altarin e heronjve të tjerë të luftërave të mëparshme. Burra të tillë si Haziz Lusha, Hajdar Noka(Vllanicë), Murat Skepi(Vllanicë), Can Han Xhari (Vllanicë), Llan Pali (Vllanicë), Muharrem Bitri(Vllanicë), Jashar Allaman Maleçka, Lokë Nuz Loka, Maliq Loka, Xhafer Loka, Ali Koltraka Kurt Sali Cuni, i vrarë tek Ura e Lushës; Sali Buci në Rrenx te Ara e Xhokës; Hysen Man Tusha, i vrarë tek lapidari i Suhodollit Halit Kuta, Ferë Nezha, i vrarë në Grykë të Gramës, Dalip Hasi e Taf Hasi u vranë në Vllanicë, Ibrahim Paci në Peshkopi, Rushit Pashnjari, Xhetan Kaloshi, Maliq Loka, Xhafer Sulë Kaloshi, Hysen Bushi, Isuf Shquti, Beqir Loka, Abaz Shquti, Ramadan Doka, Haziz Loka, Hasan Shquti të vrarë në Skërtec, Abaz Isuf Loka, Hysen Jonuz Bitri, Met Osman Buci.

Ndërsa tek Ura e Lushës, në një nga "shëtitjet" e forcave serbe, kapet Ajshe Ramadan Bodi (Skepi), nëna e Fil Skepit, me një torbë me drithë në krah, që e kish marrë te shtëpia e ua çonte fëmijëve që ndodheshin në anën e djathtë të Drinit. Forcat serbe, që ndodheshin tek Ura e Lushës, e kapin dhe me bajoneta fillimisht i çajnë thesin e drithit, pastaj fillojna ta godisin edhe atë vetë, e cila dha shpirt e mbuluar me gjak. Me gjakun e tyre nderuan veten dhe krahinën tonë.

Kryengritja e shtatorit 1913 i tronditi shumë rëndë themelet e ngrehinës pushtuese sllave. Qeveria serbe e shqetësuar nga ky hov luftarak, filloi të organizohet për të përballuar furinë luftarake të dibranëve. Serbët më 22 shtator 1913 largohen nga Dibra, të mundur e të shpartalluar, inatçorë e kryeneçë. Për këtë, qeveria serbe u detyrua të mobilizojë një pjesë të mirë të ushtrisë për të kundërsulmuar. Ja si shprehej gazeta "Taraboshi" e 28 shtatorit 1913: *"Qeveria e Belgradit, me një ukazë (urdhër - H.P.) tjetër ka thirrë nën armë oficerat e të dytit rend (rezervistë - H.P.), për me i bà ballë ushtrisë vullnetare të Shqipërisë"*. Pra, siç shihet, shovinistët serbë shumë shpejt, mblodhën mbi 60.000 forca ushtarake dhe në fillim të tetorit 1913 u derdhën si zëgjeri ujqërish, me thika e ura zjarri në duar, duke djegur gjithshka u doli përpara, duke therë gra, fëmijë e pleq, që gjetën në shtëpitë e boshatisura dibrane.

Masakrat që ato kryen i kalonin kufijtë e çdo mizorie. Aq të pashembëllta ishin këto masakra, sa një ushtarak serb, i rrënqethur nga skenat mizore që kish parë të bëheshin ndaj shqiptarëve, shkruante në një nga gazetat e kohës: "*Nuk kam kohë të shkruaj gjatë, por mund të them se këtu po bëhen gjëra të tmerrshme… mund të them se Luma nuk egziston më. Nuk ka veçse kufoma, pluhur e hi"*. Po e njëjta gazetë shkruan edhe kujtimet e një oficeri serb, i cili shprehet: "*… Ndërmorëm një sulm duke mos kursyer asnjë dhe asgjë, robërit menjëherë i vramë, bagëtitë i morëm, fshatrat i dogjëm me radhë dhe në shumë vende nuk kursyem as gratë e as fëmijët"*.

"Trimëritë" e serbëve me fëmijët e pleqtë ishin unikale. Malësorët dibranë u gjetën të paorganizuar dhe nuk mundën ta përballojnë furinë e serbve. Në të gjitha pikat strategjike të kufirit, forcat shqiptare kishin vënë njerëz, të cilët ruanin me radhë e heroizëm kufirin. Forcat serbe, të riorganizuara e të shumëfishuara, iu vërsulën gjithë vijës së kufirit. Në Malin e Skërtecit ruanin vullnetarët e komanduar nga Murat Kaloshi, të cilët bënë një rezistencë të madhe kundër armikut për të penguar përparimin e tij, derisa të tërhiqeshin banorët nga fshatrat. Ndërsa, në Lake t'Xhipve në rojë me forcat e veta, ishte Zenel Noka. Në këtë betejë u vranë *"…Xhetan Kaloshi dhe Xheladin Shehu."*Forcat çidhnake "*Duke u zbrapsur tërhoqën me vete dhe fëmijët e gratë për të kaluar sa më shpejt më atë anë të Drinit. Armiku gjente kudo pengesa prej praparojave të fuqive tona."*

Martirët e kësaj kundërmësymje ishin njerëz të pambrojtur: fëmijë, gra, pleq, të pamundur etj. Megjithë terrorin e egër e masakrat çnjerzore që përdori pushtuesi, çidhnakët nuk pushuan për asnjë çast luftën për liri. Edhe pse u derdh shumë gjak, frytet e kryengritjes nuk u ruajtën për shumë arsye, por kjo nuk do të thotë që ajo të quhet spontane. Vërtet fillimi i saj qe spontan, por nuk mund të thuhet ashtu, për mënyrën e zhvillimit të vetë kryengritjes, e cila ishte një luftë popullore e organizuar shumë mirë, duke ngritur më lart patriotizmin e dibranëve, dashurinë për atdheun dhe ndjenjën e sakrificës për mbrojtjen e lirisë.

Ky heroizëm masiv popullor, që treguan të parët tanë në këtë luftë, do të frymëzonte brezat e mëpastajmë për beteja të tjera në mbrojtje të atdheut. Ja si do të shkruante poeti popullor: *"Krali serbit à hutue, / Ushtri t'madhe ka hazrue, / Nuk durohet kral Pashiçi, / Nuk durohet n'gji iriçi. / Prej Korabi e n'Radikë, / Vra me pushkë e therë me thikë, / N'gjeshkë t'Zojnave mu ke stani, / Ai Met Dedja musteçemadhi, / Ban huxhum ke istikami: / - Ta farojmë pa ardhë akshami! / Kral Pashiçi, ki rafazi, / Po djeg shpi e vret f'mijë, / Ka ba Çidhnën shkrum e hi, / Si n'dynja s'ka ba vaki. / Mu n'Arras mlidhen trimat,/ Ka dy pluma n'gojë martinat, / Sot pa burra t'i lam' shkinat,/ E jan' ujit me gjak celinat. / I ran' sejrpit n'Ostush. / Me dy s'ra kollanat mbush. / Se kjo Çidhna gjeg si prush. / E ka turrin si arushë."*

MET DEDJA DHE CIDHNAKËT NË QAFË TË KOLOSJANIT

Po rikthehemi edhe njëherë në ngjarjet e vitit 1912 e, pikërisht tek momenti, kur çidhnakët u nisën për të ndihmuar shkodranët. Siç u theksua edhe në kapitujt e mëparshëm, Kapedani i Mirditës nuk i lejoi këto forca vullnetare të kalonin sa më shkurt nëpër Mirditë. Kjo i detyroi vullnetarët dibranë të ecin në drejtim të Matit dhe, kur ata po kalonin atyre viseve, një letër i vjen Elez Isufit nga Sheh Zumani i Vleshës, i cili njoftonte se disa ushtri serbe i janë drejtuar Lumës e, ndoshta, hyjnë edhe në Dibër. Çeshtja ishte serioze, ndaj dhe u vendos që forcat derjane të udhëhequra nga heroi Elez Isufi, i mbështetur edhe nga një kompani çidhnakësh të udhëhequr nga Met Dedja, të ktheheshin në zonë. Kështu u vendos dhe kështu u bë.

Rreth 60 çidhnakë u kthyen në fshatra e tyre dhe ishin në gatishmëri të plotë për të rrokur armët në luftë. Nuk vonoi shumë dhe në ditët e para të nëntorit 1912, forcat serbe po përparonin vazhdimisht drejt Lumës. Elez Isufi i dërgoi fjalë Met Dedes, duke i kërkuar sa më shpejt të shkonin në Kolosjan, për t'i dalë përpara hasmit. Ky veprim ishte plotësisht i justifikuar nga pikëpamja taktike, ndaj dhe angazhimi luftarak i malësorëve ishte në lartësinë e nevojshme.

Elez Isufi kish dërguar në Qafë të Kolosjanit mbi 400 forca të shoqëruara edhe me dy topa të vegjël dhe, me 19 nëntor 1912, aty u shkrua një faqe e ndritur e historisë së luftrave kundër serbit. Gjëmimi i topave dhe thirrjet "besa-besë", gjallëruan si asnjëherë tjetër zemrat e luftëtarve dibranë dhe realizuan fitoren e bukur mbi hasmin e egër serb, të cilit i mbetën në fushën e betejës një regjiment ushtarësh të vrarë. Flamuri i fitores me shqiponjën dykrenare u valëvit në fushën e betejës, në ditën që u shpallë Pavarësia në Vlorë. *"… E Isufi, luftoi burrnisht e trimërisht në Qafë të Kolosjanit të Lumës kundër serbve, të cilëve u dha shumë të vdekun, … më 27 Nanduer 1912,…"*. Në këtë formacion luftarak, ishin të rreshtuar edhe çidhnakët, të udhëhequr nga Met Dedja, të cilët luftuan heroikisht krah për krah me derjanë e reçjanë. Një këngë e asaj kohe thoshte*: "Kush ban mledhje ke istikami? / Ai Met Dedja musteçemadhi. / Ki Met Dedja mustaqekuq, / Bini burra n'qofshi turq! / Tym e flakë bajmë duman, / Si n'Bërdicë e n'Kolosjan."*.

Në këto luftime të përgjakshme, pranë Halil Selmanit të larë në gjak, pushuan përgjithmonë edhe çidhnakët Beqir Dan Bushi, Dan Beshir Sala, Osman Liman Kariçi dhe Rushit Miftar Përseku ndërsa u dalluan edhe luftëtarët çidhnakë, si Destan Tota, Feri Dauti, Halim Xhika, Sahit Xhika, Bajram Xhika, Selam Daci, Selman Xhika, Avdi Xhika, Elez Shehu, Sali Shehu etj, etj.

EPISODE TË HEROIZMIT TË CIDHNAKËVE NË SHKODËR

Edit Durham shkruante: *"Shkodra u dorëzua. Atje vdisnin 30-40 veta në ditë nga uria."*, ndërsa e shoqja e Kryekonsullit të Përgjthshëm të Austrisë në Shkodër, më dt 21.4.1913 shkruante: *"…se prej tre ditësh, po rebelohen ushtarët…. Ata nuk duan mish kali, por duan bukë"* dhe më poshtë vë në dukje se, *"trimnia heroike e oficerave, nuk e përballon dot faktin elementar e forcën madhore: mungesën e bukës."*

Kësaj situate të rëndë në llogoret e luftës, po t'i shtosh edhe njoftimin që ata morën se në Dibër kishte zbritur serbi, i bëri dibranët më të vendosur dhe më trima. Më 9 shkurt 1913, në Bërdicë u zhvillua beteja më e përgjakshme me forcat malazeze. Momente të tilla heroike janë përjetuar në qindra këngë, që qarkullojnë ende në popull. Ja si thuhet në njërën prej tyre: *"…Kur i vikati Muda (Basha) Zenelit (Basha),/ Shab Lusha hapi telin…"*. Trimi Shaban Lusha del nga istikami dhe, pasi shkatërron gardhin serb të telit me gjemba, si shqiponjë hidhet mbi pozicionet e armikut, duke u përleshur fyt për fyt me malazezët. Një breshëri plumbash qerthullon trupin stërmadh të trimit, i cili rrëzohet në tokë, duke mos ia lëshuar thonjtë nga gryka malazezit, që e kish vënë përposhtë.

Tjetër episod heroik është edhe ai i dy vëllezërve nga fisi i Kukele në Mustafe: Të dy vëllezërit ishin në një distancë prej 30-40 metrash, në mes kishin edhe plot trima tjerë. Lufta qe mjaft e ashpër dhe një plumb merr në gjoks njërin vëlla, Destanin. Gojë më gojë mbërrin lajmi i vrasjes së Destanit tek vëllai tjetër, Imeri, i cili sapo kish mbushur të njëzetat. Në zemrën e re e djaloshare të Imerit, shpërthen lëmshi i dhimbjes për vëllain e vrarë dhe menjëherë del nga istikami me pushkë në dorë, duke ecur e duke qëlluar drejt armikut. Kështu vazhdoi të ecte përmes plumbave Imeri, ndërsa shumë luftëtarë i bërtisnin që të kthehej në istikam. Imeri nuk dëgjonte se dhimbja për vëllain e humbur ia kish errësuar vetëdijen dhe vazhdonte të qëllonte, kur një breshëri plumbash i përshkojnë trupin e njomë. Kur ra nata dhe u errësua, shokët e tërhoqën trupin e pajetë të Imerit dhe e varrosën në një vend me vëllain e tij, Destanin.

Kjo dhimbje e madhe, ku dy vëllezër bien dëshmorë, u përjetua në këngë që këndohej aso kohe në Çidhën:*"…Si rrallë herë kish ba vaki, / Dy xhigërli me ni shpi…"* Kështu të dy vëllezërit mbetën atje, por kujtimi dhe akti i tyre heroik shpejt mbërriti në odat çidhnake dhe përmendet e kujtohet me respekt edhe sot pas 100 vjetësh.

Le të kujtojmë edhe një episod tjetër, i cili shumë kohë është përmendur e kujtuar në odat tona. Në mes të muhurrakëve pjesëmarrës në këtë luftë, nga Shorokani ishte edhe një burrë në gjysmë të moshës. Fjalët e urta të tij ngrohnin zemrat e shokëve në llogoret e Bërdicës. Ky ishte Ismail Dede Ballazhi. Për shkak të intensitetit të lartë të predhave që binin, askush nuk e kish vënë re, kur plumbi e kish goditur për vdekje muhurrakun, i cili për çudinë e të gjithëve vazhdonte të qëndronte në këmbë. Pas disa orësh, lufta reshti dhe muhurrakët iu afruan trimit, i cili edhe pse i vdekur, qëndronte në këmbë, mbështetur shpinën në llogore, këmbët paksa të larguara, koka e anuar, sytë çelë e pushkën nuk e lëshonte nga dora...

Muskujt e duarve të Dede Ballazhit, kishin ngrirë dhe pushka nuk i shqitej nga dora. Ata nuk e prekën fare kufomën që qëndronte më këmbë dhe, ndërkohë, thirrën nipin e tij, Mehdi Spata, i cili ishte pak më tutje në llogore me çidhnakët. Mediu kish mësuar në Turqi dhe ishte besimtar i fesë islame, si dhe ushtrues i saj. Ai mori abdes me pluhurin e dheut të llogores dhe, duke këndduar ajete (pjesë) të Kuranit, ia nxori pushkën nga dora Ismail Dede Ballazhit. I mbylli sytë dhe e uli ngadalë në tokë. Ai kish mbetë shehit, për tu kujtuar në shekuj, thuhej në popull.

Beteja përfundoi me fitoren e dibranëve, por fusha e luftës ishte mbushur plot me kufoma të armikut. Pas armëpushimit, në muajin maj 1913, të gjithë luftëtarët dibranë po ktheheshin në Dibër. Nga radhët e tyre mungonin 114 prej tyre, të cilët ranë dëshmorë. Selman Alia, i plagosur rëndë, mezi qëndronte në një kalë, të cilin ua kishte falë një nga Bërdica. Ai kishte udhëhequr çidhnakët në sa e sa luftra, kish marrë pjesë në sa e sa beteja, por kurrë si sot nuk i ishin veshur sytë me lot.

Ende në vesh i buçiste zëri kumbues i Shaban Lushës, ndërsa trupi i tij prehej në Bërdicë e në krah të tij ishin varrosur edhe Hakik Ismail Raska, Han Abaz Bitri, Ramadan Miftar Përseku, Shaban Hakik Tola, Taf Lam Pashnjari, Tahir Çup Leshi, Xhetan Fali Kola, Rushit Bajram Përnezha, Destan e Imer Kukeli, Met Osman Buci, Beqir Selman Përnezha, Bajram Martini, Hysen Tahir Çuni, Sulë Nuz Çuni, Bajram Bajram Lusha e shumë të tjerë. *"Vetëm në Kushaj te Hani i Hotit, ndodhen 30 varre dhe vendi thirret Varret e Dibranëve."*

Rruga e Arbërit nr. 170

kujtime

Jeta e Gani Metës ishte një dramë e fortë dhe e ngjeshur e jetës njerëzore, tipike e shqiptarit të kohës së tij, por edhe shembull i urtisë së mendimit që ai manifestonte në odat dibrane.

Kujtime për Gani Metën

Nga **BAJRAM XHAFA**

Sokol Shtrezi m'u vu fort t'i shkruaj ca kujtime për gjyshin e tij nga nana, Ganiun, babën e Lutes. Ke ndejtë shumë me Ganiun dhe keni pas biseda të shumta, më tha. Ai vazhdimisht të kishte në gojë dhe përmendte bisedat që banit me njeni tjetrin. Me njohjen që ke, ma mirë se ti, besoj, askush nuk mund të shkruajë për Ganiun. – Eshtë e vërtetë, i thashë, por gjana të shkruajtura kam pak. Atëherë ishte e vështirë të mbaje shënime të çfarëdollojshme pa rrezikuar, se do të ndodhej ndokush që ta përcillte informacionin tek ai "vendi".

Edhe mbajtja e një ditari personal atë botë ishte me rrezik. Një kangëtare e talentuar dhe e hirëshme dibrane, Alida Hisku, nga sheherlinjt e Tiranës, qe shumë e suksesshme në fillim të të 70-ve. Kur çarku i ngritur e hodhi në hekurat e sigurimit, nga hetimet doli se ajo kishte mbajtur edhe një ditar ku na paskesh shënuar të "fshehtat" e saj ndaj partisë dhe pushtetit. Kjo veprimtari iu quajt "konspiracion". Ditari shërbeu si provë fajësie e deliktit të saj. Ky shembull ishte kumonë me ndí për ata që kishin veshë dhe pesë pare mend në kokë. Aq ma tepër për mua që e kisha kalue një "grip ideologjik" të fortë dhe isha në përgjim. Një fjalë e urtë thotë: është më mirë me nxanë në shpinë të tjerëve se në kurrizin tand. Me këto gjëra nuk bëhej shaká. Terror psikologjik.

***

Me Kanun të Maleve, në Dibër nipi nuk e ka detyrim të "qesë pushkë" për dajën, por Sokoli e ka "vaktin" dhe vullnetin e mirë, dhe, pa ba ndonjë sakrificë të madhe mund të bajë nji gjest nderimi dinjitoz për Babëgjyshin e vet. Për ma tepër, edhe për t'ia ba qejfin nanës vet, e cila, me të drejtë e çmon babën e vet, si babë e si person që ishte dikushi dhe që meritonte diç ma shumë se të tjerët. Ai nuk mund të largohej nga kjo dynjá pa lanë një kujtim të shkruar. "Verba volant, scripta manent" (fjalët fluturojnë, i merr era, të shkruarat mbeten, thoshin latinët).

Kujtimi i tij ishte pengu i së bijës, por edhe pengu ynë moral. Ai nuk duhej të largohej si shumë të tjerë, pa lanë tek të gjallët një kujtim jete e një përvojë urtie. Kjo edhe si mesazh për shoqërinë, si nevojë e transmetimit të përvojës nga brezi në brez e si rregull cilivizimi.

Jeta e Gani Metës ishte një dramë e fortë dhe e ngjeshur e jetës njerëzore, tipike e shqiptarit të kohës së tij, por edhe shembull i urtisë së mendimit që ai manifestonte në odat dibrane. Kjo pasuri nuk duhet lënë që ta fshijë koha. Dinamizmi i sotëm i ndryshimeve të jetës shoqërore asht galopant. Trysnia e globalizmit për rrafshimin e kulturave rrezikon identitetet nacionale, pjesë e së cilës është edhe mendësia popullore, konstitucioni shpirtëror. Zhvillimi i vrullshëm i mjeteve të komunikimit, mediat, lëvizjet e njërëzve nxjerrin nevojën e ruajtjes e të konservimit së traditës, të identiteteve nacionale e të veçorive të tyre. Jeta e Ganiut është një mesazh edhe në këtë drejtim.

Pa marrë zotime, Sokolit i premtova të shtrydh kujtesën time dhe, besoj se diçka mund të bëj, ashtu siç di dhe sa mundem, për të gjitha motivet fisnike të Sokolit, të Lutes, por edhe për veten time, për bashkëfshatarin e bashkëfshatarët e mi, për fshatin tim të lindjes, për tokën ku për herë të parë më ka pa dielli, për Tre Gjurrat që e shpërthejnë furishëm ujin jetëdhanës qelibar nga burimet e shumtë, ndoshta si në asnjë vend tjetër në këtë rruzull toke e mbi këtë faqe dheu. Shtysa shpesh bëhet sebep për të bërë gjëra të dobishme. Le të shpresojmë.

***

Me mixhën Gani kisha diferencë të madhe moshe; ai i vitlindjes tek 1900-a e unë 1945-a, pra, gati gjysëm shekulli. Kjo sillte vështirësi. Këtyre u shtohen ato që lidhen me kontekstin social-politik të kohës. Jetën e tij e kam shoqëruar qysh se "kam ra në mendt e mia" deri në janar 1976 kur ai u nda nga kjo botë. Vërtetë unë jam larguar herët nga fshati, qysh në fillimet e shkollës 7-vjeçare, me 10 vjet si konviktor bursist në Peshkopi, përfshirë edhe të Mesmen e Universitetin në Tiranë, dhe, së fundi emërimin me punë në Shkodër ku vazhdoj të jetoj edhe sot e gjithë ditën. Mbi 50 vjetë.

Duke pasur prindërit në fshatin e lindjes, të cilët, të "ngjitur me tokën", kurrësesi nuk donin ta "lëshonin vendin", unë asnjëherë nuk i shkëputa lidhjet me fshatin, me jetën e tij, me banorët e tij, me punët dhe hallet e tij. U ngjita dhe unë përjetësisht me të. Është fundamentale. Madje, këtë gjë vazhdoj ta bëj edhe tani pas 15-20 vjetësh kur edhe prindërit e mi janë ndarë nga kjo botë. Dhe, besoj se do ta bëj edhe më tej, deri kur nuk do të mundem më. Jam nostalgjik i pakorrigjueshëm.

Sa herë shkoja në fshat, me mixhen Gani lehtësisht na takonte rastësia. Nuk kishim ku ta çonim njëri tjetrin, ishim kojshí. Mbase, i pari që do ta merrte vesh ardhjen time në fshat, pas fëmijëve të mëhallës, ishte ai. Ishte nevoja për komunikim, për diskutime, për shkëmbime mendimesh, kryesisht për historinë, "fusha" jonë e përbashkët, por edhe për plot gjëra të tjera.

Thashë më lartë se ishim mëhallali, në Mëhallën e Epër të katundit Kovashicë (të Malësisë, të Grykës së Vogël, mbasi në Dibër ka edhe një Kovashicë tjetër, në Fushë, në zonën e Maqellarës). Shtëpitë tona i ndante në mes një përrua që zente fill në faqen lindore të kodër Kishës (Kajshës), me zabelet e veshura me dushk dhe që zbriste poshtë deri tek Lenishtet, arat nën ujë që ujiteshin nga ujrat e Gjurrës s'Tòme. Shtëpia e hasmete ishte përtej përroit, në drejtimin v-p të mëhallës, naltë, në krye të mëhellës e të katundit dhe në fundin e kurrizit të një kreshte të rrafshët që zbret nga rrëza e kodër Kishës. Ajo është vendosur lart, si bisht i një tarrace natyrore prej nga mëhallët e fshatit me shtëpitë e tyre, shumica të grupuara në blloqe lagjesh të veçanta e disa të veçuara, me rrugët që ndërthuren e kryqëzohen në të, nga mund të kundrohen si nga llozha e një teatri.

Kodër "Kisha" ("Kajsha", në aksentin vendas), fillimisht ngrihet në formë kurbe duke e rritur me shpejtësi pjerrtësinë në anën perëndimore të mëhallës si faqja e një piramide, maja e së cilës i rrin përsipër asaj dhe të krejt fshatit si një karakoll (postroje) vigjilente dhe hijerëndë. Nga maja e saj ku janë rrënojat e venitura të një kishe të hershme mesjetare, e cila i ka dhënë edhe emrin kodrës "Kisha", sheh e ruan gjithë luginën e Dibrës që shkon nga jugu në veri përgjatë luginës së Drinit të Zi. Kur kthen hija e mbasdites, shtëpia e parë e fshatit mbi të cilën ajo bie, është e Gani Metës; ashtu siç, kur dielli lind, të parën shtëpi që dielli praron me rrezet e tij është sh(të)pija e hasmete.

Kur dalin ne mëngjes, pasi kalojnë nga lindja kreshtën e vargut malor Korab-Deshat-Velivar, rrezet e para të Diellit prekin së pari majën e kodër Kishës dhe "*Gjurin e Zi*", një masë e madhe metamorfike shkambi në ngjyrë të zezë e dalë nga toka si një kuçedër, mu në ballin e "Kishës" midis gjelbërimit të dushqeve bungë buta, siç i quante botanisti i famshëm Ilia Mitrushi. Nga larg ai dukej si i veshur me mistér. Në fëmijërinë time "Gjuri i Zi" i Kishës më dukej si cungu i frikshëm i bririt të thyer nga lëvizjet inatçore të kokës të një përbindëshi mitologjik. Herë të tjera më ngjante si vendstrehimi i qenieve që të shitojnë (ngrijnë, paralizojnë). Kushedi se ç'qenie shituese duhet të strehoheshin në zgavrat e zeza të kësaj "qenie" të mistershme. Vetëm pasi lindte dielli, drita që vinte nga rrezet e tij më dukej se e largonin misterin dhe vendi ngrohej.

Vala e rrezeve të diellit ulet pastaj teposhtë në formën e një vije horizontale dritë-hije tek Brinja e Keqe (zabelet e Toçe), pastaj tek *Rrafsha e Melicës* ku janë zabelet e hasmete, një rrafshinë e bukur shlodhëse, tamam si një ballkon natyror ku puna të kthehet në prehje; një hapësirë mbi një a më shumë hektarë që nxin nga fidanë të drejtë lisi të harlisur bunge si një park. Ulet pastaj më poshtë "pëlhura" e dritës tek Kroji i Epër me ujin e tij të bekuar, për të zbritur tek Ara në Hurdhë, kalon Rrucekën, Hurdhën e mëhallës së Epër dhe së fundi, të parën çati shtëpie që dielli lan me dritën e tij është ajo e hasmete.

Aty jetonte mixha Gani me familjen e tij të "madhe". Në atë truall e në ato troje ishin rropatur e kishin shkuar jetën paraardhësit e tij, të cilët, ashtu si pothuajse të gjithë fiset e tjera të fshatit, ishin të ardhur, nuk dihet sa kohë ma parë, dy apo tre shekuj. Natyrisht që këto ishin migracione të brendshme të popullsisë shqiptare. Ganiu jetonte aty bashkë me Rremi-n, (kështu e shkurtojmë në anët tona emrim Muharrem; nuk themi Rrema), i cili duhej të ishte ndonja 20 vjet ma i ri se ai.

Deri nga viti 1955-56 kur në fshat u ngrit sëpari kooperativa bujqësore, kanë jetuar në një familje të përbashkët dykunoréshe: Ganiu me Alimanen e Bllacës dhe dy vajzat, Mijen dhe Luten; Rremi me Miten e Mere dhe fëmijët e tyre: Luanin, Shahinin, e më pas, Njaziun, Flamurin, Hasijen etj., një katrrosh. Endé ishte gjallë edhe gjyshja, nana e Rremit, Delishja e Lukanit.

Luani i Rremit, si djali i parë i sh(të)pisë, ishte personi ma me kimét në atë familje të "madhe". Edhe pse shpejt u bë me vllazën të tjerë, të cilët, për marshallah erdhën njënni mbas tjetrit, në fëmininë time nuk kuptoja se pse me aq ngut atij i zunë edhe një byrazer, nji vëlla gishti, në Boçevë, me ç'rast u ba "bukë e madhe". Pak për qejf e për lezet e ndoshta pak për dúkë. Deshën ta promovonin herët emrin dhe "reputacionin" e Luanit, pa pritur që ai vetë ta ngrinte atë. Mendonin që ai të rritej me rreth të gjërë e me "taraf" të vetin. Kohë e zakone. Deri nga vitet '50 të shek. XX vinte e gjallë tradita me ngarkesë mistike e vëllamërisë, një imitim i vëllazërisë së gjakut. Mbase vinte edhe si nevojë e shqiptarit për solidaritet e "aleanca" kur shihej qartë se mbi njëqind e sa vjet raca shqiptare sa vinte e tkurrej. Instink mbijetese.

Zakoni i vëllamërisë në fakt ka qenë i përhapur shumë edhe tek sllavët, tek "zadrugat serbe të Shumadisë. Madje, shumë i zhvilluar ka qenë ai edhe midis sllavëve dhe shqiptarëve në zonat e kontaktit. Shpesh ka histori mbresëlënese kur në një situatë rreziku befas del probatini (byrazeri) si shpëtimtar i situatës dhe i jetës së vëllaut të tij shpirtëror të imituar. Në zonën e Malësisë së Mbishkodrës është shumë i përhapur edhe sot apelacioni, më shumë në trajtë humori, "he probe", "ç'kemi probe", "kah po shkon or probe", shkurtim përkëdhelës i probatinit. Në Ditarin e Xhino Berrit për "Rrethimin e Shkodrës" 1912-1913, në veprat e Durhamit e të studiuesve e udhëpërshkruesve të tjerë perëndimorë për Shqipërinë ka përshkrime me tone epike të ngjarjeve për aktet që sillen rreth zakonit të vëllamërisë tek shqiptarët.

Aty nga mesi i të '50 –ve, kur djali i mixhës tim u lirua nga ushtria, të cilën e kishte kryer në Berat, e pyeti Ganiu. A u lirove prej ushtrie or Fiqiri? Po, i tha ai. Atje në ushtri a zune ndonjë mik a byrazer, që ta keshë edhe ma vonë si vëlla? Po, i tha Fiqiriu, zuna nji byrazer. Ai asht Tufik Kaja prej Zogje. L'shoj dushke, tha Ganiu. Zogjen këtu e kemi e nuk na ikën. Unë mendova se ke zanë ndonjë byrazer të largët, andej nga jugu, nga Tosknia, Berati, Vlona a tjetërkund e ti më thue Tufik Kajën prej Zogje. Me të dalë ndonji nevojë në jetë kujt do t'i kërkosh ndihmë? Ata të jugut po, se janë ma të zott në punë qeverie dhe mund, edhe të ta venë dorën.

Pas kësaj, Ganiu kishte gati një tjetër "histori" me qëllime didakte. Dy persona në fëmijëri kishin qenë shokë shumë të ngushtë. Fati i kishte ndarë dhe njeni ishte ba njeri i madh, kryeministër, kurse tjetri kishte mbetur bujk, aty në fshatin e vet. Pas shumë vitesh lumturisht fati i takoi dhe kjo u solli gëzim të dy palëve. Pasi u pyetën, qanë edhe hallet. Katundari ç'të qante më parë. Mal me halle. Kam mundësi të të ndihmoj, i tha miku i vjetër prandaj del nëpër qytet dhe shih ndonjë rast për ndonjë punë të përshtatshme për ty. I ra lartë e poshtë qyqari dhe diku pa një burrë që, me gishtat e duarve po i binte shufrave të një vegle e cila lëshonte tinguj të çuditshëm. Kjo qenka punë fare e lehtë dhe mund ta baj edhe unë. Njerëzit grumbulloheshin për ta dëgjuar plot dëshirë. Nuk ishte si kazma dhe sopata e tij të cilat t'i çonin djersët çurkë.

E gjeta një punë shumë të mirë, tha hallexhiu, punë të cilën mund ta baj fare lehtë. Si ishte ajo punë e pyeti miku i fëmijërisë. Me gishtat e duarve i binte pa prâ një vegle që e mbante përpara dhe ajo lëshonte tinguj muzikorë. Njerëzit argëtoheshin dhe ndigjonin me qejf të madh. Ajo punë që ke parë ti, i tha miku i vjetër, kërkon të bajsh shkollë të madhe. Një e rame me gisht të asaj veglës (ishte fjala për pianon), duhet te kryeje plot një vit shkollë. Atëherë lene këtë punë, se nuk qenka për mua, tha mundqari. Mua më rroftë kazma, lopata dhe sëpata. Ky asht risku (fati) yt, i tha vetes dhe u kthye në fshatin e në fatin e vet.

Jetoi Delishja (gjyshja e dashur e Luanit) deri nga mesi i të '70 kur erdhën "dritat e partisë" për të lënë atë batutën që tregohej si burim humori. Ndërsa radioja transmetonte një kangë nga ato të kohës, befas gjyshja u përmend se po jepej kanga e preferuar e Luanit, prandaj kërkoi ta mbyllnin radion që t'ia "ruanin" kur të vinte në shpi nipi të saj të dashur kangën e preferuar.

Shtëpia e tyre ishte një konak i gjatë dykatësh me pamjen ballore nga lindja e diellit. Në pjesën qendrore kishte një çardak ku ngjitja bëhej me shkallë druni nga jashtë (teliz). Fundi i konakut përfundonte me dhomën e miqve, pjesa e vjetër e shtëpisë. Ajo nuk kishte lidhje me çardakun, kishte hyrje më vete e shkallë të brendshme me basamak tip sënduk, dhomë të rregullueme mjaft mirë qysh herët, me tavan dhe dysheme dërrase. Aty priteshin miqtë e afërt e të largët. Atë dhomë mixha Gani e bëri jatak edhe kur po largohej nga kjo dynja.

Oborri (kurti) shtrihej përpara shtëpisë, i sheshtë, me dhé të kuq e të ngjeshur, pa bar të gjelbëruar sipër, rrethuar nga një avlli e madhe në mes të të cilit ishte një pus (bunar) 13 pashë i thellë me ujë akull të ftohtë. Uji i tij ishte në damarin e Kroit të Epër në faqe të (kodër) Kishës, ujë që për nga cilësia konkurronte me ujin Zem Zem të Qabes së madhnueshme do të thosha unë një metaforë e frymëzuar nga fakti kur në vitin 2000 shkova në Qabe dhe u bana Haxhí. Por gratë dhe vajzat e hasmete (të fisit Meta), ashtu si të gjitha gratë e mëhallës së Epër, mbushnin ujë tek Gjurra e Tòme.

***

Kovashica (*Cobocheste*) e Grykës së Vogël

Prof. Kristo Frashëri në veprën "Skënderbeu – Jeta dhe Vepra", në kap. XIII "Kanunet e Skënderbeut", shpjegon si lindën bashkimet e maleve si bashkësi ndërkrahinore politike, ushtarake dhe zakonore. Përdorimi nga kronisti bizantin i shek. XIII G. Akropolitis i emrit të Dibrës në shumës, lë të kuptohet se treva e saj, për shkak të numrit të madh të fshatrave, ishte e ndarë, të paktën që në atë shekull, në dy pjesë – në Dibër të Sipërme dhe në Dibër të Poshtme[1]. Kjo nënkupton formimin me kohë në këtë trevë të dy bashkësive ndërkrahinore. Më vonë të dyja këto bashkësi hynë në pushtetin e dy familjeve feudale të njohura – Dibra e Sipërme që në fund të shek. XIII nën sundimin e Gropave[2] dhe Dibra e Poshtme dhe një pjesë e Dibrës së Sipërme, siç u pa, që në fund të shek. XIV nën pushtetin e Kastriotëve.

Në shënimet plotësuese që bën për familjen Pal Gropa (fudnota 15), me titullin sevast, del në vitin 1273 si feudatar i disa fshatrave të dhuruara atij nga Karli I Anzhu, në atë kohë "mbret" i Shqipërisë (*Rex Albaiae*). Në dokumentin latinisht (A Alb.I, 300) emrat e tyre janë shkruar kështu: fshatrat si Radicis maioris (Radica e Madhe, Gryka e Madhe), Radicis minori (Radica e Vogël, Gryka e Vogël), si dhe fshatrat Cobocheste (Kovashica), Zuadigoriza (Vadigirica, Vau i Gjoricës), Sirclani (Zerqani), Craye (Krajka), Sessiza (Zeshica?) që ndodhen në luginën e lumit Ebu (Bulqizë?), vende këto që, siç shihet, ndodhen në Dibrën e Sipërme. Pra, emri **Kovashica - Cobocheste** për herë të parë del qysh na del qysh në vitin 1273.

Tri Gjurrat e Kovashicës

Gjurra e Tòme buron në mes të fshatit. Buçakët (burimet) e saj dalin nga të çarat e shkëmbenjëve të shumtë përfund Sharrës së Zenele ose Sharra e Kovashicës. Ajo është një kodër që ngrihet "thikë" përpjetë, e përbërë nga formacione gëlqerore dhe e veshur me shkozë, dëllinja, frashër e ma pak me dushk, kodër aq e dashur për mua, që në fëmininë time e kam shkelur jo vetëm me kambë por edhe me të ndenjura. Aty ku del Gjurra, a pak më poshtë është sinori i mëhallës së Epër me mëhallën e Tome.

Pasi përshkonte ndonja 30-40 m me drejtim lindor duke kaluar sipër Verrinjve, një moçalishte e errët mbushur me verrinj të gjelbëruar, (më 2010 është kthyer në rezervat për rritjen e troftës), rrjedha e ujrave të kristaltë të gurrës bën një hark drejt veriut duke mbajtë krahun lindor Lenishtes dhe pas ndonja njëqind metrash, bën një këndë nga e majta dhe kapërcen një prag që e bën të lëshojë një shushurimë monotone ëndërrimndjellëse e cila përhapet në gjithë luginën duke krijuar ndjesi paqe e qetësie.

vijon në numrin tjeter

1 Kristo Frashëri, Skënderbeu – Jeta dhe Vepra, Toena, Tiranë, 2002, f. 224.

2 Pal Gropa, me titullin sevast del në nitin 1273 se feudatar i disa fshatrave të dhuruara atij nga Karli Anzhu, në atë kohë "mbret i Shqipërisë (Rex Albaniae). Në dokumentin latinisht (Aalb.I, 300) emrat e tyre janë shkruar kështu: fshatrat e Radicis maioris (Radica e Madhe, Gryka e Madhe), Radicis minori (Radica e Vogël, Gryka e Vogël), si dhe fshatrat Cobocheste (Kovashica), Zuadigoriza (Vadigirica, Vau i Gjoricës), Sirclani (Zerqani), Craye (Krajka), Sessiza (Zeshica?) që ndodhen në luginën e lumit Ebu (Bulqizë?), vende këto që, siç shihet, ndodhen në Dibrën e Sipërme. Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV Gropat me tritullin zhupan banonin në Ohër. Gj. Muzaka thotë se "Zoti Gropa ishte Zot i Ohrit ose i Dibrës" (Signor Groppa Signor d'Orida overo Debria) (G. Muzachiao, f. 282); Kristo Frashëri, "Skënderbeu Jeta dhe vepra", Toena, Tiranë, 2002, f. 223-224.

histori

Bëmat e Sheh Hajredin Zerqanit ishin dhe do mbeten një shembull i lartë patriotik për brezat, në mbrojtje të çeshtjes kombëtare.

Hajredin Shehu *i shehelerëve të Zerqanit, kleriku dhe atdhetari në gjurmët e të parëve*

Nga **HYSEN LIKDISHA**

NË VEND TË HYRJES

Ashtu si dhe në jetëshkrimet për Sheh Mustafën e Sheh Sulën e Zerqanit, edhe në realizimin e jetëshkrimit, për Sheh Hajredinin e Zerqanit, jam mbështetur në materiale të shumta dokumentare e historike, në kujtimet gojore të familjes, trashëguar ndër breza, si dhe dokumenteve e dëshmive të marra nga Muzeu i Dibrës, mbledhur e sistemuar me shumë kujdes nga Fadil Shehu, djali i Sheh Hajredinit të Zerqanit.

Hajredin Shehu (Sheh Hajredini i Zerqanit), pinjolli i brezit të tretë, të shehelerëve të Zerqanit,ushtroi veprimtarine e tij, klerikale dhe atdhetare, duke ecur pa u lëkundur në gjurmët e të parëve të tij, gjyshit Sheh Mustafa dhe xhaxhait Sheh Sula. Lindur e rritur në oborrin e një familje të madhe, siç ishte ajo e shehelerëve të Zerqanit, Hajredin Shehu, ruajti traditën e të parëve të kësaj familje, duke mbajtur të pacënuar emrin e saj, të mirë, në udheheqje të malit të Grykës së Madhe Zerqanit, duke bërë emër që në të gjallë të Sheh Sulës.

SHKOLLIMI DHE LARGIMI NGA STAMBOLLI.

Lindi më 1882. Vitet e para të fëmijërisë, i kaloi pranë teqesë së Zerqanit, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Sheh Sulës. . Nga prindërit e veçanërisht nga Sheh Sula u edukua dhe mësoi mbi bëmat e të parëve, për fe e atdhe.në luftë kundër pushtuesit osman. Mësimet e para i mori në mejtepin turk, hapur nga qeveria turke në Zerqan. Mbi veprimtarinë atdhetare të xhaxhait, Sheh Sulës, Hajredini ende pa mbushur 10 vjeç, mësonte duke dëgjuar në dhomën e selamllëkut të teqese, ku mblidheshin burrat e dheut. Pasi mbaroi mësimet e para në vendlindje, nën kujdesin e prindërve, u dërgua në Manastir, ku për 7 vjet, kreu shkollën e ulët dhe të mesme. Manastiri në atë kohë ishte qendër e vilajetit dhe njëherësh e lëvizjes kombëtare shqiptare. Aty kryqëzoheshin përpjekjet e atdhetarëve nga të gjitha vilajetet me Stambollin. Në Manastir në këtë kohë, zhvillonte veprimtari atdhetare e për shkollë shqipe, Hamdi Ohri, i biri i Iliaz Pashë Dibrës (Qoku), me të cilin Sheh Sula, kishte patur bashkëpunim. Kështu përveç arsimit të marrë, këtu Hajredini u vu në lidhje edhe me rrethet patriotike, ku lidhje të ngushtë vendosi me patriotin Hafiz Sherifin. Sapo kish kaluar të 20-tat, më 1903, kthehet në vendlindje, Zerqan. Në këtë kohë, roli i teqesë së Zerqanit, ishte rritur dukshëm, jo vetëm në Dibër, por edhe më gjërë. Familja ishte fuqizuar edhe ekonomikisht. Rreth vitit 1904, Hajredin Shehu, dërgohet për studime të larta, në Stamboll, ku kishin përfunduar studimet edhe paraardhësit familiarë të tij. Në shkollë veç shkencave të kohës, mëson edhe turqisht, arabisht, persisht, anglisht e frëngjisht. Atje njihet me shume shqiptarë e njerëz nga Gryka e Madhe dhe Bulqiza, ndër të cilët edhe me Hamza Gurrën, officer në ushtrinë turke, me të cilin bisedon për zhvillimet politike, veçanërisht për lëvizjen xhonturke. Në një nga këta biseda të zhvilluara, në një kafene të Stambollit, një turk u afrohet pranë dhe u thotë: -"Juve u duhet Turqia dhe Sulltani, dhe jo Shqipëria". Hajredini ngrihet në këmbë, nxjerr nga xhepi revolen dhe e vret turkun. Për t'i shpëtuar hakmarrjes, largohet nga Stambolli për në Tripoli. Deri në pragun e revolucionit xhonturk, qendron nën mbrojtjen e Rexhep Pashë Matit, një mik i vjetër ky i familjes, i lidhur me Sheh Sulën.

Revolucioni xhonturk dhe interesimi i turqëve të rinj, për ta patur teqenë e Zerqanit, në krah të tyre.

Revolucioni i turqëve të rinj, e gjeti Hajredinin në Zerqan, pranë xhaxhait Sheh Sula dhe kushëririt Tush Shehu.. Këtu propogandon idetë e turqëve të rinj dhe bashkë me Tushin e luftëtarë nga Gryka e Madhe, angazhohet në përpjekjet që bëheshin, për përmbysjen e Sulltan Hamitit. Turqit e Rinj shfaqin interes për ta patur teqenë e Zerqanit, në krahun e tyre. Kështu pas revolucionit, ata i ofrojnë Hajredinit detyra të ndryshme. Fillimisht e caktojnë komisar policie në Shkodër e më pas në Tiranë. Gjatë shërbimit në Shkodër dhe Tiranë, u njoh e lidhi miqësi me patriot të shquar si; Refik bej Toptanin, Halil Kuqi etj. Në këto detyra qendroi për një kohë të shkurtër, rreth 1.5-2 vite, pasi mosha e thyer e Sheh Sulës dhe kryengritjet e viteve 1909-1912, bënë që ai të kthehet pranë familjes në Zerqan, për të ofruar ndihmesën e



tij, në udhëheqje të Grykës së Madhe (Zerqanit). Që më parë, pranë teqesë, kushëriri i tij, Tush Shehu, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Sheh Sulës, kishte ngritur çetën e tij, me vullnetarë, në mbrojtje të krahinës. Hajredini bashkëpunon me të dhe me çetat e tjera të Grykës së Madhe dhe Bulqizës, ku bashkë me ta merr pjesë në një sërë aksionesh luftarake, kundër pushtuesit osmnan. Bashkë me Tushin, merr pjesë në të gjitha kuvendet e dheut që organizonte Sheh Sula me krerët e tjerë të maleve të Dibrës.. Gjatë kryengritjes së përgjithëshme të vitit 1912, Hajredini bashkë me Tush Shehun, vihen në ballë të aksioneve luftarake, kundër pushtuesve osmanë e ushtrive serbe. Kështu çeta e komanduar nga Tushi, vihet në mbështetje të shtabit kryengritës, i cili e kishte vendosur qendrën e tij, në Tërnovë të Zerqanit. Nën kujdesin e saj, bëhej edhe lëvizja e krerëve nacionalistë, mes të cilëve edhe Irfan bej Ohrit.

Me organizimin e xhandarmërisë shqiptare nga qeveria e Vlorës, ne dhjetor 1913, Hajredin Shehu, emërohet komisar politik, duke i ofruar detyra në radhët e saj, ku shërbeu në Krujë dhe Durrës. Në këto detyra ai vinte pas përvojës së krijuar nga shërbimet e kryera më parë në Shkodër dhe Tiranë, ndaj dhe i kreu me shumë sukses.

Me ardhjen e princ Vidit, Hajredini vendoset në Durrës, duke i ofruar mbështetjen qeveris së tij. Me largimin e princ Vidit, edhe Hajredini si shume nëpunës të tjerë në shërbim të tij, u largua nga Durrësi dhe shkoi në Zerqan. Këtu vihet në shërbim të teqesë, për kryerjen e shërbesave fetare, pasi mosha e thyer tashmë, e kishte kufizuar mjaft ndjeshëm Sheh Sulën, në kryerjen e tyre. Në veprimtaritë fetare, Hajredini kishte pranë edhe dervish Ibrahim Shehun (ish officer në ushtrinë turke) që e ndihmonte. Gjatë Luftës së Parë Botërore, bashkë me Tushin merr pjesë në një sërë aktivitetesh politike dhe me armë. Kështu gjatë kësaj periudhe zgjeron kontaktet me krerë nacionalistë nga Dibra dhe Mati, ku bisedohej për situatën në të cilën ndodhej vendi, në interes të mbrojtjes së çështjes kombëtare shqiptare.

VDEKJA E SHEH SULËS DHE VENDOSJA E HAJREDINIT, NË KRYESIMIN E TEQESË.

Vdekja e Sheh Sulës, ishte një humbje e madhe, jo vetëm për teqenë e Zerqanit, por edhe për lëvizjen kombëtare në Dibrën e Epërme. Pas Sheh Sulës, Hajredini ishte pinjolli më i përshtatshëm dhe i denjë në krye të teqesë së Zerqanit, pasi kishte shkollimin, inteligjencën dhe përvojën e duhur, si në veprimtarinë fetare, ashtu edhe në atë të veprimtarisë kombëtare në dobi të atdheut, për të mbajtur lart emrin e të parëve, gjyshit Mustafait dhe xhaxhait Sulejmanit. Dhe Sheh Hajredini nuk zhgënjeu në këtë drejtim. Kështu pa mbushur vitin në krye të teqesë, Sheh Hajredini, bëri emër me pjesmarrjen e tij aktive, në ngjarjet kryesore të kohës, ku bashkë me krerët nacionalistë nga Dibra dhe Mati, shpaloste cilësitë atdhetare, në mbrojtje të vendit. Një nga këta tubime të rëndësishme, ku mori pjesë Hajredini, ka qenë ai i mbajtur më 17.03.1919 , në katundin Murrë të Qafë-Murrës, ku morën pjesë 42 vetë nga Dibra dhe Mati. Kuvendi del me një letër dërguar Delegatës së Punëve të Brëndëshme Durrës, që t'i kërkojë Konferencës së Paqes në Paris, se para se të ndajë kufijt, të hedhë vështrim në Shqipërinë e robnueme, ku ka për t'pa shqiptarët në lufë me armiqt që e rrethojn. Ishte koha kur krerët e 9 maleve të Dibrës, lëviznin vrullshëm, sa në Dibër ashtu edhe në Mat. Hajredin Shehu, jo vetëm në sajë të lidhjeve të vjetra të krijuara nga të parët, por edhe atyre të krijuara prej tij drejtpërsëdrejti, vihet në kontakt me krerë të Dibrës së Poshtëme si; Elez Isufi, bajraktarët Selim e Murat Kaloshi, Abdulla Murren etj. Në Dibrën e Epërme e Fushë, krijon lidhje me krerët nacionalistë Dine Dema, Shaqir Cami, Dine e Izet bej Nasufi (Maqellara), Maliq Kërçishta (Agolli), Riza bej Dibra, Nazif Grazhdani etj. Në këto lëvizje, në nënprefekturën e Matit, Hajredini takohet e mban lidhje të forta me krerët Ahmet Bozhiqi, Mahmut Zeneli, Riza bej Çela, Kapllan Allamani, Mal Terziu, Hamit Lezi, Kadri Karrica, Sulë Husa, Lim bej Çela etj. Hajredin Shehu dhe krerët e tjerë dibranë e matjanë, që përbënin krahun e atdhetarëve nacionalistë demokratë të këtyre trevave, në bashkërendim mes tyre, analizuan situatën e vështirë në të cilën ndodhej vendi, veçanërisht trevat e pushtuara nga serbët.

SHEH HAJREDINI I VENDOSUR NË KRAHUN NACIONALIST E DEMOKRATIK, NË KRAH TË FAN NOLIT.

Në fillimvitin 1919, Gryka e Madhe dhe Bulqiza, vazhdonin të ishin zona të nxehta, ku përplaseshin forcat serbo-esatiste me çetat e prira nga Tush e Hajredin Shehu, Ymer Pervizin, Destan Puca, Mehmet Duriçi etj, që duhej të përballonin një forcë të organizuar ushtarake serbe prej rreth 1000 vetësh, të komanduar nga Halit Lleshi, një nga krerët dibranë, që tashmë i kaluar në krahun e serbëve, duke tradhtuar lëvizjen kombëtare shqiptare. Nga Gryka e Madhe dhe Bulqiza, gjegjësisht nga teqeja e Zerqanit dhe teqetë e tjera, nuk evidentohet asnjë rast i kalimit të krerëve, apo personave, në krahun e forcave serbo-esatiste. Përkundrazi, Sheh Hajredini, Tushi, Destan Puca, Dile Voci, Mehmet Duriçi, Ymer Pervizi dhe krerë të tjerë, u bënë barrikadë, kundër forcave serbo-esatiste, që kalonin në këto anë. Kështu në fillim të gushtit 1919, Halit Lleshi në krye të 150 forcave, ndodhej e vepronte me forcat serbe, i përqendruar në Zerqan. Në përplasje me çetat vullnetare të zonës, detyrohet të tërhiqet drejt Dibrës së Madhe. Pas një riorganizimi aty, mësyn sërish në drejtim të Grykës së Madhe dhe Bulqizës. Forcat e shumta serbo-esatiste, arritën deri në Bulqizë, ku ndeshën në rezistencën e organizuar nga Mehmet Duriçi, i cili kordinon veprimet me çetat e Grykes së Madhe, të komanduara nga Tush dhe Hajredin Shehu, Ymer Pervizi e Destan Puca, si dhe me luftëtarë të ardhur në ndihmë nga Gryka e Vogël (Homeshi). Këto zhvillime, përcillen edhe nga ish nënprefekti i Matit, i cili më 15 gusht 1919, i shkruan Delegatës së Punëve të Brëndëshme Durrës: " Populli i Homeshit dhe Zerqanit, 60 vet pa armë dhe 100 vet të armatosur, gjenden në jug të Bulqizës. Ushqimin e ka siguruar nga populli i Bulqizës, por nga zgjatja e situatës së luftës, po vuajnë fort. Ushqimi i këtyre vullnetarëve, që janë të lidhur me qeverinë e Durrësit, e që janë t'u u përpjek me mish e me shpirt, të sigurohet nga qeveria ose të formohet një komision për të mbledhë ndihma nga populli.

Vjeshta e 1919-tës, mbetej tejet e vështirë për Dibrën dhe dibranët, pasi mbeteshin të okupuar nga serbët, në lakminë e tyre për coptimin e Shqipërisë. Një situatë e tillë, i detyron 12 krerët nacionalistë të krahut demokratik të Dibrës, mes të cilëve, Elez Isufi, Dan Cami, Hajredin Shehu, etj, që të apelojnë për qeverinë e Durrësit, për padrejtësitë në qendrimet e Beogradit, që nuk kanë lënë këto territore (dy Dibrat shënim F.SH), të lidheshin me qendrën (Durrësin FSH), për zgjedhjen e kryepleqëve në Prefekturën e Drinit. Por edhe në zgjedhjet e 15 tetorit 1919, qeveria e Durrësit, nuk arriti të realizojë zgjedhjen e kryepleqëve. Ndërkohë qeveria e Durrësit, po e ngushtonte dita-ditës, shtrirjen e veprimtarisë së saj në Dibër. Në të tilla kushte shumë intelektualë atdhetarë, nisin e distancohen prej saj, duke menduar për një tjetër kuvend kombëtar, i cili të mund t'i mbronte më mirë interest kombëtare. Sheh Hajredini ndjek me vëmendje këto zhvillime të reja dhe ofron ndihmesën e tij, pro tyre.

SHEH HAJREDINI, NË MBËSHTETJE TË KONGRESIT TË LUSHNJËS.

Mbështetja që Sheh Hajredini i bëri Kograsit të Lushnjës, bëri që qeveria e Sulejman Delvinës, t'i ofroi atij detyra të rëndësishme. Fillimisht u caktua nënprefekt në Fullqet të Matit, detyrë që e mbajti deri më 1922. Në vitet 1920-1924, Sheh Hajredini, u vu në mbështetje të fuqishme për lëvizjen me karakter demokratik e përparimtarë. Ai, veçanërisht kushëriri i tij, Riza Shehu, një tjetër pinjoll ky i familjes së madhe të shehelerëve të Zerqanit, i cili u vu në udhëheqje të shoqërisë kulturore, të formuar më 1921, në nënprefekturën e Zerqanit. Madje Riza Shehu u zgjodh edhe në krye të degës "Bashkimi" Dibër, në nënprefekturën e Zerqanit. Sheh Hajredini e Riza Shehu, bashkëpunojnë me të tjerë luftëtare të idealeve demokratike si; Vaid Kurmakun, Mustafa Dervishin, Destan Pucën, Mehmet Duriçin, Dile Vocin etj.

Sheh Hajredini, i rreshtuar me krahun nacionalist democrat, kundër Zogut dhe pro Fan Nolit, qeveria e të cilit, e emëroi nënprefekt në Zerqan.

Sheh Hajredini, si shumë krerë të tjerë, vihet në ballë të përpjekjeve kundër rikthimit të Ahmet Zogut, në Shqipëri. Në vijim të këtij qendrimi, krerë si, Elez Isufi, Hajredin Shehu etj, më 18 shtator 1924, organizojnë në Peshkopi, një tubim të gjërë, i quajtur ndryshe "Kongresi i Malsisë". Në zhvillimet e armatosura gjatë kthimit të Ahmet Zogut në Shqipëri, Sheh Hajredini, qendroi në distancë duke mos u përfshirë në përleshjet me armë.

Vitet në vijim i kaloi pranë teqesë, duke u vënë totalisht, në organizimin e saj. ku më vonë u vesh Sheh. Në teqe, krahas shërbimeve fetare, bisedonte me mbështetësit edhe për situtën e krijuar në vend. Ndryshimet pozitive të bëra nën qeverinë e Zogut, bënë që Sheh Hajredini, të krijojë një tjetër imazh për Ahmet Zogun.

HISTORIA E SHKOPIT, QË SHEH HAJREDINI, JA BËN "DHURATË" VIKTOR EMANUELIT.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, Sheh Haredini, caktohet në delegacionin që do t'i dërgonte kurorën e Skënderbeut, Perandorit të Italisë, Viktor Emanuelit të III-të. Pa dëshirën e tij, vijnë dhe e marrin në Zerqan, dy oficerë të fashios italiane dhe e bashkojnë me dërgatën e Dibrës, për ta çuar në Romë. Shehu në momëntin që avioni po ulej për t'i marrë, i drejtohet kolegut të delegacionit me të cilin po bisedonte: -Të lutem ma mbaj pak shkopin se erdha dhe zhduket. Avioni ulet, por shehi, nuk dukej gjëkundi. Ora e nisjes së avionit erdhi dhe ai nuk mund të priste më gjatë Sheh Hajredinin. Sapo avioni ngrihet lart, ai shfaqet në shesh dhe ngren shikimin lart, në drejtim të avionit, ku belbëzon; - "amanet shkopin". Kjo përveçse kujtimeve gojore të familiarëve të teqesë ndër vite, konfirmohet edhe nga një dokument i lëshuar nga Muzeu i Dibrës, të firmosur nga kryetari i Lidhjes së Historianëve Dibër Adem Bunguri dhe ish drejtori i Muzeut Dibër Gafurr Zoto, ku tekstualisht thuhet:

"Pasi u paraqit në Romë delegacioni që dërgonte kurorën e Skënderbeut, Perandorit të Italisë, kryetari i delegacionit i tha Viktor Emanuelit të III-të se gjithë paria është prezent, vetëm Sheh Hajredini nuk është, por ai në këmbë të tij më ka dhënë këtë shkop (bastun). Pastaj edhe ai copë dru thane I maleve tona, kaloi dorë më dorë. I pari e mori Viktor Emanueli, pastaj Beneto Musolini, Konti Çiano….e përsëri në suart e perandorit i cili tha: -Sinjore, të mos e harroni ta merrni me vete këtë bastun, kur të shkojmë në Shqipëri, se kam dëshirë ta njoh edhe atë, të zotin e këtij bastuni, se është një symbol vllazërimi?!! Ata që e njihnin, thanë me vete, do ta njohësh, edhe ai vetë, një shkop thane është".

Po sipas këtij dokumenti thuhet se; -ditët e prillit 1940, Sheh Hajredini, u helmua nga fashistët italianë dhe vdiq më 6.04.1940. Tre ditë pas varrimit, fashistët italianë, vijnë dhe i hapin varrin, Sheh Hajredinit, për t'u bindur nëse ka vdekur vërtet, ky atdhetar i flaktë që kishte rrokur pushkën, që më 7 prill 1939 kundër fashizmit.

Gjithsesi bëmat e Sheh Hajredin Zerqanit, ishin dhe do mbeten një shembull i lartë patriotik për brezat, në mbrojtje të çeshtjes kombëtare.

Rruga e Arbërit nr. 170

Z.Qemal Çadri, Qytetar nderi i Bashkisë Dibër: Personalitet i spikatur dhe udhërrëfyes në rrugëtimin e mjekut, që me cilësitë personale, njerëzore, profesionale, ngriti në nivelet më të larta mjekësinë në Dibër e në mbarë Shqipërinë.

profil

QEMAL ÇADRI, një meteor që nuk do të shuhet kurrë

Nga prof. **NAZMI KOÇI**



Më 14 korrik 2020 u nda nga jeta në mënyrë të papritur mjeku i mirënjohur dibran, specialist në disa fusha të mjekësisë , i njohur në të gjithë vendin, por sidomos në Dibër e Tiranë, ku shërbeu si mjek e specialist me devocion të lartë për rreth 40 vjet. Në luftë bien ushtarë, por bien edhe gjeneralë. Njeriu që luftoi gjithë jetën e tij me vdekjen dhe shpesh fitoi mbi të, më në fund u mund prej saj. Me karakterin e fortë njerëzor dhe me përgatitjen e lartë profesionale që kishte, ai luftoi gati një dekadë me një sëmundje të rrallë e të rrezikshme. Luftoi dhe vendosi ekuilibër në fushën e betejës, aq sa i habiti specialistët vendas dhe të huaj me qëndrueshmërinë dhe mbijetesën e tij, e rrallë në një situatë të tillë. Më në fund , kur nuk pritej , u largua në mënyrë të papritur duke ruajtur humorin e hollë dhe kthjelltësinë e mendimit deri në momentin e fundit të jetës. La në trishtim familjen e tij , vëllezërit dhe motrën, pacientët e shumtë kudo nëpër Shqipëri dhe miqtë e shokët që e donin aq shumë pasi konsiderohej shok, mik dhe idhull për shumicën prej tyre. Po kush ishte Dr. Qemali, humbja e të cilit la një boshllëk kaq të madh në shërbimin shëndetësor dhe në shoqëri.

Lindi në fshatin Trebisht të Dibrës (sot rrethi Bulqizë), më 23/10/1944 në familjen e Mehmet Çadrit, mësuesit të njohur normalist, që dha kontribut të spikatur në zhvillimin e arsimit në trevën e Dibrës. U rrit në fshatin e tij në një familje me 6 vëllezër dhe një motër. Kreu me rezultate shumë të mira arsimin shtat vjeçar në fshat dhe në vitin 1958 u regjistrua në Politeknikumin mjekësor në Tiranë të cilin e përfundoi në vitin 1962 me rezultate të shkëlqyera . U dërgua direkt për studime në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë të cilin e përfundoi gjithashtu shkëlqyeshëm në vitin 1967. Ai nuk qe një student i shkëlqyer, por me shumë se kaq, qe i jashtëzakonshëm dhe kjo e bëri të përmendej si një nga shembujt më pozitivë për dekada të tëra. U emërua fillimisht në Peshkopi dhe më 1968 u transferua në spitalin zonal të Klenjës. Kudo shkëlqeu puna dhe profesionalizmi i tij. Në vitin 1970 u dërgua për specializim për Kirurgji të përgjithshme në Tiranë. Ai ishte target i të gjitha klinikave të specializuara dhe shefat e tyre e njihnin të gjithë si një rast e talent i rrallë, ndaj dhe kërkonin ta tërheqin në fushën e tyre. Në vitin 1973 për nevoja të kohës u dërgua për specializim në patologji të përgjithshme për 3 vjet , të cilin e kreu me sukses të plotë. U emërua shef i shërbimit të patologjisë në rrethin e Dibrës, detyrë të cilën e kreu për 14 vjet. Bëri disa kualifikime të tjera si në pneumologji, kardiologji, neurologji e nefrologji dhe u bë një nga specialistët më të kompletuar të fushës së mjekësisë në Dibër e në shkallë vendi. Më 15 qershor të vitit 1982 u emërua drejtor i spitalit të Peshkopisë dhe më 1 qershor 1983 përgjegjës i seksionit të shëndetësisë të rrethit Dibër. Kudo shkëlqeu me punën dhe talentin e tij si specialist dhe organizator e njeri me cilësi të rralla. Në vitin 1991 u transferua në Tiranë pranë familjes ku punoi në Urgjencën e Tiranës, Drejtor i Poliklinikës nr.10 dhe si specialist deri sa doli në pension.

Ç'farë e bëri të njohur sa qe gjallë dhe te pavdekshëm pasi u nda nga jeta mjekun , specialistin dhe njeriun e mirë, Qemal Çadri ? Si një njeri që e kam njohur që në fëmijëri dhe kam kaluar një rrugë të përbashkët me të, që nga viti1960 e deri sa ai u nda nga jeta, do të përpiqem të them ca fjalë , aq sa më lejon formati i këtij shkrimi. Them kështu pasi në konsideratën e njohjen time , ai meriton monografi e libra dhe është një fenomen njerëzor i pa përsëritshëm.

Kolegu ynë, Qemal Çadri, ishte një kategori e veçantë njerzore. Aty plekseshin në mënyrë harmonike e nivel të lartë cilësi të tilla si erudizmi, dashuria për shkencën dhe profesionin, modestia e tej skajshme, dashuria për njerëzit, sidomos pacientët që i njihte shpejt, i kuptonte mirë dhe ju shërbente njëlloj, por gjithmonë në një nivel të admirueshëm, jo të arritshëm nga kushdo. Për të ishin të shenjta dashuria për familjen dhe kolegët. Në dukje disi "i pa kujdesshem", ai ishte modeli i njeriut që dinte të donte pa përkëdheli , por me respekt të lartë njerëzor familjen dhe fëmijët e tij të cilët i edukoi me cilësitë më të mira të qytetarëve dhe intelektualëve të kohës. Qe i butë e i arsyeshëm me kolegët dhe kurrë nuk u duk i ashpër e i pa drejtë me ta. Ai që natyra e pajisi me virtyte e aftësi të tilla që i kultivoi e zhvilloi edhe vetë në jetë, mund të vinte poshtë vetes këdo me 4-5 fraza, kurrë nuk bëri të diturin e të fortin. Rrezatoi dituri e qytetari edhe kur ishte mjek i thjeshtë fshati, por sidomos në pozicione drejtuese , kur jo rrallë , jo fjala e pa menduar por edhe heshtja, mund të bënte dëme deri të pariparueshme. Por ai, i pajisur me një kurajo të pa zakonshme, nuk heshti kurrë kur nevojitej fjala e tij, në rastet kur ai qe i pranishëm.

Ne se do ta krahasoja me ndonjë kategori filozofike, ai ishte një fenomen apo kategori që përfaqësonte të pa përsëritshmen, të jashtëzakonshmen. Kjo më shtyn mua të flas për të edhe me pasion , por plotësisht në meritë. Si kategori filozofike do të thosha se pati probleme me kategori të tjera të këtij lloji si koha dhe hapësira.

Ai pati probleme me kohën se ajo për të ecte ngadalë, ndërsa mendimi dhe vullneti i tij kërkonin një ritëm tjetër. Nxënës dhe student ai nuk kishte nevojë të kyçej e të studionte 4-5 orë në ditë siç ishte e obligjuar dhe siç bënim të gjithë. Ai dëgjonte dhe regjistronte njëkohësisht çdo detaj që thuhej në leksione e praktika. Me pas i duheshin 10-15 minuta për të bërë një sistemim që si rregull e kryente diagonal dhe gjithçka mbetej aty e fiksuar e regjistruar në "hard diskun" e tij për gjithë jetën. Një inteligjencë dhe memorie përtej normales do ta bënin atë të pa thyeshëm në mendime apo në konsulta dhe që kur qe student do të debatonte me ata që ishin në majat e shkencës dhe do të shijonte modestisht fitoren e tij. Si specialist nuk mbytej midis dokumenteve dhe analizave, por bënte sintezë dhe nxirrte përfundime të shpejta. Qemali i ngjasonte shkencëtarit të famshëm francez , Lamarkut, i cili në kohën e vet pat deklaruar: "Më jepni një kockë te vetme dhe unë do të ju ndërtoj skeletin e kafshës që i përket ajo".

Ai pati problem me hapsirën gjithashtu si kategori filoziofike e veçantë. Hapsira shpesh nuk ishte e mjaftueshme për të. I "rrinte ngushtë kostumi"që i kishin veshur dhe në mënyrën e vet ai do ta kontestonte këtë fenomen. Një herë u shpreh në këtë mënyrë: "Ç' do të kishte bërë Ajnshtajni në qoftë se nuk do ti kishin dhënë hapësirën e nevojshme, a do të ishte ai që u bë në të vërtetë. Në se atë do ta kishin mbyllur në barakën e një këpuctari, me siguri vetëm të ngulte gozhda do të kishte mësuar. Mund ta bënte këtë më mirë se të tjerët , por vetëm kaq do ishte kontributi i tij". E kam thënë diku tjetër se në se Qemal Çadrit do ti qenë krijuar mundësitë, kishte talent e dhunti të matej me më të mirët në Europë e në botë.

Konsideratën time për të edhe pse njihemi prej 60 vjetësh, nuk e kam vetëm personale. Me këdo që e ka njohur nga afër, kam gjetur të konsoliduar të njëjtin mendim që ngjasonte me vlerësimet e mia. Në morinë e fakteve pa fund , po përmend vetëm dy raste të tilla. Pata rastin të punoj disa vjet në Komitetin Ekzekutiv të rrethit si përgjegjës i seksionit të Shëndetësisë dhe në këtë detyrë shkova pas Qemal Çadrit. Isha i prirur të zbatoja çdo gjë që ai kishte nisur të bënte apo i kishte premtuar dikujt, por i la në mes. Kjo nuk ishte punë shokësh, por ishte besimi im i plotë në logjikën dhe drejtësinë e detyrave që ai kishte përcaktuar të bënte. Në vitin 1987 u zhvillua një aktiv kombëtar për shëndetësinë në Shkodër ku shkuam dhe ne një grup jo i vogël nga Dibra. Qe një takim serioz ku merrnin pjesë 4 anëtare të Byrosë politike. Mbledhjen e drejtonte Zv. Kryetari i K.M., i cili kishte studiuar për mjekësi ne Itali , mbulonte arsimin dhe shëndetësinë dhe ishte ndër kuadrot më aftë të asaj kohe. E vlerësova takimin dhe shkova i përgatitur edhe pse në telegramin e njoftimit thuhej se nuk jeni planifikuar për diskutim. Në atë mbledhje duhet të aprovoheshin objektivat e shërbimit shëndetësor lidhur me vdekshmërinë foshnjore deri në vitin 2000. Për hir të së vërtetës ishin tregues shumë të guximshëm sa nuk kisha besim se do mund të realizoheshin. Ata që diskutuan, të gjithë u shprehën se ishin dakort me objektivat. Krejt pa pritur drejtuesi i mbledhjes kërkoi të dëgjonte rrethin e Dibrës, ishte radha ime. Dola dhe fola për shërbimin shëndetësor ne Dibër, për realizimet dhe problemet e tij pa eufori , por duke evidentuar punën e bërë. Dibra ishte ndër 3-4 rrethet kryesore dhe treguesit e Republikës pa Dibrën nuk mund të bëheshin. Ai më pyeti , po për objektivat deri në vitin 2000, ç'farë mendoni? Mund të thuhej po, siç vepruan të tjerët, por pas disa muajsh kjo punë do të analizohej dhe realisht nuk isha i bindur per to. Me kujdes i thashë se kjo nuk është detyrë vetëm e shefit, në se unë zotohem ju nuk duhet të më besoni. Kërkoj një muaj kohë që ta diskutoj me strukturat e rrethit dhe gjithë personelin shëndetësor dhe do të sjelle në qeveri një mendim më të plotë se ai i një shefi. Për çudi drejtuesi i rreptë nuk u mërzit, por më tha: " Faleminderit, keni të drejtë ". Pas 6 muajsh na thirri në analizë dhe kur erdhi radha ime nuk më pyeti më për objektivat, por më tha: Po ai shefi që ishte para teje ku ndodhet? I thashë se ai është tani Drejtor i institucioneve të mjekimit të rrethit dhe bën një punë që askush nga ne nuk mund ta bëjë si ai, ndërsa këtë detyrë e bëjmë disi edhe ne të tjerët. Ai vazhdoi : Qe djalë shumë i zgjuar , prandaj po te pyes të dhe vazhdoi : jeni djem të mirë ju dibranet. Nuk qe e folur e zakonshme për kohën. Qemal Çadri e kishte shtruar tapetin edhe për mua, sa qeshë aty nuk u konfliktova as me zv. Kryeministrin as me ndonjë tjetër siç bënin vazhdimisht përfaqësuesit e rretheve të tjera.

Në një rast të dytë ,gati një vit më parë , ishim një grup intelektualësh dibranë që shkuam për të vizituar tunelin e rrugës së Arbërit në Qafë të Murrizit. Rasti e solli që të isha bashkë me shkrimtarin Xhaferr Martini dhe biseda erdhi mbi një mikun tonë të përbashkët, Dr. Qemalin. Ai pa u menduar shumë dhe në mënyrë sintetike më shprehu mendimin e tij duke deklaruar se në gjithë jetën time nuk kam njohur njeri më inteligjent se Qemal Çadri. Fjala e tij ka përmbajtje të thellë, humori është mjaft i hollë, shikimi i tij zhbirues dhe ajo nënqeshja e tij thotë mijëra fjalë në të njëjtën kohë. Këto ishin afërsisht ato që më tha . Këto po i thoshte një njeri që ka njohur dhjetëra mijëra njerëz në jetë, që ka shkruar dhjetëra libra e përshkruar me mijëra karaktere njerëzore, një krijues i spikatur dhe një mik i tij. Kisha dëgjuar qindra vlerësime të tilla për të nga ata që kishin arritur ta njohin sadopak nga afër. Unë them kështu pasi jam i bindur se ai ishte një univers i atij lloji që nuk ishte e lehtë ta kuptoje dhe njihje tërësisht e në çdo detaj. Në ditët që e përcollëm, shoqja e tij Dr. Avija, m'u drejtua me fjalët : "Ne të dy ishim ata që e kemi njohur më mirë Qemalin, ai pat deklaruar vetë kështu". Doktoreshë i thashë , ne kemi njohur anë të veçanta të tij , ti e njohe atë si bashkëshort, ndërsa unë si mik, por jo Qemalin si fenomen. Ishte një univers i llojit të vet , i komplikuar e i pa fund sa që ishte e vështirë ta njihje plotësisht me botën e vet të jashtëzakonshme e krejt unike.

Qemal Çadri i kaloi vitet e fundit të jetës me shqetësimin e një sëmundjeje të rrallë e të vështirë, me të cilën u muar ai vetë, specialistë të vendit e të huaj dhe ishte nën kujdesin e familjarëve të tij ku bashkë me të bënin pjesë 4 mjekë. Ishte skuadra që ai pat përgatitur vetë dhe ata u kujdesën me devocion deri ne fund si ushtarët për komandantin e tyre. Sëmundjen dhe dhimbjen i përballoi me dinjitet. Ai që kishte bërë mjekun në mënyrë të shkëlqyer gjithë jetën e vet, diti ta bënte me dinjitet edhe pacientin dhe ti përballonte të gjitha shqetësimet që i sillte sëmundja. Organet, trupi i tij u lodhën, një gjë mbeti e pa ndryshuar, kthjelltësia e mendimit, qartësia e tij, deri në sekondën e fundit ai ishte po ai Qemali i zgjuar, i ditur e fenomen siç kishte qenë gjithmonë. Truri

Kolegu ynë, Qemal Çadri, ishte një kategori e veçantë njerzore. Aty plekseshin në mënyrë harmonike e nivel të lartë cilësi të tilla si erudizmi, dashuria për shkencën dhe profesionin, modestia e tejskajshme, dashuria për njerëzit, sidomos pacientët që i njihte shpejt, i kuptonte mirë dhe ju shërbente njëlloj, por gjithmonë në një nivel të admirueshëm, jo të arritshëm nga kushdo. Për të ishin të shenjta dashuria për familjen dhe kolegët. Ishte modeli i njeriut që dinte të donte pa përkëdheli, por me respekt të lartë njerëzor familjen dhe fëmijët e tij...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK

Këshilli Bashkiak Dibër me Vendim Nr.115, datë 22.11.2019,
Për dhënie Titull Nderi,
Vendosi:

QYTETAR NDERI I BASHKISË DIBËR
"Z. QEMAL ÇADRI",

Me motivacionin:

"Personalitet i spikatur dhe udhërrëfyes në rrugëtimin e mjekut, që me cilësi personale, njerëzore, profesionale ngriti në nivelet më të larta mjekësinë në Dibër e mbarë Shqipërinë."

Kryetar Këshilli — Sokol Sava
Sekretare Këshilli — Inva Thuja
Kryetari i Bashkisë Dibër — Dionis Imeraj

Miku im Qemal, në mendjen tonë do të mbetesh përherë i gjallë e fisnik, i dashur e i paharruar përjetësisht. Kujtimi yt do të na frymëzojë e ndriçojë sa të jetë jeta.

i tij mbeti i paprekur si maja e një kështjelle që përfaqëson madhështinë e saj, edhe kur muret fillojnë të rrënohen.

I vlerësuar e respektuar gjithmonë nga të gjithë, qytetarë , pacientë e kolegë në Tirane e në Dibër ai do të ishte i tillë edhe më datën 22/11/2019, kur Këshilli Bashkiak i Bashkise Dibër, me Vendimin nr.115 të asaj date vendosi që Z. Qemal Çadri të shpallet Qytetar nderi i Bashkisë Dibër me motivacionin: "Personalitet i spikatur dhe udhërrëfyes në rrugëtimin e mjekut, që me cilësitë personale, njerëzore, profesionale, ngriti në nivelet më të larta mjekësinë në Dibër e në mbarë Shqipërine". Në pak fjalë thuhet krejt qartë ajo që ai bëri në mbi 40 vjet shërbim ndaj njerëzve kudo ku u ndodh. Me këtë rast më duhet ta falenderoj me shumë sinqeritet Këshillin bashkiak të Bashkisë Dibër për këtë gjetje shumë të merituar. Dibra dhe Qemali i bënin nder reciprokisht njëri tjetrit. E konsideroj detyrë që të falenderoj Kryetarin e Bashkisë z. Dionis Imeraj dhe të gjithë ata kolegë e miq që u kujdesën që kjo procedurë të shkonte deri në fund. Midis tyre i pari do te ishte kolegu dhe miku ynë i përbashkët, Dr. Ramazan Buci me banim këtu në Tirane. Në Dibër e mbështetën kolegë të tjerë si mjekët Beqir Bici, Filip Cfarku e Gëzim Puci, por edhe mjaft të tjerë në shëndetësi e jashtë saj. Kanë nderuar veten të gjithë këta, pasi kanë treguar se njihnin nga afër një personalitet si Qemal Çadri dhe kjo për mua është një risi për të gjithë ata që e kanë patur këtë shans. Doktor Qemali e mësoi këtë lajm dhe u entuziazmua mjaft. Mendova se më kishin harruar më tha, por me sa duket njerëzit më duan akoma. Atëherë kur njerëzit të duan ja vlen të jetosh. Ai e mësoi lajmin, por nuk arriti ta prekte me dorë këtë dekoratë që edhe pse në meritë është një vlerësim me shumë vlere. Pandemia e virusit covid 19 bëri punën e vet dhe në pritje që ajo të kalonte dhe të mblidheshim në një aktivitet siç e donte ai dhe me të në qendër, gjendja u përkeqësua dhe ai u largua pa pritur. Edhe pse dihej gjendja e tij shëndetësore, askush nuk e priste një përfundim të tillë në atë mënyrë dhe në atë kohë që ndodhi. Virusi që është në qarkullim këtë vit na prishi jo vetëm cilësinë e jetës, por edhe atë të vdekjes. Shumë gjëra në këto kushte mbeten pa u kryer dhe ritet e vdekjes që kemi trashëguar dhe që për mua janë nga më të mirat në botë, mbeten pa u kryer siç njeriu do të dëshironte. Megjithatë familja u kujdes që për të, të zhvillohej një ceremoni dinjitoze dhe me masat e duhura mjekësore. U jam mire njohës atyre pasi me vunë edhe mua në radhë me vëllezërit e Qemalit, midis Dilaverit dhe Ramazanit, një tjetër aset me shumë vlera intelektuale e njerëzore në Dibër e në Tiranë. Më duhet të falenderoj edhe të gjithë ata dibranë dhe jo vetëm , që duke njohur miqësinë dhe raportet tona, më ngushëlluan edhe mua si të isha vëlla prej nëne me Qemalin. Të tillë ka patur me dhjetëra dhe u jam mirënjohës. Po citoj vetëm njërin, atë të një punonjësi të vjetër e të dalluar të shëndetësisë në Dibër dhe mikut tonë të përbashkët Dilaver Gjoni, i cili më shkruante: "Dr. Nazmiu, ngushëllime për shokun e mirë e të rrallë Dr. Qemal Cadrin, qoftë i xhenetit ".

Qemal Cadri u përcoll me të gjithë nderimet e duhura, me një ceremoni të organizuar mirë, me të afërm, miq e shokë. E përfytyroja se sa do të ishte kortezhi i njerëzve sikur kjo ceremoni të zhvillohej në Dibër ,qoftë edhe Tiranë, në kushte normale. Në vendin ku u vendos trupi i tij u ngrit një mal me lule , i denjë për një njeri që të gjallët e kësaj bote e deshën fort dhe kanë mënyrën e vet për ta nderuar pas ndarjes prej tij. Njerëzit pa dyshim që e deshën atë dhe do ta nderojnë përjetësisht pse ishte madhështor në profesionin e tij në shëndetësi dhe njëherazi fisnik në të qenët njeri. Dhe madhështia lind së pari nga thjeshtësia, ky ishte mesazhi që na la miku ynë Dr. Qemali. Ndjehem shumë i nderuar që në jetë ecëm bashkë, mësuam, punuam e ëndërruam bashkë. Miku im Qemal, në mendjen tonë do të mbetesh përherë i gjallë e fisnik, i dashur e i paharruar përjetësisht. Kujtimi yt do të na frymëzojë e ndriçojë sa të jetë jeta. Përsiatjet e mia me këtë rast nuk kanë fund, pasi ka fjalë që qajnë dhe lot që flasin për humbjen e njeriut dhe mikut të shtrenjtë. Dhe po i mbyll këto radhë me vargjet e Dritëro Agollit: " Dhe floriri mund të ndryshket,/ edhe ylli digjet, shkon/ dashuria midis nesh / s'ndryshket kurrë, nuk perëndon".

Gusht 2020

"Selim Sula nuk ka nevojë për lavdi, ne kemi nevojë shumë për të"

Selim Sula, ambasadori shëtitës i Elez Isufit

Nga **SHAQIR SKARRA**

Një jetë nëpër odat e Dibrës dhe malet me borë, nëpër qelitë e burgjeve dhe pallatin e mbretit. Një libër i pa shkruar, por që mbushen mijëra fletë me fjalën e mençur dhe alegorinë e këtij studenti që mori diplomën në "Universitetin e Dibrës".

Në qoftë se historia ka borxhe për të larë karshi Sllovës, do të mbetet fajtore për jetë. Zonë pa monumente e përmendore, pa histori e muze që i përkasin këto merita. Mburret me të drejtë Sllova për gjeneralët dhe kolonelët e saj, për shtatmadhorët e patriotët e vërtetë. E pikërisht në këtë fshat, në një shtëpi të varfër e me tradita patriotike e atdhetare, në vitin 1885 lindi ai që me të drejtë Dibra edhe Luma e quajtën "Filozofi i pa diplomuar" megjithatë ai ishte diplomuar në Universitetin e Dibrës, në odat dibrane ku një diplomë të tillë rrallë kush e meritonte.

Shumë veta brenda e jashtë sinorit të Dibrës kanë dëgjuar të flitet për Odën dibrane, Selim Sulën dhe fjalët e tij proverbiale.

Gjenerali me shajak, udhëheqësi popullor i Dibrës Elez isufi, duke parë tek djaloshi që po rritej se zgjuarsia e tij i kalonte kufijtë e çdo moshe e mori këshilltar pranë vetes. Kështu e nisi udhën e tij të vështirë e mjaft të bukur ambasadori shëtitës , të cilin në një kohë fare të shkurtër filluan ta cilësonin si "Sokrati i Dibrës.

Gjykimi dhe fjala e këtij burri të mençur bie në tokë sepse përfaqësonte mendimin e kohës.Selim Sula, ky filozof e përfaqësues i denjë i mendimit popullor, që ndjell sikur të jetë një copë e shkëputur nga mali i lartë i Korabit e që ruan të gjithë përbërjen e këtij mali kreshnik, do të kujtohet me respekt e do të cilësohet si një shkollë për gjeneratat që do të vijnë.

Fjalën e tij të mençur e blinte i riu dhe i moshuari, fshatari dhe intelektuali, bajraktari dhe vetë mbreti. Në takime pune, por dhe në biseda të lira që zhvillonte Elez Isufi me krerët e Dibrës dhe Lumës, me Bajram Currin e Isa Boletinin do të ishte kurdoherë i pranishëm dhe Selim Sula.

Nuk ka asgjë të shkruar e dokumentuar për filozofin dibranë, por të moshuarit, brezi i tij sa ishin gjallë tregonin me vërtetësi e realitet edhe pse historia ka qëndruar memece.

Selim Sulën do ta gjeje shpesh herë në konakun e Dine Hoxhës,, Muharrem Bajraktarit, Murat Kaloshit, bejlerët e Maqellarës, tek Demet e Homeshit . Në këto oda futej si ambasador i Elez Isufit por Selim Sula shkonte dhe në odat dibrane, aty ku muhabeti merrte udhë edhe për probleme politike të kohës por edhe për halle e shqetësime të ndryshme. Kështu do ta gjeje në Reç tek teqja e Troci, në Luzni tek Murrja e Manuka, në Çidhën tek Kola e Noka, në Vleshë tek sheh Zumani, në Lurë tek bajraktari e Gjoçi.

Ndër karakteristikat e veçanta të tij ishte se gjithmonë mbronte atë që nuk e kishte pranë. Në saj të zgjuarsisë së tij, duke përdorur gjithmonë fjalën e mençur dhe alegorinë dibrane bëri të pa mundur që të shpëtojë jetë njerëzish nga kthetrat e vdekjes së sigurt, por fali edhe gjaqe me përmasa të mëdha.

Vrasja tinzare e Elez Isufit një dhjetor të vitit 1924 ishte një dramë që i kaloi caqet e përmasat e dhimbjes familjare. Selim Sula kishte kaluar vitet më të bukura të jetës së tij pranë gjeneralit me shajak e nga kjo derë, e fisme bujare, "sokrati dibranë" kishte mësuar më shumë se sa dhuntitë që ia kishte falur natyra. Në këtë periudhë, Cen Elezi, djali i Elez Isufit ishte futur nëpër analet e politikës europiane.

Prestigji i tij po rritej dita ditës në popull e kështu filozofi i pa diplomuar nuk kishte pse të shkëputej nga djali i Elez Isufit.

Filloi pra kështu periudha e dytë e ambasadorit shëtitës e cila do të kalonte mes peripecive të ndryshme; nga odat dibrane, në pallatin e mbretit, i arratisur në male dhe në qelitë e burgut famëkeq të shtetit diktatorial të instaluar në vendin tonë, por gjithmonë "Sokrati i Dibrës" kudo doli i fituar. Humbi ai që ndeshej ballë përballë me Selim Sulën.

Ruajnë kujtimet më të bukura ata që jetuan në kohën kur fjala e tij filozofike u bë melhem edhe për plagën e gjakmarrjes, e sot nëpër odat dibrane kur muhabeti merr udhë, fjala e mençur dhe alegoria ndeshen ballë për ballë e gjakrat nxehen, mjafton vetëm njeri të thotë shprehjen :"Ka thënë Selim Sula" e në çast çdo gjë shuhet nga fillimi.

Ishin vitet e para kur komunizmi u shfaq me tërë egërsinë e tij e më vonë diktatura e proletariatit vazhdojë të godas koka të pa fajshme. Cen Elezi me shpirt e zemër demokrati e nuhati se çfarë po sillte komunizmi në Shqipëri. Ndaj në vitin 1946 u arratis bashkë me djemtë e tij, dhe me këtë veprim tepër të guximshëm i tha Enver Hoxhës:" Unë nuk mund ta ha atë çorbë që po gatuan". Së bashku me Cenin, ambasadori shëtitës la Sllovën dhe mori udhën e malit.

Me porosi të Koçi Xoxes iu kërkua Cen Elezit të dorzohej së bashku me djemtë që ti falej jeta. E Ceni e dinte fare mirë se çfarë fshihej pas "besës dhe sinqeritetit" të Koçi Xoxes dhe megjithatë, falë moshës së re të djemve e pranon që djemtë e tij së bashku me Selimin të dorëzohen në "besën: e Koçi Xoxes. Dhe "besën" e mbajti Koçi Xoxe pasi djemtë e Cen Elezit e Selim Sula përfunduan brenda qelive të burgut të Peshkopisë. Ishte hera e katërt që Sokrati i Dibrës bëhej banor i qelive dhe si gjithmonë, falë fjalës së tij të mençur dilte gjithmonë i fituar. Ishte avokat i vetvetes.

Tashmë shtëpia e tij në Sllovë ishte shembur e plaçkitur. Shpata e diktaturës kishte filluar të binte pa mëshirë mbi familjen e madhe të Ndreut. Megjithatë sofra e bujarisë shtrohej në Sllovë, por edhe në Dibër e Lumë për ambasadorin shëtitës të Elez Isufit. Megjithatë dikujt nuk i interesonte shumë që Selim Sulën ta respektonin Ujemuja, Malet e Dibrës dhe e gjithë krahina e madhe e Lumës.

Tregojnë se një ditë në turizmin e Peshkopisë Selim Sula ishte ulur dhe po priste kafen që kishte porositur. Pranë tij ndodhej dhe kryetari i degës së brendëshme me suitën e tij.

-Mos ma tund atë kafe sikur tundet gjiza, i kthehet Selimi kamarierit.

-E çfarë kërkon me thënë me këto fjalë or Selim, i kthehet kryetari i degës. Sokrati i Dibrës heshti, nuk e zgjati më shumë bisedën por nuk mundi të hesht kryetari i degës.

-U takua Tito me Cen Elezin në Beograd e tani kërkonte të takohej edhe me ju.

-Sa për Titon të garantoj o kryetar , se mua nuk më njeh fare, ndaj nuk ka pse më kërkon të më takojë. Takime ka bërë dhe vazhdon të bëjë me shokë e miqtë e tu. Kaq gjë besoi se duhet ta dini dhe ju.

Mjaftojnë këto fjalë thënë me mjeshtëri e pjekuri nga Selim Sula e muhabeti u prish "në paqe" por kryetari nuk mund ti harronte lehtë fjalët helm të thënë nga ambasadori shëtitës i Elez Isufit. Dhe rasti iu dha në spitalin e Peshkopisë.

Tashmë vitet e pleqërisë dhe nga një plevit i hershëm iu imponua filozofit të shtrohej në spitalin e Peshkopisë. Nuk dihet se si dhe nga kush i ra në vesh kryetarit të degës i cili urdhëroi që i sëmuri Selim Sula të nxirrej jashtë spitalit. Edhe pse kjo botë paska njerëz me shpirt të zi katran, që flaknin në rrugë të sëmurë Selim Sulën, përsëri do të gjendeshin njerëz human si Shaban Strazimiri e kolonel Suri Strazimiri të cilët do ta merrnin dhe ta shëronin në Tiranë njeriun që gjithmonë foli vetëm fjalë të mençura.

Pasi shërohet del nga spitali dhe kthehet në Sllovë të jetonte vitet e pleqërisë , pasi me Sllovën e lidhte çdo gjë e mirë dhe e bukur. Tek shtëpia e Shemsi Çores sëmuret përsëri sa këtë radhë edhe vetë po e shikonte vdekjen se e kishte afër.E gjithë Sllova ishte vënë në shërbim të filozofit mirëpo sëmundja kishte përparuar e nuk kishte mjek më që ta ndalonte. Ishte viti 1966 e kur e pa veten të ligështuar mjaft shumë nga shëndeti kërkoi ta dërgonin në Lisivalle tek Rushir Ndreu.

-Do të vete të shërohem në Tiranë, u tha burrave të Sllovës atë mëngjes vjeshte kur e nxorrën nga shtëpia. Po, kjo kishte qenë vetëm një nga ato fjalët e mençura filozofike që thoshte ngaherë e rrallë kush i kuptonte. Kur vajti në Lisivalle dhe pa Rushitin që po përgaditej vërtet për Tiranë, iu kthye buzagaz:

-Or Rushit Ndreu. Nuk e tradhëton lehtë Selim Sula bukën e Ndreut, jo. E pikërisht aty, ku lindi vite më parë gjenerali me shajak Elez Isufi, mbylli sytë përgjithmonë jo në vetmi, por mes njerëzve që e deshën dhe i deshi, ambasadori shëtitës i Elez Isufit.

Një jetë nëpër odat e Dibrës dhe malet me borë, nëpër qelitë e burgjeve dhe pallatin e mbretit. Një libër i pa shkruar, por që mbushen mijëra fletë me fjalën e mençur dhe alegorinë e këtij studenti që mori diplomën në "Universitetin e Dibrës".

E si përfundim për "Sokratin e Dibrës" të harruar, për filozofin e pa diplomuar të mbetet lapidare thirrja:"Ai nuk ka nevojë për lavdi, ne kemi shumë nevojë për të"!

Historia e dëshmorit Isuf Murrja është pjesa e pestë e studimit "Kronologjia e fisit Murrja në Luzni të Dibrës

Gjaku i Isuf Murres si gjak dovleti

Nga: **ARIF MURRJA, XHELADIN MURRJA, SKËNDER MURRJA**

(vijon nga numri i kaluar)

Ndër të tjera autori shkruan: Jusuf Murren e vrau kolas Esat Beu ne vitin 1886. Pesë djemtë e tij: Abdullahu, Dauti, Miftari, Ymeri dhe Shabani, luftuan me uzbashë Deli Mehmetin në Qenok dhe i asgjesuan me asqerë. Deli Mehmetin e vrau Mal Neziri (Rexhepi) nga Hoteshi dhe ishte nipi i Isuf Murres nga e bija.

Analizë: Heroizmi i Isuf Murres nga Munir Shehu vjen i plotësuar në kënvështrime folklorike e historike. Hulumtimi i tij është shkrimi i parë historik i detajuar për Isuf Murren, që daton në vitet 60' të shekullit të kaluar (njëzetë). Në këtë variant konstatojmë pjesëmarrjen në luftë të Allaman Strakës (Sipas Hazis Ndreut është Hysen Straka dhe ky është emri i saktë) nga Çetushi, Ramë Kaziut (Kurtit) nga Arapi i Epërm dhe të Mal Nezirit (Rexhepit) nga Hoteshi.

4. Hazis Ndreu (1935-2000),

Rapsodi dibran që u investua edhe në studimin e historisë së Dibrës në librin e tij "Dibra në Udhën e Historisë", shkruan: Isuf Murrja, biri i atdhetarit Elez Murrja, që pat udhëhequr luznakët kundra Hajerdin Pashës ... djemtë e Isufit për kohën e kthimit të komandës turke për në Shehër (Dibër të Madhe) i lajmëroj Sheh Nuzi nëpërmjet Mane Bardullës (nipi i Sheh Nuzit). Vargjet e skalitura nga mendja dhe të kënduar prej tij pasqyrojnë variantin më të plotë, më të saktë e më të bukur të betejës së Qenokut.

U rref teli për këshlla
(Shkoi haberi n'at' kishlla)
Isuf Murrja qenka vra!
Isuf Murrja paska thanë:
-Të pesë djemtë që i kam lanë,
Si Dautin e Abdullanë,
Pa pague besën se lanë.
Daut Murrja një burrë idhnak,
Shemën krahinën krejt luznakë,
Ka zan pritën n'at Qenok.
-Kush u vra në tabe të parë?
-Mane Nurçja, Azhderbar .
N'at lëndinë e mbuloi tymi.
E mbuloi tymi, e mbuloi flaka.
Ban gajret o Hysen Straka!
Ahmet Murrja burr azgan
Prej n'Trepçë e n'Dovolan,
Përmbi turqit nam po ban!
-Sel Prethi ku të kam?
-Qëndro, Murre, se këtu jam!
Shtatë a tetë mbajtun i kam!
Kur vikati Deli Mehmeti:
-Hik nizam se na gjet kjameti!
Gjaku i Sufë Murrës si gjak dovleti,
Gjaku i Sufës u la me gjak,
Treqind turq u dogjën flakë.
Nam po ban pushka e Luznisë,
Kundra mbretit të Turqisë!

Analizë: Studimi i Hazis Ndreut për heroizmin dhe luftën e Qenokut është në përuthje me burimet e para dhe është akoma më i plotësuar në këndvështrimin shkencor. Kjo reflektohet edhe në vargjet e tij ku përcilllet heroizmi i luznakve dhe dibranve në emra të përveçëm. Këto vargje janë hedhur në nota muzikore dhe janë kënduar për herë të parë për më shumë se 6 minuta nga vet Hazis Ndreu dhe më pas në variante më të shkurtra nga Skënder Cala e Arif Vladi.

Kënga e Suf Murres e kënduar nga Skënder Cala

Eeej na u rref teli për këshlla
Heej çaj Suf Murren mor na e paskan' vra
Heej çaj Suf Murren mor na e paskan' vra
Ç'ajat Suf Murja pajaska than'
Eee te pesë djemtë, o mor që kam lan'
Pa e pague babën nuk e lan'
Eeej ka nis dita me zbardhue
Çajat Çenok mor e kanë, o rrethue
Ti izbash ka ke o me shkue
Eeej kur vikati, Deli o Mehmeti
Xhaku i Suf Murres, or si gjak o dovleti
Ik o nizam se të gjet o kjameti
Eeej gjaku i Suf Murres, u la o me gjake
Treqindë turqë o u dogjen në flake
Treqindë turqë o u dogjen në flake
Heej nam o po ban hej pushka e Luznisë
Kujundra mbretit oro të Turqise
Treqindë turqë o u dogjen në flake

Kënga e Suf Murres e kënduar nga Arif Vladi

Heej na u rref teli për këshlla
Çajat Suf Murren mor na e pajaskan' vra
Çajat Suf Murren mor na e pajaskan' vra
Heej çaj Suf Murrja na pajaska than':
Të pesë djemtë o si kam lan'
Pa e pague babën nujuk e lan'
Në at' Çenok ku derdhet gjak
Treqinde turqit o po digjen flak'
Ooou Dibra pushkën e ka zanate
Heej kaja nis dita meje zbardhue
Ni o piskam na asht'o ndigjue
Kur o vikati, o Deli Mehmeti
Ik nizam se të gjetë o kjameti
Mbrrin haberi o në Stamboll o mo te mbreti
Ooou gjaku i Suf Murrës si gjak dovleti
Ooo na o po ban, o pushka e Luznis'
Kujundra mbretit të Turqisë
Ooou me i zbardh faqen,
O me i zbardh faqen o shqiptarise

Analizë: Rapsodi i Madh, Hazis Ndreu zyrtarizoi në vargje dhe në nota muzikore këngën e Isuf Murrës. Më pas këndohet në një variant më të shkurtër nga aktori Skënder Cala dhe më vonë me kompozim të Mjeshtrit të Madh Përparim Tomiçni këndohet nga Mjeshteri i Madh i Këngës Populllore Arif Vladi. Ky variant u bë himn i trimërisë luznake, i trimërisë dibrane dhe i trimërisë shqiptare. Me vargun e fundit "Ooou me i zbardh faqen, O me i zbardh faqen o shqiptarise" kënga arrin dimensionin kombëtar.

5. Hilmi Kolgjegja (nuk kemi mundur të gjej të dhëna për lindjen dhe vdekjen),

Në librin e tij të vitit 1990 "Folklor nga Dibra 7" shkruan: ... për shpërndarjen e forcave të Lidhjes së Prizrenit në Dibër erdhën disa ekspedita osmane. Kundër tyre u ngritën malsorët e Dibrës dhe u dalluan shumë luftëtarë, si p.sh. Jusuf Murrja nga Luznia, që u vra pabesisht nga turqit në Çenok të Peshkopisë në vitin 1882. Autori e përcjell ngjarjen me një pjesë të vargjeve të këngës së Isuf Murres me titullin "Shkoi haberi n'at' kishlla".

Shkoi haberi n'at' kishlla,
Jusuf Murrën e kan' vra.
Jusuf Murrja paska thanë:
-Un' pes' djem i kam lanë,
kam Dautin si kapidan;
kapidan ni djalë luznak,
bani prit në Çenok;
Në Çenok e deri në Çeqë,
u shem Luznia i mirë e i keq.
-Dalip Lela ku të kam?
-Qinro, Murre, se ktu jam.
Krisi pushka, u dyn mileti
gjaku i Jusufit ni gjak mreti.

Gjithashtu Hilmi Kolgjegja luftën e Qenokut e ka komentuar edhe nëpërmjet anekdotës historike si vijon: Në luftën e Çenokut, maj Peshpaj, ku luftun' dibranë e turq, ni luznak i ra disa herë me shpatë ni turku kresë e, e kujtoi të vdekun. Të nesërmen ki luznak bashk' me ni shok t'vetin erdhën në venin ku qe ba beteja më turqit e ushtarin turk, të coptuem kresë, e gjetën hala gjallë. -A hala gjallë qanka ki turk, -pajti shoku luznakun, kur ti m'thae se i ke ra disa herë me shpatë kresë? -Ki e paska pasun krajet krejt rrashtë –ja kthej i luznaku. Se po t'kishte pasun pak tru, do kishte vdekun.

Analizë: Siç shikojmë ruhen variantet e mësipërme fillestare dhe konstatohet prezenca e një luznaku tjetër nga Hoteshi, Dalip Lela.

6. Kristo Frashëri (1920-2016),

Historiani brilant në librin e tij "Histori e Dibrës" në KreunXXIV "Dibra pas lidhjes së Prizrenit" shkruan: -Tensioni i madh që u krijua në marrëdhëniet midis popullsisë shqiptare dhe administratës osmane e ndriçon midis të tjerave revolta, e cila mori zjarr nga një shkas i izoluar-vrasja e Jusuf Murrës, e cila duhet të ketë ndodhur aty nga viti 1881.

Në kundërshtim me urdhërin e rreptë të lëshuar nga administrata perandorake, i cili ndalonte lëvizjen me armë të malësorëve jashtë "maleve"-në kohën kur kthehej nga fshati Grevë në shtëpinë e vet u ndesh ballë për ballë më një kompani shëtitëse xhandarësh. Kur komandanti i repartit me gradë yzbash, e urdhëroi të dorëzonte armën, malësori dibran nuk pranoi. Atëherë u zhvillua një shkëmbim zjarri. Në përfundim të ballafaqimit të armatosur Josuf Murrja u vra, pasi la të vrarë disa xhandarë. Vrasja e tij shkaktoi tronditje për më tepër kur kokën e tij të prerë e ekspozuan për qëllim terrori në qendër të Peshkopisë. Të ofenduar, pesë djemtë e Jusuf Murrës ftuan malësorët në ndihmë për të mbrojtur nderin e babait të tyre dhe njëkohësisht të drejtën e mbajtjes së armëve sipas traditës. Kur reparti turk kthehej nga Peshkopia për në Shehër, rreth 500 malësorë luznakë i zunë prit në Qenok. Yzbashi me mjaft xhandarë mbetën të vrarë. Nga frika e përhapjes së ballafaqimit të armatosur administrate osmane nuk e shpuri më tej.

Analizë: Parë në kënvështrimin profesional është përshkrimi më i përsosur dhe testamenti më i çmuar në aspektin shkencor.

7. Ibrahim Murrja (1937-2015),

Pasionanti i historisë së Luznisë. Më 1988 shkruajti monografinë për Ali Likën (Damzin) "Burri që vdiq në këmbë". Në librin e tij "Nandë Malet e Dibrës" shkruan për "Betejën e Çenokut 1872"shkruan: Pas një periudhe 7-vjeçare, inatçinjtë pashallarë turq e autoturq duke mos harruar ndëshkimet dhe humbjet me turp të paraardhësve të tyre në Dibër, kësaj radhe menduan të përdorin forcën për të vendosur format radikale pa dallim feje e kombësie dhe nga ana tjetër me çdo kusht të kapnin dhe të ekzekutonin krerët malësorë. Për këtë arsye Porta e Lartë e Stambollit *në vitin 1872* nisi për në Dibër tre taborë me nizamë nën komandën e bymbash Deli Mehmeti me që ky e dinte vendin pëllëmbë për pëllëmbë dhe ua dinte zakonet dhe huqet dibranëve. Reforma e Tanzimatit dhe zbatimi i tyre në Dibrën e Madhe me oficerë dhe xhandamërinë lëvizëse, për katër ditë kalon në fshatrat e Maqellarës. Në fshatin Majtarë patrulla turke me atë të turxhimenëve (përkthyesve) kapin Llan Kaziun që ishte Kreu i Nahisë Selishtë (Katër Grykëve) dhe e ekzekutojnë duke i prerë kokën.

Pas disa ditësh në fshatin Trenë, 2 km larg Peshkopisë, zabitllarët turq zatekin Isuf Murrën. Në momentin kur najçalliku, i kërkon Prijësit të Malit të Luznisë të dorëzoj hutën, me plumbin e vetëm e qëllon duke e lënë të vdekur. Zabitllarët sulen dhe në përleshje e sipër edhe Isuf Murrës i presin kokën dhe bashkë me atë të Llan Kaziut i dërguan në Kishlla-Peshkopi. Ndërkohë vargjet e memorizuar prej tij janë:

More bymbash ku don me shkue?
Sot Luznia në luftë t'ka ftue
Luftë po ban në tabe t'parë
Mane Nurçja azhdaharë.
Hazhdahar trim me fletë
mitun turqit, ka shtat a tetë
Mane Nurçja i ra nishanit
rrëzoi bymbashin majë kalit
Ahmet Murrja burr azgan,
Përmbi turqit nam po ban
Nat Çenok po ban kërdi
Me Sal Prethin e ka gri
Po pyet friku: Çu ba bymbshi?
I kan pre kryet Luznija-Hoteshi
Gjaku i Isuf Murres u la me gajk
300 turq u dogjën në flak
Ça qe posht n'ato lajthia
Lufton Reçi, Dardha e Çidhna
Me grykë të vogël, grykë të madhë
Nizamit, turkut ia lanë për varre.
Daut Murrja me Luzni
Në Çenok la historinë
Me luzninë çapajeve
Pushkë e fortë me nadë male.

Ndërkohë Ibrahim Murrja në librin e tij sjell të pikturuar nga dora e tij, imazhin e personazhit kryesor të kësaj lufte, Daut Murrën (Figura 5.5).

Analizë: Hulumtimi ka pika të përbashkëta me studiuesin Munir Shehu. Sipas tij ngjarja ka ndodhur në vitin 1872, ndërkohë kemi vitin 1886 nga Munir Shehu, vitin 1882 nga Hilmi Kolgjegja dhe vitin 1881 nga Kristo Frashëri.



Figura 5.5 *-Daut Murrja (Imazh nga Ibrahim Murrja)*

8. Emrie Skuka (Mera),

Nxorri në dritë tesatmentin e parë të Luznisë me librin e saj "Sinoret e Luznisë". Në këtë libër varianti i saj për vrasjen e Isufit dhe Luftën e Qenokut është i bazuar në studimin e Hazis Ndreut. Vrasje dhe marrja hak nga djemtë, luznakët dhe dibranët është më i zgjeruar dhe më në detaje. Autorja me doza letrare prezanton operacionet sipas kohës, vendit dhe emrave të përfshirë në këtë luftë në vitin 1882. Ndër të tjera, ajo paraqet një tjetër variant të këngës së Isuf Murres nga Osman Shquti.

Isuf Murrja na paska thanë
Pesë djem mbrapa i kam lanë
Kam Dautin e Abdullain
Pa pague babën se lanë,
Ka nis dita me zbardhue, ske ku me shkue,
N'ato lajthi ku del tymi,
Lufton Sel Predhi e Dan Brahimi
More Sel Prethi, ku të kam?
Qëndro Murre se ktu jam
Shatat a tetë majtun i kam.
... kush piskati në tabe t'parë
Mane Nurçja nji hashdehar
Ky Met (Ahmeti) Murrja nji burrë azgan
Ther turqit e nam po ban.
Ç'po pyet Feriku: Ç'u bë izbashi?
I kanë prerë kokën Luznia e Hoteshi
I thuj mbretit t'osmanllisë,
Tabori ta ndali pushka e Luznisë,
Nam po ban pushka e Luznisë,
Kundra mbretit të Turqisë.

Sipas autores këtë variant e kanë arkivuar në memorjet e tyre deri në ditët e sotme Nuri Murrja (76 vjeç) dhe Beqir Mata (87 vjeç). Ndër të tjera ajo shkruan: në atë betejë u vra Mal Neziri (Rexhepi), Mane Nurçja, Sel Prethi e Dan Brahimi.

Analizë: E reja e këtij varianti të këngës është pjesëmarrja e Dan Brahimit. Meqë autori i këtyre vargjeve është Osman Shquti, është e vlefshme të bëjmë me dije se ai ishte thesar i çmuar i memories historike për luftën e Qenokut. Kontributin e tij do ta quajmë "apologji për Isuf Murren". Në hulumtimet që ka bërë Rapsodi Hazis Ndreu, ai ka një kontribut të jashtëzakonshëm dhe e ka mbrojtur apologjikisht Heroin Isuf Murrja.

Në cilin vit u vra Isuf Murrja?

Duke analizuar autorët në Tabelën 5.2 risjellim vitin e vrasjes sipas secilit.

Tabela 5.2 –Viti i vrasjes së Isuf Murres

Autori:	Viti i vrasjes:
Ibrahim Murrja	1872
Kristo Frashëri	1881
Hilmi Kolgjegja	1882
Emrie Skuka	1882
Munir Shehu	1986

Burimi: Paraqitje e autorëve

Mendojmë se viti 1872 i shkruar nga Ibrahim Murrja dhe viti 1886 i shkruar nga Munir Shehu bien si variante sepse Hilmi Kolgjegja ekspeditat e turqve i argumenton si presion ndaj organizimeve të Lidhjes së Prizërenit, ndonëse ai shkruan se vrasja ka ndodhur në vitin 1882. Kujtojmë se Lidhja e Prizërenit është organizuar nga 1878 në 1881, ndaj mendojmë që viti 1881, që Kristo Frashëri ka shkruar në librin "Historia e Dibrës" duhet të ketë qenë periudha e ndodhjes së ngjarjes.

Territori i betejes së Qenokut

Lufta e luznak've e dibran've me komandën shëtitëse të xhandamërisë turke, kur ato po ktheheshin nga divizioni i Peshkopisë për në Sheher (Dibër të Madhe) është zhvilluar në kodrat e Qenokut. Kjo betejë është zhvilluar nga kodrina nga ku sot është rruga për në hyrje të fshatit Trepçë e deri te rruga e sotme në hyrje të fshatit Dovalan (Burimi: Jahe Murrja, Osman Shquti, Haqif Gjurra dhe Malet e Dibrës).

vijon në faqen 21

Sabedin Kurti-Kola la një trashëgimi të pasur dobiprurëse në ruajtje të traditave më të mira njerëzore.

Sabedin Kurti, *mjeshtër i rrallë i punës dhe zejeve popullore*

Nga **MEVLUD BUCI**,
studiues e publicist

Mendja dhe puna, dy shina jete që rrezatojnë jetën dhe vlerat njerëzore. Mendja është xhevahir, puna mineral, që s'e tret dheu; të dyja përbëjnë pozitën a pasurinë më të çmuar, më të ndritur për veten, shoqërinë, për kohën dhe brezat që vijnë.

S'ke se si nuk mediton, apo nuk gjurmon, kur kujton dikë që e ke njohur, që i njeh mendjen, punën a shpirtin qelibar, si i thonë, që i njeh urtësinë e pasionin, njohuritë e virtytet. Kështu të ndodh me Sabedin Kurtin e Matit, me birin e thjeshtë e të talentuar për zanatet që mësoi e demonstroi si rrallëkush. E çuditshme, njerëzore, e kuptueshme dhe fare e thjeshtë: s'paska si provat e mendjemprehtësisë, të mirësisë e të pasionit, s'paska si uniteti vëllazëror, shpirti i punës e i kërkimit, s'paska si kultura e lënë, si i thonë, e si pasioni; të gjitha këto e plot të tjera rrezatojnë si drita në udhët e jetës e të zanateve të Sabedin Kurtit.

* * *

Kur mësova, me vonesë, për ndarjen nga jeta të Sabedinit, m'u duk sikur Deja më ra mbi kokë, sepse e kisha njohur, kisha biseduar dhe në mendjen e zemrën time qe gdhendur matjani i thjeshtësisë, i mjeshtërive të rralla të punëve, "gjeologu" popullor që s'pushonte së kërkuari në krah të vëllait, të paharruarit e shkencëtarit të mirëfilltë, Dilaver Kurtit.

Jeta është e shkurtër, por ngjan me pasqyrën me dy anë, ajo regjistron gjurmët, dritën, vlerat nëpër vite e kohëra. Jeta dhe puna e Sabedin Kurtit, birit të thjeshtë e të talentuar, i ngjan një galerie të thellë, një mali me kurorë e luleshumë, i ngjan burimeve që nuk shterrojnë. Përpara provave të punës, mendjes së ndritur, shëmbëllimit në gjurmime e shpirtbardhësisë së Sabedin Kurtit, cilitdo, sado i madh në pozitë a në para, vetja do t'i dukej shumë i vogël.

Kur nisa këtë shkrim, me pengun e vonesës në shpirt, m'u kujtua një thënie epope dhe kuptimplotë e 90-vjeçarit Dali Totraku i Lùkanit (ndjesë pastë): "Or, bir, ma mirë pak shkollë e mendjehollë, se sa shumë shkollë e mendjeshollë!". Sabedin Kurti ishte mendjehollë, pasionant, durues, guximtar, mjeshtër i zanateve me shumë vlerë, kërkues ndaj vetes, i papërtuar, njeri i unitetit vëllazëror e prind shembullor. Koha dhe jeta janë "SPAK"-u më real, më i drejtë, që çmojnë drejtësinë për cilindo; u jep herët a vonë atë që meriton. Sabedin Kurtin e nderon puna, shpirtdrita, përkushtimi e pasioni, intuita prej vërtet "filozofi" në mjeshtëritë e ushtruara.

Para se të nisja këtë shkrim modest, ristudjova revistën "Emathia", ndër revistat më të ndritura të kohës, një thesar për brezat dhe traditat. U ndala tek shkrimi i pendëndriturit, publicistit e poetit të shquar, Rakip Lasku, bir i Gurit të Bardhë botuar në numrin 1 (9) 2009, faqe 50-53. "Vëllezër të pandarë në një hullì" e titullon autori, por më pas shkruan: "Sefa, një libër ende i palexuar". Shkrim studimor-publicistik mjaft mirë i realizuar, me fakte përvoje e argument, shkrim që ngjan me një përmendore fisnikërie për vëllezërit e nderuar Dilaver e Sabedin Kurti. Sigurisht, që në jetën e përditshme shkrimet duken si diçka e thjeshtë, por në fakt dëshmojnë madhështinë, bëhen themel i monografive, poemave, skicave, përshkrimeve, reportazheve. Dhe, vërtet, kushdo që lexon, a rilexon Rakip Laskun, mediton: - Sa e çfarë mund të bëj edhe më, sadopak për Sabedin Kurtin?!



* * *

Sabedin Kurti, pinjoll i fisit Kola të Burrelit, u lind në Elbasan më 29 shkurt 1936, kohë kur babai i tij shërbente në ushtrinë mbretërore. Sabedini fëmijërinë e kaloi në qytetin e Burrelit, që po shtohej me institucione e numër banorësh, ku mori edhe mësimet bazë. Familja ku u lind, u rrit e ku mori formimin kulturor e njerëzor, përbëhej nga gjyshi Jakup (që e thërrisnin Kurt, emër që u përdor si mbiemër nga trashëgimtarët e tij), gjyshja Selvije (bijë e fisit Sana të Burrelit), babai Ibrahim, nëna Fetije, tetë fëmijët: Shyqyrija, Dilaveri, Feridja (mbretëresha e këngës popullore matjane, "Mjeshtër i Madh"), Sabedini, Meleqja, Vera (këngëtare e dhejtra këngëve matjane dhe e himnit "Më ka zanë maraku me nji cucë matjane"), Lulja dhe Lirija të lindur nga dy martesa të Ibrahimit me Aishen (bijë e fisit Kadiu në fshatin Fshat të Klosit) dhe Fetijen (bijë e fisit Turja në Homesh të Dibrës). Babai i tij, Ibrahimi, pasi mbaroi shkollën ushtarake në Burrel, shërbeu në forcat ushtarake kufitare në zonën e Shupenzës (Dibër) dhe në përgatitjen e paraushtarakëve në Elbasan, ndërsa më pas iu kushtua familjes, duke bërë punë të ndryshme bujqësore e tregtare për të mbajtur familjen. Në krye të organizimit familjar qëndronte xhaxhai, Sadiku, i cili ishte njeri energjik dhe shquhej, si organizator, jo vetëm i jetës familjare, por edhe detyrave shoqërore të fshatit Burrel, nga koha e luftës së parë botërore e deri në vitet '70, kur ishte në moshë të thyer. Edhe bashkëshortja e tij, Hikja (bijë e fisit Mingla në Burrel), ishte një nikoqire e zonja. Megjithëse nuk pati fat të kishte fëmijë, ajo u bë nënë për tre vajzat e lindura nga martesa e parë e kunatit të saj, Ibrahimit: Shyqyrijen, Feriden dhe Verën, duke i rritur me ngrohtësi deri në martesë.

Sabedin Kurti vlerësonte shokët, mjeshtërit, ishte burrë me intuitë e mprehtësi të rrallë, bir i Matit e nip i Dibrës, kurdoherë në kërkim e veprim, në kryerje të punëve të çmuara si bletërritës dhe mjeshtër i realizimit të maketeve të zejeve popullore të ushtruara në krahinën e Matit e më gjerë. Gjatë viteve '50-'60 të shek. XX, Sabedini iu kushtua punëve në ndihmë të familjes, dhe pati fatin të zbulojë talentin e tij si një marangoz i talentuar falë mundësisë që iu dha të punonte pranë mjeshtrave të kohës në "Kooperativën e Artizanatit", ndërmarrje e hapur në vitet '50 të shek XX. Mes tyre ai përmendte Salë Cekën e Liman Kokën, por me konsideratë më të lartë fliste për Kros Metën me të vëllanë, Asllanin. Prej Krosit ai përmendte gjithmonë këshillën e urtë që i kishte dhënë: "Merre këtë zanat, që s'të kërkon bukë, se ujku nuk ta ha, zjarri nuk ta djeg, uji nuk ta merr e hajduti nuk ta vjedh. Kështu, Sefa është rrekur të hyjë në rrugën e Kros Metës dhe është përpjekur t'i hedhë hapat sipas modelit të tij në jetë." (R. Lasku, revista "Emathia" nr. 1(9) 2009 fq. 50-53).



Sabedini, krahas punëve të tij si mjeshtër i rrallë në punimin e drurit, nuk iu nda vëllait, studiuesit fisnik, Dilaverit, i cili në mesin e shekullit të kaluar kishte filluar të merrej me gjurmime dhe studime të trashëgimisë historike-kulturore të trevës së Matit. Së bashku ata udhëtuan në dhjetra vende: rrënoja kështjellash, ura dhe kalldrëme rrugësh antike-mesjetare, ndërtime popullore apo monumente të natyrës, por ajo që e tërhoqi më tepër Sabedinin ishin zejet popullore të ushtruara në krahinën e Matit, të cilat i gjurmonte në terren dhe për ato që nuk ekzistonin më, mblodhi të dhëna nga bartës të ndryshëm, duke u konsultuar edhe më vëllain e tij, Dilaverin. Meritë e tij janë ndërtimi i maketeve në funksion të mjediseve muzeale të valanicës (dërstilës) për prodhimin e shajakut me rrahje me çekiçë dhe ujë, çarqet për ngritjen e ujit për vaditje, mullinj të ndryshëm që punonin nëpërmjet presionit të ujit apo rrotulloheshin me kalë etj.

Një nga meritat e mëdha të tij është rindërtimi i dingës (punishtes) së barutit në përmasa maketi. Bashkë me vëllain e tij, Dilaverin, gjurmuan në zonën e Klosit, ku ishte ushtruar kjo zejë dhe secili në fushën e tij: Dilaveri bëri shkrimin studimor dhe Sabedini ndërtoi maketin e dingës, duke u konsultuar me bashkëkohës të periudhës së punimit të barutit, që fatmirësisht jetuan deri në fundin e viteve '60 të shek. XX. Kjo punë e tyre shuajti dyshimet e skeptikëve të qarqeve shkencore e akademike të kohës, që këmbëngulnin se nuk ishte e mundur që baruti të prodhohej në mënyrë artizanale me instrumenta prej druri e guri që vihen në lëvizje nga uji i përrenjve. Gjatë viteve '60-'70 të shek. XX, Sabedini ndërtoi me dhjetra makete të tillë për mjedise muzeale, nga madhësitë reale deri në miniaturë. Këto i ka realizuar për nevoja të Muzeut Historik Mat, Muzeut Etnografik Klos, Muzeut Historik Kombëtar dhe ekspozitave të kulturës popullore të hapura në kohëra të ndryshme në Mat, Tiranë, Shkodër etj.

Një nga këto dinga (punishte) me përmasa reale, ndërtuar prej tij, shërbeu për disa skena të filmit "Flaka e maleve", ku Sabedini u mbajt si konsulent për t'i shpjeguar aktorit të shquar Ndrekë Luca se si funksiononte ky mekanizëm dhe si ai duhej të sillej me të. Për këtë ai thoshte se Ndreka shpeshherë e quante "profesor".

Edhe pas daljes në pension Sabedin Kurti ka vazhduar të prodhojë për dëshirën e tij makete të zejeve popullore: maketin e punishtes së barutit, të çarkut të ujit dhe mullirit që sillej me kalë, duke e kthyer shtëpinë në një muze, ku vizitohej, jo vetëm nga nxënësit e shkollave, por edhe vizitorë të profileve të ndryshme, deri te diplomatë të huaj që vizitonin Matin dhe kërkonin të njiheshin me trashëgiminë etnokulturore të tij.

Duke ecur pa u lodhur nëpër luginën e Matit dhe malet historikë që e rrethojnë, krahas vëzhgimeve në kalatë ilire-mesjetare dhe zejet popullore të kësaj treve, Sefa (siç thirrej nga të njohurit e tij M.B.) ushtroi edhe një pasion tjetër qysh nga rinia e tij, atë të bletërritësit. Këtë profesion e ushtroi deri në ditët e fundit të jetës së tij, duke u bërë një bletërritës jo vetëm për veten e tij, por duke ndihmuar me dhjetra të tjerë që dëshironin të merreshin me këtë profesion, duke u mësuar atyre rrugën e drejtë dhe të përkushtuar larg mashtrimeve, që fatkeqësisht kanë funksionuar dhe funksionojnë në shfrytëzimin e punës dobiprurëse të bletës për jetën njerëzore.

Ajo që shkruan i nderuari Rakip Lasku, dikur në revistën "Emathia": "Sefa një libër ende i palexuar" është mjaft domethënës dhe cilindo lexues, a studiues, publicist, a cilindo e bën të vëzhgojë e mendojë, gjurmojë e krenohet me mjeshtëritë e Sefës (Sabedin Kurtit), i cili, krahas shumë artistëve e mjeshtrave të zejeve popullore përbën një vlerë të shtuar për brezat e Matit e të kombit tonë.

* * *

Sabedini u martua më 1966 me Shpresën (bijë e Çitozëve të lagjes së vjetër Berbère të Krujës) me të cilën lindën dhe rritën gjashtë fëmijë: Mirelën, Voisavën, Gencin, Etlevën, Fatjonin dhe Eltonin. Ata kanë ecur e përparuar në udhët e vështira e të bukura të jetës, të dijes e të punës. Kanë krijuar tashmë familjet e tyre dhe jetojnë në Burrel, Angli dhe Itali, duke i gëzuar prindërit me nipa e mbesa, të cilët janë krenarë për kontributet që ka lënë babai dhe gjyshi i tyre në ruajtjen e traditave më të mira të trashëgimisë kulturore.

Sabedini, pas humbjes së parakohshme të vëllait të shtrenjtë e studiuesit të talentuar, Dilaverit, nxiti dhe angazhoi me gjurmime në terren nipin, të përkushtuarin Artanin (djalin e Dilaverit) duke e orientuar në ato vende me histori në ushtrimin e zejeve, apo në ndërtimtari, ku para rreth pesëdhjetë vitesh i kishte shkelur me arkeologun, etnografin dhe folkloristin, vëllaun e tij dhe babain e Artanit, Dilaverin. Puna pasionante e dy vëllezërve Kurti është dëshmia e gjallë se si të lartëson pasioni, kërkimi, dashuria për gjurmime e mbi të gjitha nderimi për vlerat etnografike, arkeologjike, kulturore e më gjerë.

Shembulli e përvoja e Sabedin Kurtit të Matit: "...pak shkollë e mendjehollë" - "...zbato ato që di, por mëso gjithnjë!", tregon se puna, zelli, shpirti pasionant, krijues e zbatues të japin emër e bëjnë që të rrezatojë dituria. Koha dhe jeta, brezat dhe faktet e dritësimit do ta lartësojnë edhe më shumë përkushtimin e Sabedin Kurtit, këtij mjeshtëri të zejeve popullore, burri fisnik i vëllazërimit, i mençurisë dhe i punës.

Sabedin Kurti-Kola u nda nga jeta më 31 gusht 2019, duke lënë një trashëgimi të pasur dobiprurëse në ruajtje të traditave më të mira njerëzore, qoftë në mjetet në dobi të jetës, qoftë në virtytet e një njeriu që është për t'u marrë si model. Ai mbetet ikonë mendjendritur, mjeshtër i rrallë i punës në ruajtje të trashëgimisë së zejeve popullore.

Gjaku i Isuf Murres si gjak dovleti

vijon nga faqja 20

VI. PËRFUNDIME

Në vjeshtën e vitit 1881 Isuf Murrja u pikas nga komanda e xhandamërisë turke duke u kthye për në shtëpi, pas një vizite tek vjaza e tij, e martuar tek Jashar Fida në Grevë. Vendi i ballafaqimit është pak mbi rrugën nacionale të sotme afër një burimi uji në hyrje të rrugës për në fshatin Grevë. Kallauzi (udhrrëfyesi) i komandës Esat Beu kërkoi ta çarmatoste, nën urdhërin e yzabash Deli Mehmetit por ai nuk u bind dhe plasi pushka. Në shkëmbime zjarri Isuf Murrja u vra nga Esat Beu, pasi ai kishte vrarë disa xhandarë. Pas vrasjes trajtimi i kufomës ishte çnjerëzor. Ato i prenë kokën dhe së bashku me trupin e ekspozuan duke ndjell terror deri në këshlla (divizionin ushtarak turk) në Peshkopi (ku sot është shkolla Nazmi Rushiti). Trupi tij mbeti për disa ditë aty. Pas disa ditësh kur yzbash Deli Mehmeti me komandën po kthehej për në Shehër (Dibër të madhe), djemtë e Isufit të mbështetur fuqishëm nga dhjetra e qindra luznakë e dibranë organizuan hakmarrjen e babës në kodrat e Qenokut. Në këtë organizim ndihmuan Sheh Nuzi, Mane Bardulla, Elmaz Mena dhe Tahir Abazi. Betja u shtri përgjatë rrugës nacionale të sotme dhe ekzaktësisht nga rruga që të fut sot në fshatin Trepçë e deri tek rruga që të fut sot në fashtin Dovalan. Në këtë betejë u vranë Yzbashi Deli Mehmeti dhe i gjithë tabori që mendohet të ketë qënë 150 vetë. Autori i vrasjes së yzbashit është Mal Neziri (Rexhepi), i cili mbeti i vrarë së bashku me Mane Nurçen, Sel Prethin, Hysen Straka e Dan Brahimin. Ndër dibranët e shumtë që morën pjesë në luftën e Qenokut janë Ram Kaziu (Arapaj), Sadik Gjurra (Pekë), Sal Shquti (Hotesh) Dalip Lela (Hotesh) e shumë e shumë të tjerë.

VII. REKOMANDIME

Në nderim të Dëshmorit Isuf Murrja dhe heronjëve të vrarë në Betejën e Qenokut të merret në kosideratë nga institucionet vendore dhe qendrore rekomandimi ynë për të ndritur përkujtimore (i) në vendin ku është vra Isuf Murrja dhe (ii) në një nga kodrinat e Qenokut ku janë vrarë Mane Nurçja, Sel Prethi, Hysen Straka, Dan Brahimi, Mal Neziri (Rexhepi) e të tjerë.

Rruga e Arbërit nr. 170

profil

Më 29 gusht 2020 u nda nga jeta gazetari, publicisti dhe shkrimtari Velo Cfarku. Gazeta i përcjell ngushëllimet familjes.
Ai ishte një kontributor me vlerë në gazetën tonë, duke botuar shkrime, por dhe duke dhënë sugjerime të vlefshme.
Velo Carku ishte një nga lexuesit tanë më të rregullt, i cili shprehej se gazetën "Rruga e Arbërit" e lexoj me laps në dorë".

Velo Cfarku, *ikja e një njeriu që la emër pas*

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Ai iku, iku në të tetëdhjetë e pestat e jetës së tij...

Iku duke lënë pas djem e vajza, nipër e mbesa, shokë e miq...

Iku duke lënë emrin e vet, emër me germa të mëdha...

Kryeredaktor i gazetës dibrane "Ushtima e maleve"...

Unë kam punuar me të një kohë të gjatë...

Kam bredhur malet, veçanërisht ato të Gollobordës, dashurinë e jetës së tij...

Velo Cfarku iku...

Në këtë ikje, në pamundësi për të derdhë mbi dheun e varrit pika loti, për tu dhënë gjakut të tij kurajo por përcjell një letër të Velos, letër plot dashuri e respekt...

Po përcjell edhe një shkrim që bëra për librin e tij duke udhëtuar me të atyre vendeve që ai i donte dhe nuk mungoi tu japë bojë nga pena e tij e gazetarit...

MA DALLGËZOVE SHPIRTIN VELO CFARKU

Udhëtim mes kujtimesh të largëta

Më mirë mos ma kishe dërguar atë libër Velo Cfarku, mos ma merrje shpirtin e ta dallgëzoje atyre maleve, atyre vendeve që hyjnë e mbeten përjetë si një ëndërr, asaj treve ku ti linde e unë mora e mbusha shpirtin me një tufë kujtimesh që syrgjyni (dhe vetëm ai) i ve në qendër të jetës. Se ty, i dashur Velo, nuk të ra shorti i jetës të syrgjynosesh, të udhëtosh në legjendën "Nëntë male kaptuar", të përballesh me gjuhë tjetër e dhunën për t'iu përshtatur vendit të huaj. Ti Velo ishe e Velo mbete. E vetmja rrugë e jetës tënde ishte nga malet e Gollobordës; nga Gjinoveci, Klenja e Trebishti në Peshkopi. Më pas shkove në Lezhë e siç më tha Kozmai tani ke ngreh një pallat në Tiranë.

Unë, megjithëse "Nëntë male kaptuar", më ndodh, kur takoj apo flas me ndonjë dibran, të iki (si ai qengji i Naimit) me mend atyre vendeve e të bujë në ato kulla apo kasolle mbi male. Unë, vazhdoj të jem dibran jo vetëm shpirtërisht por edhe ligjërisht. Ende nuk e kam hequr (dhe nuk do ta heq) qenien qytetar i Peshkopisë, megjithëse bashkë me fëmijët, e kam një shtëpi në Tiranë dhe nja pesëqind metro katrore tokë në Kamzë. E shumta që mund të bëj është që ta spostoj gjendjen civile në Zdojan, në fshatin ku linda dhe ku kam varret e prindërve. Por këtë do ta bëj kur atje, në majë të asaj kodrës që sheh tërë luginën e Drinit të Zi e Nëntë Malet e Dibrës, të bëj një kasolle dhe të dremis vitet e fundit të jetës...

Kur Kozma Traja më dha letrën tënde të ngrohtë (Ti nuk mund ta kuptosh se sa të ngrohta janë letrat e vendit tënd, veçanërisht kur vijnë dhe mes kujtimesh të marrin me vete) dhe librin tënd të parë, "Golloborda në optikën e kohës" dallgët e shpirtit i kaluan tetë ballët. Diçka kam shkruar si meditim të atij takimi, diçka që ndonjë ditë do ta lexosh.

Ç'është e vërteta unë gjatë këtyre viteve jo vetëm një herë kam qenë në Gollobordë.

Jo fizikisht, por me shpirt e me zemër, në udhëtime fantastike. Kam qenë në Ostrenin e Madh me vëllezërit Rama. Kam qenë edhe në Ostrenin e Vogël me Eduard Sulën, dibranin që i shpëtoj dhunës detare të anijes Sibila të marsit të egër 1997 duke lënë mes dallgëve të zeza djalin, gruan dhe vëllanë. Kam qenë edhe në Tuçep e Lladamericë, në ato kopshtet e bukura ku rriten pemë gjithfarë llojesh, ku ka një burim, një kanal ujitës që kalon kufirin, një hidrocentral. Kam qenë edhe në Pasinkë e Tërbaç. Madje Tërbaçin e kam lakuar në sa e sa shkrime falë një miku që kam nga Tërbaçi i Vlorës. E din ti i dashur Velo se Tërbaçi i Vlorës e ka konakun dhe gjakun e të parëve të vet nga Tërbaçi i Dibrës ? Unë e kam parë të shkruar me germa të mëdha (shprehje krenarie labe) në muzeun e fshatit, muzeun "Hysni Kapo" siç e quanin atëherë. E trazuar është Shqipëria, i dashur Velo, e trazuar. Jemi një edhe pse historia (dhe histeria e fuqiplotëve) na kanë dashtë të ndarë e të përçarë. Aq të ndarë sa është i vetmi vend në botë që është prerë siç pritet berri për kurrizi e qendrën gjeografike të vetën (francezët kanë Verdunin) e ka jashtë kufijve, diku midis Dibrës së Madhe dhe Strugës. Ti je mësues i shkencave ekzakte dhe mund të bësh matje, matje të cilat të jesh i sigurt se nuk luajnë "me pash".

Me thënë të drejtën, i dashur Velo, e kisha dëshirën që ta bëja një rrugë mes përmes Gollobordës. E ëndërrova dhe e planifikova dhjetëra herë vitin e kaluar kur një miku im emigrant më tha se kur do të përurojë lokalin e tij në Librazhd do më marrë me vete. E pata skicuar që pasi të kaloja natën në Librazhd të nesërmen t'i zija pritë ndonjë fugoni që udhëton drejt Gollobordës. Më kishte marrë malli të mbushja grushtet me ujë në ato çezmat në shkallën e Lunikut, të hidhja një sy mbi ato kullat e gurta të Llangës, kulla ku mjeshtëria e të ndërtuarit ka bërë monument, të ndalesha për pak minuta në fushën e Studnës, atje ku një herë e një kohë patatet formonin kalldrëm mbi tokë e kamionët autokolonë transporti. Doja, kur të ngjitesha lartësive të Steblevës, bjeshkëve të mrekullueshme të Kallkanit të mblidhja një dorë lule mali e me një vështrim t'i përcillja larg në malet e Okshtunit e Prodanit, atje ku Haki Stërmilli i madh i letrave dibrane pat shkruar ditarin e tij të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqiptarëve.

E kam me vete Haki Stërmillin. E kam jo me veprën e botuar por me të pa botuarën, me "Dibra në prag të historisë". Diçka shkruan Hakiu edhe për Gollobordën e fillim shekullit të kaluar. Diçka kam edhe unë në një bllok me shënime të nxjerra nga gazeta "Përlindja e Shqipërisë", botim i Qeverisë së Vlorës në vitet 1913 – 1914. Po e lë në qetësi pak kompjuterin në kërkim të tyre...

...Të dytën harroje. Në bllok kam vetëm këtë shënim: "Përlindja e Shqipërisë, vjeti II nr, 4, 11/24, kallnduer 1914, e shtunë.

Flet për barbaritë serbe në Gollobordë nën titullin "Udhëtim në Gollobordë" Vazhdon edhe në nr. 5, 15/28 kallnduer 1914...

Më vjen keq që nuk e kam. E kisha vendosur atëherë që ta fotokopjoja të tërë shkrimin që thuhej se ishte bërë sipas tregimit të një diplomati. Nuk u bë sepse atëherë (1978) fotokopjuesi i Bibliotekës Kombëtare ishte tepër i ngarkuar.

Mund ta kopjoni ju i dashur Velo. Jeni në Tiranë dhe kohë keni me bollëk. Unë po të kisha këtë privilegj do të mbillesha e mbija në bibliotekë.

Të parën, atë që e dokumenton Haki Stërmilli në "Dibra në prag të historisë" mund të ta shkruaj pa i bërë ndonjë "redaktim" në gjuhën drejtshkrimore të sotme...

"...Zoti Kenedy, misionar Amerikan në Korçë, me përpjekjet e mundimshme që hoqi për Kombin Shqiptar, u bë i shtrenjtë për ne. Shkon n'atë kohë edhe në Gollobordë për tu ba disa ndihma atyre ma nevojtarëve. Shoqi i tij shqiptar, mbasi përshkruan bukuritë natyrore të Gollobordës, ban në formë përshkrimi edhe psimet e këtyre katundeve në kohën e okupimit serb:

Në Fushë Studën shofim nji vorr dhe pranë vorrit nji shtëpi. I vrami qe i zoti i shtëpisë së djegun. Përqark kanë pa edhe shumë shtëpi të djegura ndonëse Studna në atë kohë kishte qenë brenda kufinit tonë. Ma përpjetë bje në Zabzun dhe ka ndalë vetëm në dy shtëpi se të tjerat ishin ba gërmadhë e hi. Njena prej kësaj shtëpie kish ba fli dy vëllazën. Ke xhamia tregon nji grue faqe së cilës i vranë të shoqin, Halil Aganë. Prej këtij trishtimi gruaja hikën dhe len foshnjën pranë shtëpisë. Serbët kur dogjën shtëpinë e kapën edhe djalin e vogël dhe e hudhnë në zjarr të gjallë...

...Më tutje shohim nji vorr dhe në gërmadhë të shtëpisë së djegun gjejmë të mbeturat e grues e cila kishte qenë djegun ma parë në zjarr...

...Në Zabzun u vranë 34 vetë dhe u dogjën 175 shtëpi..."

Me dhimbje i dashur Velo, me dhimbje jemi ngjitur në të përpjetën



U NDA NGA JETA GAZETARI, PUBLICISTI DHE SHKRIMTARI **VELO CFARKU**

Më 29 gusht 2020 pushoi së rrahuri zemra e gazetarit, publicistit dhe shkrimtarit Velo Cfarku nga një sëmundje e papritur dhe e rëndë.

Velo Cfarku lindi më 5 maj 1935 në fshatin Gjinovec të Gollobordës, në një familje bujare dhe atdhetare. Mësimet e para i mori në vendlindje, pastaj vazhdoi shkollën pedagogjike "Ndrec Ndue Gjoka" dhe plotësim shkollën pedagogjike "8 Nëntori" Peshkopi. Kreu Institutin Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani" në Tiranë për matematikë-fizikë.

Më vonë mbaroi Shkollën e Lartë të Partisë dhe kursin e lartë të filozofisë. Ka punuar mësues në fshatin e tij të lindjes për 7 vjet në shkollën 7-vjeçare "10 Dëshmorët", Trebisht. Në vitet 1956-1963 ka punuar drejtor i shkollës 7-8 vjeçare "Spiro Velka" të Klenjës dhe njëkohësisht drejtor zone. Ka punuar 5 vjet instruktor në aparatin e Komitetit të Partisë së rrethit Dibër. Për gati 19 vjet ishte kryeredaktor i gazetës "Ushtima e maleve", një nga gazetat lokale të kohës.

Velo Cfarku është autor i librave: "Golloborda në optikën e kohës", "Një jetë mes dibranëve", "Të parën kemi Dibrën", "Intelektuali emblematik i Gollobordës", "Mozaik episodesh e ngjarjesh rrjedhës së Drinit të Zi" si dhe bashkautor i disa librave të tjerë dhe redaktor e recensent i dhjetëra librave.

Për punën e bërë është dekoruar me dinstiktivin "Mësues i dalluar", me medaljen "Naim Frashëri", për punë të mirë në arsim dhe me urdhërin "Naim Frashëri" të klasit II, "Për punë të mirë në drejtimin e gazetës "Ushtima e maleve".

Edhe si pensionist Velo Cfarku u dallua si qytetar aktiv. Ai nuk pushoi së punuari për promovimin e ngjarjeve e figurave të ndryshme të Gollobordës, Dibrës e Shqipërisë. Dha ndihmesën e tij të veçantë si anëtar i kryesisë së përgjithshme të Shoqatës "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë" dhe si anëtar i kolegjumit të gazetës "Zëri i Pensionistit" prej më shumë se një dekadë.

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes, Kryesia e Shoqatës "BPPSH" i dha Velo Cfarkut titullin e lartë "Nderi i Shoqatës Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë" me motivacion: "Për kontribut të veçantë në forcimin dhe gjallërimin e jetës së BPPSH-se dhe pasqyrimin e problematikave të pensionistëve të Shqipërisë në medien e shkruar". Po me propozimin e kësaj Kryesie në vitin 2014, Komuna Trebisht e shpalli "Qytetar Nderi "

Faik Xhani, Kryetar i Shoqatës "BPVPSH"

NJË LETËR NGA VELO CFARKU

I dashur Abdurahim !

Jam mirë, dëshiroj që të jeni shëndosh e mirë familjarisht.

Abdurahim !

Ka disa vite që nuk jemi parë, por po të them sinqerisht ushqej një respekt të jashtëzakonshëm për gjithë atë punë që po bën, me pasion e përkushtim. Nëpërmjet shkrimeve që po lexoj në gazetën "Rruga e Arbrit" më duket sikur jemi shumë afër. Ju them shpirtërisht kam një mall e ndjenjë respekti për karakterin tuaj konsekuent.

Abdurahim !

Po të dërgoj si dhuratë simbolike librin tim të parë " Golloborda në optikën e kohës ". Ju jeni gazetar dhe sigurisht do të keni edhe vlerësimet tuaja. Unë tash së shpejti do të botoj edhe një libër të dytë. "Përplasjet në Dibër" me burim ndeshjet që kemi pasur gjatë viteve në gazetë.

Mu bë qejfi kur lexova se ju së shpejti do të hidhni në qarkullim librin tuaj "Njerëz që i dua".

Kam shumë për të shkruar, por të them sinqerisht, dora po më ngec. Kam përpara një Abdurahim fytyrëqeshur, një Abdurahim organizator, një Abdurahim asnjëherë qejfprishur, një Abdurahim organizator e alegrist në dasmat e fëmijëve të mi në Peshkopi.

Ju uroj shëndet familjarisht. Ju, Natashës dhe fëmijëve tuaj.

Me nderime e respekt.

Velo Cfarku

Tiranë më 28 janar 2008.

Ty, i dashur Velo, nuk të ra shorti i jetës të syrgjynosesh, të udhëtosh në legjendën "Nëntë male kaptuar", të përballesh me gjuhë tjetër e dhunën për t'iu përshtatur vendit të huaj. Ti Velo ishe e Velo mbete. E vetmja rrugë e jetës tënde ishte nga malet e Gollobordës; nga Gjinoveci, Klenja e Trebishti në Peshkopi.

homazh



Më ngope me ajrin e pastër të atyre maleve i dashur Velo në udhëtimin tënd të fundit në Klenjë e Gjinovec me zotin Zibitko. Do të doja të isha edhe unë me ju, veçse, pasi të pija një kafe në qytezën e sharrëtarëve të më jepnit leje të zbrisja pak në Steblevë për tu dalë përpara sipër, tek ai dyqani me artikuj të përzierë anës rrugës.

e historisë për të bërë vend midis kombeve të Evropës, të asaj Evrope që nuk na deshi, që na ndau e na përçau, të atyre fqinjëve që copa lakmonin të merrnin duke na konsumuar kafshatë pas kafshate derisa një ditë të dilnin në Durrës, Shëngjin e Vlorë, duke na brejtur tërë kockat.

Fatmirësisht qëndruam. Ndoshta edhe në sajë të zgjuarsisë dhe fjalëve të asaj gruas që përmendet në historinë e Trebishtit, të asaj gruas që foli shqip, kur shqiptarët dhe shqipen (edhe sllavishten) duhej ta kërkonin tutje Tetovës e Gostivarit, në Shkup, Preshevë e Nish, në Ulqin, Tivar e Vermosh...

Më ngope me ajrin e pastër të atyre maleve i dashur Velo në udhëtimin tënd të fundit në Klenjë e Gjinovec me zotin Zibitko. Do të doja të isha edhe unë me ju, veçse, pasi të pija një kafe në qytezën e sharrëtarëve të më jepnit leje të zbrisja pak në Steblevë për tu dalë përpara sipër, tek ai dyqani me artikuj të përzierë anës rrugës. Kisha dëshirë ta shoqëroja në raki atë plakun e vjetër të Avdëve, Ibrahimin, atë që na mori përkrahu nga sharra e na çoi në shtëpinë e tij, që u deh e na vuri në kor të këndojmë (edhe ne çakërrqejf) refrenin e asaj këngës së tij të çuditshme, këngë me dy vargje "Më ka humbë një dhi, kërkoj një cjap". Në mos gaboj (pleqëria bën të vetën) kemi qenë bashkë atë natë. Kaq humor e shpirt mikpritjeje nuk kam gjetur gjëkund në udhëtimet e mija maleve të Dibrës.

Ke një farë dallgëzimi në shpirt i dashur Velo kur në Klenjë e Gjinovec kërkon të kaluarën, kërkon Budinin e ujit të pijshëm e të ujëmbledhësit të Golemovës, kërkon "shatërvanët" e ujitjes së fushës. E pashë që të erdhi keq që nuk u ngjite në Raduç, nuk ece midis barit dhe luleve të atij mali të lartë që është bukuri e bukurive të zonës. Thoshe se u frikësove nga retë në qiell kur duhet të thoshe se frikësoheshe nga "retë mbi kokë", ato lloj resh që të zbardhin kokën e të ndalin këmbën në të përpjeta. Ma ka ënda të udhëtoj edhe një herë atyre maleve por nuk më len këmba. Ma ka ënda që t'i bije mes për mes Klenjës, të ndalem pak tek spitali e të marr të përpjetën në perëndim, atë të përpjetë që të çon në një majë ku pamja e Sebishtit me lumin mes për mes, me gjelbërimin dhe shtëpitë pranë e pranë të tërheq si me magnet.

Ma zbehe pak dëshirën e një udhëtimi nëpër ato vende të bukura kur shkruan se atje tashmë mungojnë shkollat, spitalet, njerëzit. Golloborda në syrin e kohës qenka tjetërsuar. Bukuria e vendit pa bukurinë e njeriut pranë e pranë, pa punën e tij u zhbëkërka aq shumë sa ti duke kërkuar qoshkat e kujtesës tënde të fëmijërisë e rinisë, humbe midis degësh e ferrash...

Nuk e harrova Trebishtin i dashur Velo, të Tre Bishtat që e formojnë atë ; Bala, Muçinë e Çelebi. Nuk kisha si ta harroja sepse atje kam qenë disa herë dhe në një ndër tubimet e tij me rastin e 70 vjetorit të hapjes së shkollës së parë shqipe, paralele në kohë me atë të Peshkopisë, më 14 prill të vitit 1914 (në mos më ka lënë kujtesa për datën) kam mbajtur edhe një kumtesë. Tema lidhej me disa aspekte të psikologjisë së punës të ndërtuesit gollobordas. E pata punuar me dashuri atë kumtim. Me dashuri dhe ovacione u prit nga njerëzit e ngjeshur si sardelet në kuti në sallën e shtëpisë së kulturës. Me shënimet tuaja, veçanërisht me fotografitë, më ktheve një çerek shekulli pas. I kam ato fotografi, në letër dhe në negativ, se edhe unë, si puna jote, jam paksa manjak në ruajtjen e gjërave. Kam një arkiv të tërë me fotografi e me negativa që nuk di se çfarë ta bëj dhe si ta administroj. Atë kohë, dhe ata njerëz, edhe pse kanë qenë heronj të mëdhenj ndërtimesh, që kanë ngritur qytete, fabrika, hidrocentrale e kanale ujitës i shohin me sy vëngër dhe (kur janë gjallë) u japin një pension sa as për bukë thatë e kafe nuk mjafton.

Asokohe, bashkë, i qemë ngjitur kodrës përpjetë, rrugës për në Gjinovec dhe më tej në Klenjë. I mban mend ato tubat që shtriheshin gjatë gjithë rrugës për t'i dhënë Trebishtit ujë ? Jam larg se do të rrëmoja në fotografi e në filma dhe me siguri do të gjeja ndonjë pamje të Tre Bishtave nga lart dhe të kanaleve e tubave në montim.

Fola me ty sot, i dashur Velo, fola në një ditë të madhe për kombin e vuajtur shqiptar, fola më 17 shkurt 2008, në Ditën e Pavarësisë së Kosovës, në Ditën e Ëndrrës së Madhe Shqiptare, u përfshiva mes dallgësh gëzimi dhe krenarie që vetëm shpirti i lexon dhe i shkruan pa gabime...

Athinë, 17 shkurt 2008

Naxhije Deva, simboli i një marrëdhënie shumëdimensionale, njerëzore dhe vëllazërore

Ikja nga kjo jetë, që ndërpreu përvjetorin e 65 të martesës

Nga **RAMIZ ÇIKU**
SHAQIR SKARRA

Sivjet, më 23 gusht të vitit 2020 djemtë dhe vajzat e çiftit Rustem e Naxhije Deva kishin vendosur t'ju festonin prindërve 65 vjetorin e martesës së tyre, 65 vjet jetë bashkëshortore, por fati u doli krejt ndryshe. Ajo dëshirë e madhe që kishin, u ndërpre në mes.

Më 6 gusht të vitit 2020, Naxhije Deva u nda nga jeta në moshën 85 vjeçare, duke ua lënë dëshirat dhe planet e parapërgatitura, thjesht një ëndërr të bukur e të parealizuar.

Vdekja e Naxhijes këtë natë gushti ishte për Rustemin si një ortek i madh dëbore që përmbysi gjithçka. Kishte kohë që e kishin kaluar gjysmën e shekullit bashkë, prisnin të festonin 65 vjetorin e jetës bashkëshortore.

Naxhija kishte kaluar një pjesë të jetës në familjen e prindërve, ku kishte mësuar shumë për traditat e bukura të mikpritjes, por kishte përfituar shumë e më shumë kur erdhi nuse në kullën e Llan Devës. Këtu ajo gjeti një familje të shëndoshë patriarkale, por edhe një disiplinë e rregull të përkryer në punët e përditshme.

Si nënë ishte e përkushtuar shumë dhe ishte modeli i grave të tjera, por edhe si bashkëshorte i krijonte më shumë mundësi Rustemit që të angazhohej me detyrat e ngarkuara. Kjo vërtet ishte një sakrificë që e kërkonte koha, por jo çdo grua e bënte me dëshirë dhe vullnet.

Unë jam njohur herët me Rustem Devën, por sot, tek po mundohem të hedh disa skica e të bëj portretin e Naxhijes, kudo më shfaqet Rustemi. E shikoja çdo ditë në mëngjes në kafe me miq e shokë, në mbrëmje krah për krah me Naxhijen dilnin në ish Fushën e Aviacionit.

Jo unë që i njihja, por të gjithë habiteshin me këtë çift në moshë të tretë që xhirot në mbrëmje të kapur të dy bashkë dorë për dore ecnin të shkujdesur dhe kafen në darkë do ta pinin gjithmonë bashkë. Dhe nuk e prishën kurrë këtë rregull, edhe kur ishin mirë, edhe kur ndjeheshin sëmurë e të lodhur. Mbrëmja do t'i gjente bashkë, deri në mbrëmjen e 6 gushtit e vitit 2020, e cila fizikisht i ndau, por jo shpirtërisht.

Rustemi punonte larg familjes dhe Naxhija u bë edhe nënë, edhe babë për fëmijët. Lindën, rritën dhe edukuan tre vajza e tre djem: Hasija, Selvija, Rabija, Ajeti, Fatosi, Altini.

Kur jetonin në Muhurr, Naxhija punonte në ish kooperativën bujqësore, merrej me rritjen dhe edukimin e fëmijëve, kujdesej edhe për punët në shtëpinë e madhe të Llan Devës, ku priste e përcillte miq të njohur e të panjohur pothuaj çdo natë. Nuk e pa askush Naxhijen të ankohej, por zgjohej në mëngjes e para dhe binte e fundit, derisa sigurohej se nuk kishte mbetur asgjë pa realizuar. Dhe jo pak, por plot 28 vjet qëndroi në Muhurr. Kur u transferuan me banim në qytetin e Peshkopisë, punonte në



ndërmarrjen ushqimore, në fruta-perime. Asnjëherë pa punë, asnjëherë nuk ankohej për punën që bënte. E urtë, e sjellshme, me virtyte të larta njerëzore, shembull për të gjithë. Punë në ndërmarrje, punë në shtëpi. Krahas fëmijëve që duheshin rritur, edukuar e shkolluar në Peshkopi kujdesej edhe për prindërit e Rustemit, të cilët jetonin në një shtëpi.

Një jetë e mbushur plot me dashuri, me halle e brenga, me dhimbje edhe gëzime. Një jetë e mbushur plot. Lot dhimbje dhe dashurie në sytë e tyre dhe sa bukur ia fshinë njëri-tjetrit lotët nga sytë. Gjatë gjithë jetës së tyre të gjatë bashkëshortore ecën bashkë, ecën të dy në udhën e gjatë të bukur, por edhe të vështirë.

Sot Naxhija nuk jeton më, fizikisht është ndarë nga jeta. Na mungon të gjithëve. I mungon Rustemit, i mungon Hasijes, i mungon Selvijes, Rabijes, Ajetit, Fatosit, Altinit, u mungon nipërve e mbesave të shumtë.

Hasija e ka përjetuar shumë keq humbjen e nënës. Me lotët në sy që e tradhtojnë vazhdimisht do të falënderojë të gjithë ato që i qëndruan pranë, ato që e ngushëlluan me telefon apo mesazhe. E një mesazh ngushëllimi i është ngulitur në memorie, i cili i vjen nga Ramiz Çiku: "Ngushëllimet e mia Altin, si dhe ngushëllime përcjell edhe për motrat e vëllezërit tuaj. Nëna juaj dhe motra jonë e familjes Naxhija do të jetojë gjatë në shpirtin tonë. Ajo nuk do të harrohet për bujarinë dhe dashurinë e saj, për urtësinë dhe qetësinë e saj, për fjalën e mirë, mundin dhe punën e palodhur, për gjithë shërbimin në kullën e madhe që ka kryer për gjithë njerëzit e shtëpisë me dekada, për edukatën dhe pastërtinë e saj. Po sa shumë të mira ka pasur ky njeri, saqë ky mesazh është i vogël për ta përshkruar. Kush e ka njohur Naxhijen sadopak, jam shumë i sigurt që bashkohet me mua. Por kryevepër e Naxhijes jeni ju, fëmijët e mrekullueshëm të saj: Hasija, Selvija, Rabija, Ajeti, Fatosi, dhe Altini, të cilët sot kanë humbur njeriun e pazëvendësueshëm, të cilët ju drejtohem sot që të mbledhin forcat për ta përballuar këtë dhimbje dhe Zoti ju dhëntë jetë të gjatë për ta kujtuar me dashuri e respekt nënën tuaj.

Babai juaj Rustemi sot ka humbur bashkëshorten dhe bashkudhëtaren e tij të dashur. E ngushëlloj dhe i uroj të ketë jetë të gjatë dhe fëmijët

Nëna juaj dhe motra jonë e familjes, Naxhija, do të jetojë gjatë në shpirtin tonë. Ajo nuk do të harrohet për bujarinë dhe dashurinë e saj, për urtësinë dhe qetësinë e saj, për fjalën e mirë, mundin dhe punën e palodhur, për gjithë shërbimin në kullën e madhe që ka kryer për gjithë njerëzit e shtëpisë me dekada, për edukatën dhe pastërtinë e saj.

shëndoshë për ta kujtuar me mall e me shpirt Naxhijen, si shoqen më të shtrenjtë të jetës.

Nënë asaj i kanë thirrur edhe fëmijët e të ndjerit Shefkiut, të cilët edhe ata i ngushëlloi njëlloj si dhe ju.

Naxhija, që kur ka ardhur në kullat e Llan Devës, një derë të hapur ka pasur edhe në shtëpinë tonë, pasi babën tonë Xhilin e kishte kumbar, e kishte vëllanë e madh. Ajo ishte simboli i një marrëdhënie shumëdimensionale, njerëzore dhe vëllazërore për familjet tona.

Kjo nënë, kjo motër, kjo gjyshe, kjo shoqe, kjo bashkëshorte, kjo komshije, kjo mbesë, meritonte gjithë respektin e gjakut dhe njerëzve që e kanë njohur sadopak".

Hasijes ende nuk i janë tharë lotët e me zemër të copëtuar shprehet: "Më mungon e do të më mungojë shumë, gjithë jetën time, e shtrenjta, e mira, e veçanta, e urta, nëna ime!

Do të më mungojë puthja e përqafimi i saj sa herë që shkoja ta takoja, do më mungojë thirrja e saj nëpërmjet telefonit të Rustemit, që më kërkonte shpesh, sa herë që mërzitej! Nuk do të kem mundësi më të shijoj gatimet e thjeshta, por të pastra që gatuante! Nuk do të qeshim më bashkë si dikur, nuk do të shikoj më nëpër shtëpi, ti ishe dhe mbete drita e syve të mi. Ti që më dhe mua jetën, që më rrite me shumë sakrifica, ti që më plotësove çdo tekë timen fëminore, ti që nuk dije të mbaje kurrë inat për asgjë, ti që më doje vetëm të mirën, ti që mendove për mua deri në momentin e fundit të jetës!

Unë ndjehem krenare për ty heroina ime, që vuajtjeve të tua u vure sipër heshtjen tënde, buzëqeshjen. Edhe momentet e fundit aty isha pranë teje, të pashë dhe më pe mirë. Sytë e ty të vegjël sikur më thoshin mua: "Mos qaj, bija ime, se unë gjithmonë do të jem me ty, gjithmonë do të jetoj në kujtesën tënde ".

Ajo ka një mesazh për të gjithë: "Rrini sa më shumë me prindërit tuaj, mos i mërzisni ata, mos u ankoni për gjëra pa vlerë, mos iu bërtisni, ata kanë gjithmonë të drejtë. Puthini prindërit tuaj çdo ditë, tregojuni sa i doni, se ndoshta një ditë do i kërkoni si të marrë dhe e vetmja gjë që do të keni është një kujtim!"

FOTOLAJM



NË FOTO: Gjatë punimeve për hapjen e tunelit të Murrizit. Kjo foto është publikuar në faqen zyrtare në Facebook të kompanisë "Gjoka Konstruksion", e cila po ndërton me partneritet publik-privat rrugën e Arbërit.
Pas shembjes së tunelit një vit më parë, kompania ka nisur në një vend tjetër tunelin, i cili do të jetë rreth 600 metra më i gjatë se ai i parashikuar në fillim të kontratës. Kryeministri Edi Rama njoftoi në mes të shtatorit se kompania ka realizuar 60% të punimeve në rrugë. Gjatë një publikimi të një video më 18 shtator, ai u tha mirëmëngjes ndjekësve të tij me "pamjet më të fundit të kantierit të Rrugës së Arbërit, ku puna vijon me ritme të larta e deri sot është realizuar 60% e projektit". Rruga pritet të hapet për kalimin e lirë në pranverën e vitit 2021.

Bigmarket
PESHKOPI

DI ÇFARË
ZGJEDH!

GJITHMONË ME OFERTA...

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

cyan magenta yelloë black